



KONTROLI I LARTË I SHTETIT
Raport përfundimtar i auditimit të ushtruar në Bashkinë Has

RAPORT PËRFUNDIMTAR AUDITIMI

MBI
“AUDITIMIN FINANCIAR”

BASHKIA HAS

Tiranë 2022



PËRMBAJTJA

I. PËRMBLEDHJE EKZEKUTIVE.....	4
1. Përshkrim i shkurtër i Projektit të Auditimit.....	5
2. Përshkrim i gjetjeve kryesore dhe rekomandimeve.....	5
3. Konkluzioni i përgjithshëm dhe Opinioni i auditimit	7
II. HYRJA.....	10
1. Objektivat e auditimit.....	10
2. Qëllimi i auditimit	10
4. Përgjegjësitë e strukturave drejtuese	11
5. Përgjegjësitë e audituesve.....	11
6. Kriteret e vlerësimit.....	11
7. Standardet e auditimit	12
8. Metodologjia e auditimit	12
9. Dokumentimi i auditimit.....	13
III. PËRSHKRIMI I AUDITIMIT	14
1. Informacion i përgjithshëm mbi subjektin.....	14
2. Përshkrimi rezultateve sipas drejtimeve të auditimit.....	14
2.1 Mbi menaxhimin financiar, kontrollin dhe auditin e brendshëm.....	14
2.2 Mbi planifikimin dhe zbatimin e PBA-së dhe buxhetit vjetor për vitin 2021	19
2.3 Mbi vlerësimin e raportimit financiar, për të arritur në opinionin për pasqyrat financiare për vitin 2021	37
2.4 Mbi zbatimin e rekomandimeve të lëna në auditimet e mëparshme	56
IV. GJETJE DHE REKOMANDIME.....	72
V. ANEKSET.....	86

Lista e shkurtimeve

KLSH	Kontrolli i Lartë i Shtetit
MFE	Ministria e Financave dhe Ekonomisë
MFK	Menaxhimi Financiar dhe Kontrolli
NA	Nëpunës Autorizues
NZ	Nëpunës Zbatues
GSM	Grupi i Menaxhimit Strategjik
NJAB	Njësia e Auditimit të Brendshëm
AB	Auditi i Brendshëm
MAB	Manuali i Auditimit të Brendshëm
FZHR	Fondi i Zhvillimit të Rajoneve
AQT	Aktive të Qëndrueshme të Trupëzuara
UMF	Udhëzim i Ministrisë së Financave
VKM	Vendim i Këshillit të Ministrave
VKB	Vendim i Këshillit Bashkiak
ASHK	Agjencia Shtetërore e Kadastrës
NJA	Njësi Administrative
SHA	Shoqëri Anonime
NJP	Njësia e Prokurimit
BOE	Bashkim i Operatorëve Ekonomikë
OE	Operator Ekonomik
KVO	Komisioni i Vlerësimit të Ofertave
ISSAI	Standardet Ndërkombëtare të Institucioneve Supreme të Auditimit
INTOSAI	Organizata Ndërkombëtare e Institucioneve Supreme të Auditimit
IFAC	Federata Ndërkombëtare e Kontabilistëve
IPSAS	Standardet Ndërkombëtare të Kontabilitetit në Sektorin Publik

I. PËRMBLEDHJE EKZEKUTIVE

Departamenti i Auditimit të Vetëqeverisjes Vendore në Kontrollin e Lartë të Shtetit, në zbatim të planit vjetor të auditimeve kreu auditimin financiar me objektiv veprimtarinë ekonomike dhe financiare të Bashkisë Has, për aktivitetin ekonomik dhe financiar të periudhës nga data 01.01.2021 deri më 31.12.2021. Auditimi është kryer duke mbajtur në konsideratë Standardet Ndërkombëtare të Auditimit (ISSAI), Manualin e auditimit financiar të KLSH-së, Rregulloren e procedurave të auditimit të KLSH-së, Kodin e etikës, si dhe praktikat më të mira audituese të fushës.

Auditimi u fokusua në përmbushjen e detyrave dhe përgjegjësi kryesore nga Bashkia Has si planifikimi, hartimi dhe realizimi i zërave të shpenzimeve buxhetore, realizimi dhe përdorimi i të ardhurave nga taksat dhe tarifat vendore; auditim me zgjedhje i transaksioneve financiare nëse janë në përputhje me kërkesat ligjore; mbajtjen e evidencës kontabël, etj.

Në mënyrë të përmbledhur nga auditimi rezultoi se:

- Në Bashkinë Has struktura e Auditit të Brendshëm nuk është funksionale pasi ka vetëm një specialist dhe për vitin 2021 nuk është planifikuar dhe realizuar asnjë auditim;
- Detyrime për investime, mallra e shërbime në datë 31.12.2021 janë në vlerën **19,089,192 lekë**;
- Sektori i Tatimeve nuk ka të dhëna lidhur me numrin e familjeve që kanë detyrimin për të paguar tarifën e pastrimit dhe taksën e ndërtesës, nuk ka të dhëna lidhur me nivelet e pritshmërisë së tyre si dhe nuk ka të dhëna se sa është numri i familjeve që janë debitoare ndaj bashkisë. Gjithashtu, familjet në Bashkinë Has nuk ngarkohen me detyrimet vendore për taksat dhe tarifat e tjera të miratuara me Vendim të Këshillit Bashkiak, si për shembull taksa e tokës bujqësore, taksa e truallit, tarifa e gjelbërimit;
- Borxhi i krijuar gjatë vitit 2021 është në shumën 4,166,512lekë dhe përbëhet nga detyrimet nga taksat dhe tarifat për personat fizikë/juridikë në shumën 3,419,026 lekë, detyrimet nga institucionet shtetërore në shumën 104,240 lekë dhe detyrimet nga qiratë e tregut në shumën 643,246 lekë.
- Të ardhurat e munguara në buxhetin e Bashkisë Has nga detyrimet për taksat dhe tarifat vendore që taksapaguesit kanë deri më 31.12.2021 janë në vlerën **32,867,505 lekë**;
- Detyrimet nga mos pagesa e taksës së ndikimit në infrastrukturë për objekte që janë legalizuar që nga viti 2017 deri në 31.12.2020 janë në vlerën **9,282,639 lekë për 239 objekte**;
- Inspektorati i Mbrojtjes së Territorit Vendor nuk ka funksionuar si rezultat i mos plotësimit të pozicionit të Kryeinspektorit;
- Nga auditimi i llogarisë 202 ôStudime dhe Kërkimeô, konstatohet se vlera e studimeve dhe projekteve të paraqitura në bilanc, përfshin edhe objekte të përfunduara përpara vitit ushtrimor 2021, duke sjellë vlerësimin jo real të llogarisë 202 dhe AAJM, në vlerën 1,613,998 lekë;
- Nuk ka informacion justifikues mbi origjinën e krijimit të diferencës prej 6,511,356 lekë që rezulton nga krahasimi i llogarisë 468 ôDebitorë të ndryshëmô me vlerën e bilancit prej 67,319,252 lekë me atë analitike prej 60,807,896 lekë;

Bazuar në rezultatet e auditimit në Bashkinë Has, KLSH ka dhënë ôOpinion të modifikuarô për pasqyrat financiare.

Referuar gjetjeve të auditimit për përmirësimin e gjendjes janë dhënë rekomandimet përkatëse të klasifikuara në rekomandime organizative dhe rekomandime për arkëtimin e të ardhurave të munguara.

1. Përshkrim i shkurtër i Projektit të Auditimit

Auditimi mbuloi çështjet kryesore të veprimtarisë së Bashkisë Has si: menaxhimi financiar dhe kontrolli, auditimi i brendshëm, planifikimi dhe zbatimi i buxhetit, të ardhurat, vlerësimi i pasqyrave financiare dhe zbatimi i rekomandimeve të lëna në auditimin e mëparshëm. Për analizimin dhe vlerësimin e aktivitetit të subjektit sipas pikave të planifikuara në programin e auditimit, grupi i auditimit vlerësoi sistemet e kontrollit të brendshëm dhe analizoi të gjitha evidencat e grumbulluara gjatë kryerjes së auditimit në terren sipas çështjeve përkatëse.

Në përfundim të punës audituese në terren, grupi i auditimit ka mbajtur dhe protokolluar në Bashkinë Has 4 akt konstatime dhe 1 akt verifikim. Mbi akt konstatimet dhe akt verifikimet e mbajtura nga grupi i auditimit si dhe mbi projekt raportin e auditimit janë paraqitur observacione nga Bashkia Has të cilat janë trajtuar në përputhje me përcaktimet e Rregullores së procedurave të auditimit të KLSH.

Subjekti nuk ka kërkuar organizim të takimit përmbyllës në KLSH.

2. Përshkrim i gjetjeve kryesore dhe rekomandimeve

Nr.	Përmbledhje e gjetjeve	Rëndësia	Rekomandimi
1	Struktura e auditit të brendshëm për vitin 2021 ka funksionuar vetëm me një auditues, nga tre që përcakton kuadri rregullator në fuqi. Rezulton se për vitin 2021 nga Bashkia Has nuk është planifikuar dhe realizuar asnjë auditim, duke mos kryer detyrën funksionale dhe duke mos i dhënë titullarit të njësisë publike këshilla për përmirësimin e veprimtarisë dhe efektivitetin e sistemit të kontrollit të brendshëm, si dhe siguri për realizimin e objektivave. (faqe 14-19 të RPA)	E lartë	Bashkia Has të marrë masa për ngritjen e strukturës së Njesisë së Auditit të Brendshëm, që të jetë një mbështetës për njësinë e auditimit të brendshëm si dhe një organ i pavarur, monitorues e këshillëdhënës për titullarin e njësisë ose, shërbimi i auditit të brendshëm të kryhet nga njësia e auditit të brendshëm të një njësie tjetër publike, në bazë të një marrëveshje ndërmjet titullarëve të njësive publike përkatëse.
2	Nga auditimi u konstatua se nuk janë marrë masa të plota për likuidimin e detyrimeve të prapambetura, pasi nga njëra anë kryhen pagesa gjatë vitit për detyrimet e trashëguara ndër vite, por gjithashtu gjatë vitit buxhetor krijohen detyrime të reja të prapambetura. Në fillim të vitit buxhetor 2021 detyrimeve e prapambetura kanë vlerën 28,833,238 lekë, prej të cilave është likuiduar vlera 13,920,155 lekë, por është krijuar detyrim i ri në vlerën 4,176,110 lekë, duke e çuar vlerën e këtyre detyrimeve më 31.12.2021 në vlerën 19,089,192.8 lekë. (faqe 19-38 të RPA)	E lartë	Kryetari i Bashkisë Has dhe Drejtoria Ekonomike, të marrin masa për likuidimin e vlerës së kontratave të lidhura midis Bashkisë Has dhe kontraktorëve, brenda afatit 30 ditor pas ardhjes së faturës tatimore, duke eliminuar në këtë mënyrë shkakun e krijimit të detyrimeve të reja prapambetura. Lidhja e kontratës të bëhet vetëm pasi fondi që parashikon procedura e prokurimit do të jetë në dispozicion (në llogarinë e thesarit) të autoritetit kontraktor.
3	Bashkia Has, Sektori i Taksave dhe Tarifave Vendore nuk ka të dhëna lidhur me numrin e familjeve që kanë detyrimin për të paguar tarifën e pastrimit, ndriçimit, gjelbërimit dhe taksën e ndërtesës, nuk ka të dhëna lidhur me nivelet e pritshmërisë së tyre si dhe nuk ka të dhëna se sa është numri i familjeve që janë debitore ndaj bashkisë. Gjithashtu, familjet në Bashkinë Has nuk ngarkohen për detyrimet vendore për taksat dhe tarifën e tjera të miratuara me Vendim të Këshillit Bashkiak. Procesi i llogaritjes së detyrimit të familjeve për taksat dhe tarifën vendore nuk është i dokumentuar dhe ka informacion mbi numrin e	E lartë	Bashkia Has, Sektori i Taksave dhe Tarifave Vendore të marrë masa për krijimin e regjistrit të taksave dhe tarifave vendore për taksapaguesit e kategorisë familjare me të gjitha të dhënat e nevojshme, i cili të shërbejë si bazë për të bërë llogaritjen e detyrimeve vendore që ju lindin familjeve referuar paketës fiskale të miratuar të Bashkisë Has.

	familjeve debitore dhe vlerën totale që ato kanë ndaj bashkisë. <i>(faqe 19-38 të RPA)</i>		
4	Në Bashkinë Has për vitin 2021 nuk është ngritur si strukturë e veçantë Inspektorati Mbrojtjes së Territorit Vendor. Në strukturën aktuale të bashkisë identifikohen 2 punonjës të emëruar në pozicionin e inspektorit të terrenit (1 në Sektorin e Planifikimit të Territorit dhe Urbanistikës dhe 1 në NjA Golaj). Këto punonjës edhe pse me detyrë inspektor terreni nuk e bëjnë funksionale strukturën e IMTV-së si rezultat i mungesës së Kryeinspektorit, i cili ka kompetencat ligjore për të nënshkruar marrjen e masave dhe dhënien e sanksioneve administrative. <i>(faqe 19-38 të RPA)</i>	E lartë	Kryetari i Bashkisë të marrë të gjitha masat për të krijuar të plotë strukturën e Inspektoratit të Mbrojtjes së Territorit në Bashkinë Has me qëllim zbatimin e ligjshmërisë në fushën e kontrollit dhe zhvillimit të territorit.
5	Llogaria 468 óDebitor të ndryshëm, në pasqyrat financiare ka vlerën 67,319,252,lekë, ndërsa analiza e kësaj llogarie në librat e kontabilitetit ka vlerën 60,807,896 lekë, situatë e cila tregon se për diferencën prej 6,511,356 lekë midis këtyre dy vlerave, nuk ka dokumentacion justifikues, i cili të shpjegojë origjinën e krijimit të këtij detyrimi ndaj njësisë vendore. Në bilanc nuk janë futur detyrimet e nxjerra nga auditimi i mëparshëm i KLSH-së mbi individët dhe furnitorët debitor nga mos arkëtimi i dëmeve ekonomike edhe pse janë rekomandime të pranuar për tu zbatuar. <i>(faqe 38-56 të RPA)</i>	E lartë	Nëpunësi Zbatues, të përfshijë në llogarinë 468 óDebitor të ndryshëm edhe dëmet e konstatuara nga KLSH në auditimet e mëparshme si dhe të justifikojë diferencën prej 6,511,356 lekë të llogarisë 468 óDebitorë të ndryshëm.
6	Nga verifikimi i analizës analitike të llogarisë 202 óStudime dhe Kërkime, konstatohet se vlera e studimeve dhe projekteve të paraqitura në bilanc, i përkasin edhe objekteve të përfunduara përpara vitit ushtrimor 2021, duke kryer vlerësimin jo real të llogarisë 202 dhe AAJM, në vlerën 1,613,998 lekë. <i>(faqe 38-56 të RPA)</i>	E lartë	Nëpunësi Zbatues, të kryej veprimet e sistemit për llogarinë 202 óStudime dhe Kërkime duke siguruar përfshirjen në këtë llogari të studimeve dhe kërkimeve vetëm për objektet ende të papërfunduara në vitin ushtrimor të mbylljes së bilancit.
7	Aktivët afatgjatë materiale të llogarisë 212 óNdërtesa e Konstruksione në vlerën 733,469,916 lekë, janë kontabilizuar në librat e kontabilitetit dhe pasqyrat financiare pa u mbështetur në një dokumentacion vërtetues, siç është titulli i pronësisë, ku gjatë auditimit u evidentua se Bashkia Has nuk ka iniciuar procesin për regjistrimin e tyre. <i>(faqe 38-56 të RPA)</i>	E lartë	Titullari i Bashkisë Has dhe Nëpunësi Zbatues të marrin masa për nisjen e procesit të regjistrimit pranë ASHK-së së aktiveve afatgjatë materiale për llogari të Bashkisë Has.
8	Nga auditimi dhe kontrolli i pagesave për investimet e Bashkisë Has nga sistemi SIFQ i thesarit, janë identifikuar pagesa faturash të cilat paraqiten të likuiduara në 2022, por të paregjistruara në detyrimet e prapambetura të vitit 2021. Mosparaqitja e tyre në kontabilitet, edhe pse janë kompetencë e vitit ushtrimor 2021 ka nënvlerësuar llogarinë 467 óKreditorë të ndryshëm me 3,173,309 lekë për vitin 2021. Kjo procedurë mos pasqyrimi në llogarinë 467 óKreditorë të ndryshëm të detyrimeve për faturat e likuiduara në 2022, por me kompetencë vitin 2021, përbën mos pasqyrim të drejtë të informacionit financiar, duke qenë se detyrimet e prapambetura për vitin 2021 të përcjella në Ministrinë e Financave janë nënvlerësuar me 3,173,309 lekë. <i>(faqe 38-56 të RPA)</i>	E lartë	Titullari i Bashkisë Has në bashkëpunim me Drejtorinë e Financës dhe Buxhetit të bëjnë sistemit për të pasqyruar në llogarinë 467 óKreditorë të ndryshëm detyrimet për faturat e likuiduara 3,173,309 lekë për vitin 2021. Gjithashtu, pas saktësimit të detyrimeve të prapambetura, duhet të merren masa për raportimin e tyre në Ministrinë e Financave, raportim i cili aktualisht nuk është real.
9	Nga auditimi i ecurisë së pagesave për taksën e ndikimit në infrastrukturë nga legalizimet rezulton se në Bashkinë Has ka detyrime të pa paguara për objekte që janë legalizuar që nga viti 2017 deri në 31.12.2020 në vlerën 9,282,639 lekë për 239 objekte që përbën të ardhura të munguara në	E lartë	Sektori i Planifikimit, të Territorit dhe Urbanistikës në Bashkinë Has të dërgojë periodikisht informacion në Sektorin e Taksave dhe Tarifave Vendore mbi subjektet debitorë për óTaksën e ndikimit në infrastrukturë për legalizimet dhe në

	buxhetin e Bashkisë Has. Për vitin 2021 Bashkia Has nuk ka marrë asnjë shkresë nga ASHK për objektet që mund të jenë legalizuar gjatë këtij viti. Gjithashtu, bashkia nga ana e saj nuk ka dërguar asnjë shkresë drejt ASHK-së për të kërkuar informacion. <i>(faqe 19-38 të RPA)</i>		bashkëpunim të marrin masa administrative e ligjore për arkëtimin e taksës së ndikimit në infrastrukturë për 239 debitorë në vlerën 9,282,639 lekë si dhe në vijimësi nga të gjitha ndërtimet e reja që legalizohen. Gjithashtu, nga strukturat e Bashkisë Has të bashkëpunohet me Agjencinë Shtetërore të Kadastrës (ASHK), për të marrë informacion periodik lidhur me legalizimet e reja që kryhen si dhe për bllokimin e veprimeve në dhënien e certifikatës së pronësisë deri në kryerjen e pagesave të taksës së ndikimit në infrastrukturë.
10	Nga auditimi i të dhënave lidhur me detyrimet që tatimpaguesit kanë ndaj Bashkisë Has rezultoi se gjatë vitit 2021 borxhi i krijuar është në shumën 4,166,512lekë dhe përbëhet nga detyrimet nga taksat dhe tarifat për personat fizikë/juridikë në shumën 3,419,026 lekë, detyrimet nga institucionet shtetërore në shumën 104,240 lekë dhe detyrimet nga qiratë e tregut në shumën 643,246 lekë. Detyrimet për taksat dhe tarifat vendore më mënyrë progresive më 31.12.2021 në Bashkisë Has janë në vlerën 32,867,505 lekë të përbëra nga: - Detyrimet nga taksat dhe tarifat e bizneseve, detyrime nga autorizimet e subjekteve hidrokarbure, detyrime nga kontratat e fondit pyjor kullosor (kontrata aktive dhe jo aktive) rezultojnë në vlerën totale 26,643,184 lekë për 187 biznese; - Qira të ambienteve të tregut (Markata) detyrime në vlerën 3,743,941 lekë; - Detyrime nga kontratat e dhënies me qira të aseteve në vlerën 2,325,900 lekë; - Detyrime nga institucione publike në vlerën 154,480 lekë. Rezultoni se Bashkia Has nuk ka aplikuar të gjitha masat e duhura ligjore për subjektet që nuk kanë paguar detyrimet për taksat dhe tarifat vendore. <i>(faqe 19-38 të RPA)</i>	E lartë	Spektori i Taksave dhe Tarifave Vendore në Bashkinë Has, të marrë masa për nxjerrjen e njoftimit të vlerësimit tatimor për debitorët, duke ndjekur të gjitha rrugët për arkëtimin e detyrimeve për taksat dhe tarifat vendore në fund të vitit 2021 në vlerën: - 26,643,184 lekë për 187 subjekte private; - 3,743,941 lekë për qiratë e ambienteve të tregut; - 2,325,900 lekë nga kontratat e dhënies me qira të aseteve; - 154,480 lekë nga institucione publike; <i>a-T'u dërgohen bankave të nivelit të dytë urdhër bllokimit e llogarive bankare.</i> <i>b-Të dërgohet në Drejtorinë Rajonale të Transportit, kërkesa për vendosjen e barrës sigurose (për mjetet) dhe në ASHK (për pasuritë e paluajtshme).</i> <i>c-Në funksion të mbledhjes së detyrimit të papaguar, Spektori i Taksave dhe Tarifave Vendore, të angazhohet për të verifikuar dhe monitoruar në vend aktivitetin tregtar të tatim paguesit, me qëllim konfiskimin në fund të çdo dite të një shume jo më pak se 50 % të qarkullimit të realizuar.</i> <i>d- Nëse edhe pas njoftimeve zyrtare subjektet, nuk pranojnë të paguajnë detyrimet, nga ana e Spektorit të Taksave dhe Tarifave Vendore, të merren masa administrative apo sekuestro dhe pas marrjes së këtyre masave të bëhet kallëzim penal.</i> <i>e-Spektori i Taksave dhe Tarifave Vendore të bashkërendojë punën me QKB Bashkia Has, për mos kalimin e subjekteve debitorë me status pasiv ose mbyllje dhe lejimin e tyre në debitorë të keq.</i>

3. Konkluzioni i përgjithshëm dhe Opinioni i auditimit

Konkluzion i përgjithshëm¹:

Në përfundim të auditimit financiar të ushtruar në Bashkinë Has, për periudhën e veprimtarisë nga 01.01.2021 deri në 31.12.2021, në zbatim të Programit të Auditimit 569/1 datë 13.06.2022, nga Kryetari i KLSH-së, Grupi i auditimit ka arritur në konkluzionin se subjekti i audituar në përgjithësi ka vepruar në përputhje me aktet ligjore dhe nënligjore, të cilat kanë shërbyer si

¹Manuali i Auditimit të Përpunshmërisë, Kapitulli VII, pika 7.3.1 Angazhimet e Raportimit të Drejtpërdrejtë/ [me siguri të arsyeshme].

kritere vlerësimi, por ka konstatuar edhe disa anomali të rëndësishme por jo të përhapura të cilat janë trajtuar gjerësisht në këtë raport auditimi.

Nga auditimi dhe vlerësimi mbi funksionimin e sistemit të kontrollit të brendshëm konkludojmë se përgjithësisht ka probleme për funksionimin e sistemit të kontrollit të brendshëm, ka përmirësime në krahasim me periudhën e mëparshme të audituar nga KLSH, në lidhje me mjedisin e kontrollit ku ushtron veprimtarinë subjekti, si dhe nuk ka kryer aktivitete kontrolli, për minimizimin e risqeve veçanërisht në menaxhimin e aktiveve. Ka nevojë për të evidentuar, monitoruar risqet e auditimit si dhe për të rritur nivelin e transparencës.

Opinion i auditimit mbi pasqyrat financiare:

KLSH auditoi pasqyrat financiare të Bashkisë Has, për vitin ushtrimor 2021, të cilat përfshijnë pasqyrat e pozicionit financiar, pasqyrat e performancës financiare, pasqyrat e ndryshimeve të aktiveve, pasqyrat e fluksit të mjeteve monetare dhe pasqyrat e shënimeve shpjeguese. Auditimi ka përfshirë ekzaminimin, në bazë testimesh të dokumenteve që mbështesin shumat në pasqyrat financiare, vlerësimin i parimeve kontabël të përdorura si dhe vlerësimin e paraqitjes së përgjithshme të pasqyrave financiare.

Opinion i modifikuar²

Ó Sipas opinionit tonë, mbështetur në standardet ISSAI 1705 dhe ISSAI 1200, pasi kemi marrë evidenca dhe dëshmi të mjaftueshme të përshtatshme dhe të besueshme të auditimit, shprehim një opinion të modifikuar për llogaritë vjetore të vitit 2021 të subjektit Bashkia Has, duke arritur në përfundimin se anomali të apo rastet e mospërputhshmërisë, individualisht ose së bashku, janë materiale por jo të përhapura, të cilat janë të shprehura te baza për opinionin e auditimit. Në llogaritë vjetore apo transaksionet të vitit 2021, pasqyrat financiare, nuk paraqesin në mënyrë të drejtë, pozitën financiare të Bashkisë Has në datën 31 dhjetor 2021, referuar Standardeve Kombëtare të Kontabilitetit (SKK), si dhe Udhëzimit nr. 8, datë 03.09.2018, ndryshuar me Udhëzimin nr. 5, datë 21.02.2022, mbi të cilat subjekti i audituar është mbështetur për përgatitjen e pasqyrave financiare vjetore.

Baza për opinionin e modifikuar

Ne e kryem auditimin në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Auditimit (SNA-të). Përgjegjësitë tona, sipas këtyre standardeve janë përshkruar në mënyrë më të detajuar në seksionin e raportit, ku jepen përgjegjësitë e audituesit për pasqyrat financiare. Ne jemi të pavarur nga Bashkia Has, sipas kërkesave etike që janë të zbatueshme për auditimin e pasqyrave financiare dhe kemi përmbushur përgjegjësitë e tjera etike, në përputhje me këto kërkesa. Ne besojmë se evidenca e auditimit që kemi siguruar është e mjaftueshme dhe e përshtatshme për të marrë siguri të arsyeshme, si dhe për të bazuar dhënien e opinionit tonë. (ISA 700).

Opinion i mësipërm i auditimit mbështetet në nivelin e materialitetit të llogaritur nga grupi i auditimit në vlerën 18,852,691 lekë, si dhe në anomali të konstatuara si më poshtë:

Përshkrimi i rasteve:

²Opinion i modifikuar jepet në ato raste kur Pasqyrat Financiare përmbajnë gabime materiale, të cilat çojnë në ndryshim të rezultatit financiar, ose kur nga auditimi nuk sigurohet evidencë e mjaftueshme dhe e duhur financiare për të mbështetur dhënien e opinionin, por që në gjykimin profesional të audituesit mund të ketë gabime materiale të cilat sjellin ndryshim të rezultatit financiar.

Rastet e mospërputhshmërisë në pasqyrat financiare të mbyllura në 31 Dhjetor 2021 paraqitet në si më poshtë:

Janë regjistruar në librat e kontabilitetit pa u mbështetur në dokumentacion justifikues si ai i titullit të pronësisë këto llogari :

- Llogaria 212 ôNdërtesa e Konstruksioneô në vlerën 733,469,916 lekë;

-Llogaria 467 óKreditorë të ndryshëmô është në vlerën 19,089,193 lekë dhe duhet të jetë 22,262,502 lekë, me një devijim prej 3,173,309 lekë;

- Llogaria 210 óToke, Troje, Terreneô nuk ka vlerë kontabël në pasqyrat financiare, por nga auditimi u konstatua se Bashkia Has administron një numër të konsiderueshëm pronash që përfshihen në këtë llogari, të cilat kanë qenë pjesë e ish komunave, dhe janë transferuar në Bashinë Has;

-Llogaria 211 óPyje, Kullota, Plantacioneô nuk ka vlerë kontabël.

-Llogaria 26 óPjesëmarrje në kapitalin e vetô është në vlerën 0 lek dhe duhet të jetë 73,334,000 lekë;

- Llogaria 466 óKreditorë për mjete në ruajtjeô është në vlerën 7,918,848 lekë dhe duhet të jetë 7,615,273 lekë, me një devijim prej 303,575 lekë;

Çështje të tjera: Sipas Ligjit nr. 10296, ku përfshihet menaxhimi financiar dhe kontrolli i brendshëm, si dhe auditit i brendshëm:

Bashkia Has, ka probleme të konsiderueshme në mos funksionimin e sistemit të kontrollit të brendshëm dhe në aktivitetin e auditit të brendshëm. Këto anomali janë konstatuar edhe në auditimin e mëparshëm të kryer nga KLSH, por nuk janë marrë masa për përmirësimin e gjendjes. Konkretisht; në komponentit ôMjedisi i kontrollitô. Nuk është ngritur GMS, struktura nuk është plotësuar me të gjithë punonjësit, duke lënë bosh disa pozicione të rëndësishme, nuk është miratuar strategjia e menaxhimit të riskut, struktura e AB nuk funksionon. Për këto arsye, bazuar në gjykimin profesional të audituesve, funksionimi i sistemit të kontrollit u vlerësua me nivel risku të lartë, gjë që u mor në konsideratë në përcaktimin e riskut të auditimit dhe përcaktimin e testeve analitike të kryera në këtë auditim.

Përgjegjësitë e Drejtuesve të Bashkisë Has:

Strukturat drejtuese të Bashkisë Has, janë përgjegjëse për përdorimin e burimeve financiare në përputhje me politikat, ligjet dhe rregulloret e aplikuara (kriteret e vlerësimit). Ato janë përgjegjëse për zbatimin e gjithë kuadrit rregullativ në menaxhimin e fondeve të alokuara për realizimin e objektivave funksional. Gjithashtu, strukturat drejtuese të Bashkisë Has janë përgjegjëse funksionimin e sistemit të kontrollit të brendshëm, hartimin e procedurave, aktiviteteve të kontrollit, gjurmës së auditimit dhe hartës së proceseve të punës.

Përgjegjësitë e Audituesve të KLSH mbi Auditimin:

Objektivi i audituesit të jashtëm publik lidhet me garantimin e sigurisë së arsyeshme³, nëse veprimtaria e subjektit të audituar është zhvilluar në përputhje me kriteret e paracaktuara, si dhe për të konkluduar me një raport auditimi që përfshin një opinion. Siguria e arsyeshme është një nivel i lartë sigurie, por nuk garanton që auditimi i kryer në përputhje me standardet mundëson identifikimin e çdo gabimi apo anomalie që mund të ekzistojë. Përveç standardeve ISSAI,

³ISA 200-ISSAI 2200 Objektivi i audituesit është të ofrojë siguri të arsyeshme nëse pasqyrat si një e tërë nuk përmbajnë anomali materiale, raste mashtrimi ose gabime, si edhe të raportojë mbi këto pasqyra për sa i takon gjetjeve të tij/saj.

audituesi i KLSH, gjithashtu aplikon edhe gjykimin dhe skepticizmin e tij profesional në punën audituese.

Auditimi identifikon çështjet më të rëndësishme lidhur me zbatueshmërinë e kriterëve të vlerësimit, kuadrin ligjor dhe rregullator nga ana e subjektit, me përjashtim të rasteve kur kuadri ligjor nuk lejon vënien në dispozicion të tyre për publikun ose në raste të rralla kur vetë ne vendosim që këto çështje nuk duhet të përfshihen në raport për shkak të pasojave negative që publikimi i tyre mund të sjellë në publikun e gjerë.

II. HYRJA

Mbështetur në ligjin nr. 154/2014, datë 27.11.2014 óPër Organizimin dhe Funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit dhe në zbatim të Programit të Auditimit nr. 569/1 Prot, datë 13.06.2022, miratuar nga Kryetari i KLSH-^{së}, nga data 13.06.2022 deri në datën 08.07.2022, në subjektin Bashkia Has u krye óAuditimi Financiaró për periudhën 01.01.2021në 31.12.2021.Grupi i auditimit përbëhej nga audituesit:

1. E.V në *Përgjegjëse Grupi*
2. E.K në *Audituese*
3. E.S në *Audituese*

1. Objektivat e auditimit

Auditimi Financiar në Bashkinë Has ka si objektiva kryesor:

- Vlerësimin nëse aktivitetet, transaksionet financiare dhe informacionet janë në të gjitha aspektet materiale ose jo, në përputhje me kuadrin ligjor e rregullator mbi bazën e të cilit subjekti që auditohet ushtron veprimtarinë e tij;
- Vlerësimin e zbatimit të kuadrit ligjor në fuqi, duke vlerësuar risqet e anomalive materiale në pasqyrat financiare dhe nivelin e pohimeve, nëpërmjet të kuptuarit të njësisë dhe mjedisit të saj, duke krijuar kështu bazën për hartimin dhe implementimin e përgjigjeve kundrejt risqeve të vlerësuara dhe gabimeve materiale (ISSAI 1315)⁴;
- Dhënien e opinionit mbi pasqyrat financiare mbi bazën e nivelit të materialitetit dhe vlerësimit të risqeve, si dhe identifikimit të gabimeve, bazuar në standardet ISSAI;
- Hartimi i Raportit të Auditimit dhe dhënia e rekomandimeve për përmirësimin e gjendjes, mbi bazën e vlerësimeve të gjetjeve, të cilat mbështeten mbi evidenca të besueshme, të mjaftueshme dhe të përshtatshme.

2. Qëllimi i auditimit

Objektivi i auditimit financiar në Bashkinë Has është dhënia e opinionit me siguri të arsyeshme, për periudhën nën auditim 01.01.2021-31.12.2021, mbi transaksionet financiare dhe ngjarjet ekonomike nëse janë raportuar drejt dhe saktë në pasqyrat financiare të subjektit të audituar, kjo referuar kuadrin ligjor të raportimit financiar në fuqi.

3. Identifikimi i çështjes

Raporti i Auditimit synon të identifikojë përmbushjen e rolit të strukturave të Bashkisë Has dhe përgjegjësi, që burojnë nga kuadri ligjor dhe dispozitat në fuqi, për përmirësimin e vazhdueshëm të punëve në shërbim të komunitetit, në funksion të zbatimit të strategjive që

⁴Në zbatim të përcaktimeve të Manualit të Auditimit Financiar të KLSH-së.

orientojnë zhvillimin e bashkisë, si dhe përmirësimin e vazhdueshëm të cilësisë së shërbimit ndaj komunitetit në plotësimin e kërkesave të tyre.

Çështjet mbi të cilat është shtrirë auditimi:

Pika 1. Mbi menaxhimin financiar, kontrollin dhe auditin e brendshëm.

Pika 2. Mbi planifikimin dhe zbatimin e planit të buxhetit, burimi i krijimi të të ardhurave, vlerësimi i mbledhjes së tyre.

Pika 3. Vlerësimi i raportimit financiar për vitin 2021.

Pika 4. Mbi zbatimin e rekomandimeve të lëna në auditimin e mëparshëm.

4. Përgjegjësitë e strukturave drejtuese

Strukturat drejtuese të Bashkisë Has, janë përgjegjëse për paraqitjen e drejtë të pasqyrave financiare në përputhje me në përputhje me kuadrin rregullator të zbatueshëm të raportimit financiar në sektorin publik. Ato janë përgjegjëse për aktivitetin financiar, në përputhje me kriteret e përputhshmërisë duke përfshirë, por pa u kufizuar në ligjin e buxhetit dhe aktet nënligjore në zbatim të tij, ligjin për menaxhimin financiar dhe kontrollin dhe aktet nënligjore në zbatim të tij, ligjin për auditin e brendshëm dhe aktet nënligjore në zbatim të tij.

5. Përgjegjësitë e audituesve

Përgjegjësia e grupit të auditimit është që të shprehë një opinion në lidhje me pasqyrat financiare në zbatim të akteve ligjore dhe nënligjore. Auditimi është kryer në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Auditimit ISSAI, të cilat kërkojnë që audituesi të respektojë kërkesat etike, të planifikojë dhe të kryejë auditimin me qëllim arritjen e një sigurie të arsyeshme në dhënien e opinionit, mbështetur në evidencat e grumbulluara të auditimit. Siguria e arsyeshme i referohet një niveli të pranueshëm sigurie, por nuk garanton asnjëherë sigurinë absolute. Auditimi në pajtueshmëri (apo në përputhje) me standardet nuk presupozohet që të zbulojë gjithnjë një gabim material kur ai ekziston.

6. Kriteret e vlerësimit

Grupi i auditimit për të vlerësuar aktivitetin e Bashkisë Has është mbështetur në kuadrin ligjor, nënligjor dhe rregullativ të listuar më poshtë. Ky kuadër ligjor ka shërbyer si bazë për burimin e kritereve që ka hartuar grupi i auditimit kundrejt të cilave janë vlerësuar aktivitetet e Bashkisë Has. Burimet e kritereve të vlerësimit janë:

- Ligji organik i KLSH-^{së} nr. 154/2014, datë 27.11.2014 óPër Organizimin dhe Funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit;
- Ligji nr. 139/2015 dt. 17.12.2015 óPër vetëqeverisjen vendore;
- Ligji nr. 68/2017, datë 27.04.2017 óPër financat e vetëqeverisjes vendore;
- Ligji nr. 10296, datë 08.07.2010 óPër menaxhimin financiar dhe kontrollin, i ndryshuar;
- Ligji nr. 9936, datë 26.06.2008 óPër menaxhimin e Sistemit Buxhetor në Republikën e Shqipërisë, i ndryshuar;
- Ligji nr. 9632, datë 30.10.2006 óPër Sistemin e Taksave Vendore i ndryshuar;
- Ligji Nr. 88/2019, datë 18.12.2019 óPër buxhetin e vitit 2020;
- Ligji nr. 9780, datë 06.07.2007 óPër Inspektimin dhe Mbrojtjen e Territorit nga Ndërtimet e Kundërligjshme, i ndryshuar;
- Ligji nr. 107/2014, datë 31.07.2014 óPër planifikimin dhe zhvillimin e territorit;
- Ligji nr. 10279, datë 20.5.2010 óPër kundërvajtjet administrative;
- VKM nr. 894, datë 04.11.2015 óPër unifikimin e procedurave të kontrollit të territorit nga Inspektorati Kombëtar i Mbrojtjes së Territorit dhe ai i Njesisë Vendore;

- VKM nr. 783, datë 22.11.2006 óPër përcaktimin e standardeve dhe të rregullave kontabëló;
- Udhëzimi i MFE nr. 5, datë 27.12.2014 óPër shlyerjen e detyrimeve të prapambeturaó;
- Udhëzimi MFE nr. 2 datë 20.01.2020 óPër zbatimin e Buxhetit të vitit 2020ó;
- Udhëzimi MFE nr. 21, datë 25.10.2016 óPër nëpunësit zbatues të të gjitha niveleveó;
- Udhëzimin i MFE nr. 22, datë 30.07.2018 óPër procedurat standarde të monitorimit të buxhetit të Njësive të Vetëqeverisjes Vendoreó;
- UMF nr. 30, datë 27.12.2011, óPër menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publikó, i ndryshuar;
- Udhëzimi i MF nr. 08, datë 09.03.2018 óPër procedurën e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore të njësive të Qeverisjes së Përgjithshmeóetj.

7. Standardet e auditimit

Për kryerjen e Auditimit Financiar në Bashkinë Has grupi i auditimit ka ndjekur edhe standardet ndërkombëtare të auditimit si më poshtë:

- ISSAI 100 óParimet themelore të auditimit të sektorit publikó;
- ISSAI 200 óParimet themelore të auditimit financiaró;
- ISSAI 2200-2899 "Standardet e auditimit financiar";
- Standardet Ndërkombëtare të Auditimit (SNA) të Federatës Ndërkombëtare të kontabilistëve IFAC.

8. Metodologjia e auditimit

1. Kontrolli aritmetik.

Duke konsideruar faktin se kontabiliteti konsiston në thelb në regjistrimin e fakteve në një formë numerike, si dhe në paraqitjen sintetike të tyre, por midis regjistrimit fillestar të fakteve dhe paraqitjes së tyre në formë sintetike, që janë edhe qëllimi i tij, bëhen një seri veprimesh që kanë të bëjnë me evidentimin në llogari, mbartjet, klasifikimin dhe rigrupimin. Kontrolli aritmetik u krye me qëllim që të sigurohemi nëse veprimet e llogaritjes dhe të hedhjeve në llogaritë përkatëse, që përfundojnë me nxjerrjen e gjendjeve sintetike, nuk përmbajnë asnjë gabim.

2. Kontrolli me anë të pjesëve justifikuese.

Edhe pse kontabilizimet nuk përmbajnë gabime aritmetike, ato mund të jenë të gabuara, nëse regjistrimet e bëra nuk korrespondojnë me realitetin.

3. Inspektimi fizik dhe kontrolli i gjendjeve ekzistuese.

Konsistoi në ekzaminimin e aktiveve, të llogarive, të librave kontabël etj. Kontrolli kontabël i ushtruar ekzaminoi përputhjen ndërmjet regjistrimit kontabël dhe pjesëve justifikuese përkatëse. Gjithashtu, u krye mbikëqyrje e magazinës për të verifikuar kryerjen e saktë të inventarizimit fizik dhe përputhjet e tij me atë kontabël.

4. Kontrolli i vlerësimit.

Kontrolli i vlerësimeve përcaktoi nëse vlerat që u atribuohen gjendjeve ekzistuese janë të sakta, nëse pasuritë duhet të qëndrojnë në bilanc me vlerat që u janë vendosur atyre.

5. Konfirmim nga të tretët.

Transaksionet e përzgjedhura për tóu nënshtruar testeve të detajeve, u kryqëzuan me informacionin e gjeneruar nga Thesari dhe rakordimet periodike me ente dhe institucione të tjera shtetërore.

6. Kontrolli sipas një treguesi.

Përdorimi i treguesve statistikorë me qëllim që të kërkohen fakte ose të dhëna “jashtë normales”, që përbëjnë tregues të parregullsive kontabël. Mund të përmendim nëse ka mungesa e pjesëve justifikuese, gabimet e shpeshta në datat, numrat, referencat e brendshme, regjistrime pak të lexueshme, shifra të renditura keq, korrigjime të shumta të shifrave, etj.

7. Intervistimi

U kryen intervista me specialistët e Bashkisë Has me qëllim për të kuptuar dhe vlerësuar më mirë problematikat e konstatuara.

8. Raporte dhe Informacione

U shqyrtuan raporte, informacione dhe dokumentacion lidhur me çështjet nën auditim.

Praktikat e ndjekura në kryerjen e auditimit

Mbështetur në standardet ISSAI, audituesit duhet të identifikojnë dhe vlerësojnë risqet e anomalive materiale në pasqyrat financiare si dhe nivelin e pohimeve, nëpërmjet të kuptuarit të njësisë dhe mjedisit të saj, duke përfshirë kontrollin e brendshëm të njësisë dhe duke krijuar kështu bazën për hartimin dhe implementimin e përgjigjeve kundrejt risqeve të vlerësuara të gabimeve materiale⁵.

Sa më sipër grupi i auditimit realizoi vlerësimin e materialitetit në përputhje me ISSAI 1320 dhe ISSAI 1450, duke përcaktuar nivelin e gabimit që audituesi konsideron të mundshëm për të influencuar te përdoruesit e pasqyrave financiare. Nisur nga gjykimi profesional i audituesit dhe ndjeshmëria e zonave të llogarisë, grupi i auditimit përcaktoi materialitetin në masën 2% për të gjitha zonat e llogarisë të planifikuara për t'u audituar, ku si bazë për përllogaritjen e materialitetit janë marrë shpenzimet për paga, shpenzime operative dhe investime.

Pas përcaktimit të nivelit të materialitetit, grupi i auditimit ka kryer vlerësimin e sistemeve të kontrollit të brendshëm në institucion sa i takon: (a) hartimit; (b) implementimit; dhe (c) funksionimit të 5-të komponentëve të kontrollit të brendshëm.

Metodologjia e aplikuar gjatë planifikimit konsiston në auditimin e të dhënave të siguruara nga vetë subjekti. Kemi ndërmarrë procedurat për vlerësimin e riskut (analiza), me qëllim sigurimin e nivelit të kërkuar të njohjes së riskut të brendshëm dhe riskut të kontrollit të subjektit. Informacion të vlefshëm administruam dhe nga procedurat e ndjekura nga vetë subjekti për vlerësimin e riskut, duke ia nënshtruar skepticizmit profesional nga ana e audituesve. Gjatë vlerësimeve u mbështetëm në Modelin e Riskut që KLSH^{ja} aplikon⁶.

Nisur sa më sipër, jemi përpjekur të ruajmë nivelin e pranuar të Riskut të Auditimit prej 5%, duke shtuar nivelin e procedurave analitike (ISSAI 1520) dhe testeve thelbësore të kryera. Në këtë kontekst procedurat e ndjekura nga grupi i auditimit konsistojnë në *analiza* të marrëdhënieve mes informacionit financiar dhe jo financiar; *inspektimeve* që konsistojnë në regjistrimin e dokumenteve në regjistra/ ditarë/ partitarë, ose në trajtë elektronike por edhe inspektime fizike; *observimet* që konsistojnë në analizën e proceseve ose procedurave të kryera nga të tjerë, me qëllim sigurimin e informacionit rreth performancës së proceseve/procedurave, por kjo mbetet e limituar deri në kohën kur observimi ka ndodhur; dhe *së fundi kërkimi/hetimi* që konsiston në kërkimin e informacionit të personat kompetent dhe të mirinformuar brenda dhe/ose jashtë njësisë shpenzuese.

9. Dokumentimi i auditimit

Nga audituesit u përgatit dokumentacioni i auditimit, i konsideruar si i mjaftueshëm për të mundësuar dhe kuptuar natyrën, kohën dhe shtrirjen e procedurave të auditimit, kryer në përputhje me standardet përkatëse dhe kërkesat e zbatueshme ligjore dhe rregullator, rezultatet e këtyre procedurave dhe evidencat e marra të auditimit, si dhe çështje të rëndësishme, që dolën gjatë auditimit, janë reflektuar në përfundimet e arritura në drejtim të tyre dhe gjykimet profesionale në arritjen e këtyre konkluzioneve. Ky dokumentacion është i përshtatshëm dhe i

⁵ISSAI 1315

⁶Risku i Auditimit = Risku i qenësishëm * Risku i kontrollit * Risku i Zbulimit

rëndësishëm për të konfirmuar dhe mbështetur opinionet dhe raportin e audituesve dhe shërben si një burim informacioni për përgatitjen e tyre.

III. PËRSHKRIMI I AUDITIMIT

1. Informacion i përgjithshëm mbi subjektin

Auditimi në subjektin óBashkia Hasô, u krye në kuadër të planifikimit vjetor të subjekteve të përzgjedhura për tóu audituar.

Nga audituesit u përgatit dokumentacioni i auditimit i mjaftueshëm për të mundësuar dhe kuptuar natyrën, kohën dhe shtrirjen e procedurave të auditimit në përputhje me standardet përkatëse dhe kërkesat e zbatueshme ligjore dhe rregullatore. Rezultatet e këtyre procedurave dhe evidencat e marra të auditimit, si dhe çështje të rëndësishme, që dolën gjatë auditimit, janë reflektuar në përfundimet e arritura në drejtim të tyre dhe gjykimet profesionale në arritjen e këtyre konkluzioneve. Ky dokumentacion është i përshtatshëm dhe i rëndësishëm për të konfirmuar dhe mbështetur opinionet dhe raportin e audituesve dhe shërbeu si një burim informacioni për përgatitjen e tyre. Në përgatitjen e materialit dokumentar për planifikimin e auditimit, grupi i auditimit i është referuar auditimeve të kryera në periudhat e mëparshme, dokumentacionit të kërkuar subjektit, të dhënat e grumbulluara për demografinë, auditimeve të realizuara nga Njësia e Auditimit të Brendshëm, fondet e realizuara nga kjo njësi vendore të publikuara në faqen e Thesarit të Ministrisë së Financave.

Bashkia Has është e organizuar dhe funksionon në bazë ligjit nr. 139/2015, datë 17.12.2015 óPër Vetëqeverisjen Vendoreô dhe ligjit nr. 68/2017, datë 27.04.2017 óPër financat e vetëqeverisjes Vendoreô.

Profili i Bashkisë Has

Bashkia Has kufizohet në veri dhe perëndim me Bashkinë Tropojë, në jug me Bashkinë Kukës dhe në lindje me Republikën e Kosovës. Qendra e kësaj bashkie është qyteti i Krumës. Sipas Censusit të vitit 2011, Hasi ka një popullsi prej 16,790 banorësh. Ndërkohë që sipas Regjistrat Civil, ka 21,247 banorë. Bashkia shtrihet në një sipërfaqe prej 399.62 km² me një densitet prej 53.16 banorë/km². Kjo bashki përbëhet nga 4 njësi administrative. Bashkia ka nën administrimin e saj një qytet dhe 29 fshatra. Pasuritë nëntokësore të këtij rajoni kanë nisur të shfrytëzohen në vitet 80 nga italianët. Deri në mesin e viteve 90 ka funksionuar miniera dhe fabrika e pasurimit të bakrit në Golaj, 6 kilometra larg qytetit të Krumës si dhe disa miniera më të vogla, ku ishin të punësuar mbi 3000 punëtorë. Jo vetëm banorët, por edhe specialistët thonë se nëntoka ende nuk është prekur. Për mineralin e bakrit dallohen zona Nikoliq Golaj, Krumë dhe Zahrisht në rrethin e Hasit. Relievi i zonës shtrihet nga rreth 300 metra mbi nivelin e detit deri në malet e larta të Gajrepit, Pashtrikut dhe Maja e Kunorës, të cilat gjenden në lartësitë 1400-1900 metra mbi nivelin e detit.

2. Përshkrimi rezultateve sipas drejtimeve të auditimit

2.1 Mbi menaxhimin financiar, kontrollin dhe auditin e brendshëm

Zbatimii kuadrit rregullator për menaxhimin financiar dhe kontrollin, në Bashkinë Has, për vitin 2021.

I. Mbi mjedisin e kontrollit

Mbi hartimin dhe miratimin e Rregullores Organizative

Për periudhën objekt auditimi Bashkia Has ka funksionuar me Rregullore për organizimin, funksionimin, detyrat dhe kompetencat e administratës së saj në nivel institucional dhe gjithëpërfshirës me nr. 05, datë 03.01.2019.

Kjo rregullore ka si pjese integrale të saj Kodin e Etikës së miratuar me nr. 05/1, datë 03.01.2019., sipas Ligjit nr. 10 296, datë 8.7.2010 Për menaxhimin financiar dhe kontrollin, neni 20; Manualin për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin, Komponentët e Menaxhimit Financiar dhe Kontrollit 3.1. Mjedisi i kontrollit të brendshëm.

Mbi përgatitjen e gjurmës së auditimit

Nga auditimi u konstatua se, nuk janë miratuar gjurmët standarde të auditimit për të gjitha procedurat, proceset dhe transaksionet që lidhen me veprimtarinë kryesore në njësinë publike Bashkia Has, konkretisht në fushat me risk siç janë prokurimet me vlerë më të madhe se 800.000 lekë pa TVSh, prokurimet me vlerë më të vogël se 800.000 lekë pa TVSh, zbatimi i buxhetit, mbledhja e taksave, etj. Kjo sjellë mos dokumentim të operacioneve të njësisë publike në atë formë, që nuk iu mundëson audituesve të brendshëm, të jashtëm dhe autoriteteve mbikëqyrëse të kuptojnë mjedisin e kontrollit. Këto veprime janë në kundërshtim me Ligjin nr. 10 296, datë 8.7.2010 Për menaxhimin financiar dhe kontrollin, neni 16; Manualin për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin, Kap. III óProcesi i implementimit të Menaxhimin Financiar dhe Kontrollit, pika 3.2 óCikli i MFK-së, pika 3.3. Aktivitetet e Kontrollit, Hapi óGjurmët e auditimit.

Mbi rekrutimin e punonjësve në marrëdhëniet e punës:

Për vitin 2021, numri i punonjësve në administratën e Bashkisë Has së bashku me njësitë e varësisë, është gjithsej 258 punonjës sipas Urdhrit nr. 09, datë 11.01.2021 óPër strukturën organizative të Bashkisë Has, nga të cilët në pozicione pune trajtuar sipas ligjit nr. 152/2013 óPër nëpunësin Civil, janë 60 pozicione, nga të cilët 40 pozicione janë me status të nëpunësit civil dhe 20 të klasifikuara si nëpunës civil janë plotësuar me pozicione sipas ligjit nr. 7961, datë 12.07.1995 óKodi i punës i Republikës Shqipërisë i ndryshuar me të cilët janë lidhur kontrata pune tip, 6 pozicione pune janë funksionarë politik (Kryetar, zv. Kryetar, Administratorët e NjA), Funksionarët e deleguar janë 73 vende pune dhe për diferencë 258-142=116 pozicione sipas ligjit nr. 7961, datë 12.07.1995 óKodi i punës i Republikës Shqipërisë i ndryshuar.

Nga 40 vende pune me statusin e nëpunësit civil, nga të cilët:

- 23 punonjës aktualisht janë me statusin e nëpunësit civil;
- 17 punonjës të tjerë janë në zhvillimin e procedurës për dhënien e statusit të nëpunësit civil.

Njësia përgjegjëse e burimeve njerëzore e ngarkuar me menaxhimin e nëpunësve civilë të institucionit si dhe eprori direkt i Bashkisë Has, për vitin 2021 kanë nisur apo zhvilluar procedurat individuale për marrjen e statusit të nëpunësit civil për të gjithë ata punonjës të administratës, të cilët janë të punësuar në pozicionet që trajtohen sipas statusit të nëpunësit civil.

Gjithashtu, janë bërë ndryshime në strukturën organizative, specifikisht largimet si mëposhtë:

1. Urdhri nr. 142, datë 01.04.2021, óPër largim të punonjësit, Bashkia Has;
2. Urdhri nr. 394, datë 30.07.2021, óPër ndërprerje të marrëdhënieve të punës, Bashkia Has;
3. Urdhri nr. 604, datë 19.10.2021, óPër ndërprerje të marrëdhënieve të punës, Bashkia Has.

Nga auditimi u konstatua se, në këto raste të ndryshimeve të emërtimeve të drejtuesve sipas strukturës Organizative, dorëzimi i detyrës si dhe marrja e saj nga persona të tjerë, nuk është bërë me akte dorëzimi dhe inventarizim përkatës, në kundërshtim me kërkesat e VKM nr. 124, datë 17.02.2016 óPër pezullimin dhe lirimin nga shërbimi civiló Kreu III, pika 27 dhe VKM nr. 171, datë 26.03.2014 óPër transferimin e përkohshëm dhe të përkohshëm të nëpunësve civilë, pezullimin dhe lirimin nga shërbimi civiló, Kreu VII, pika 49, 52, 52.

Mbi nivelin e përdorimit të programeve elektronike

Për periudhën objekt auditimi në Bashkinë Has, nuk janë aplikuar programe elektronike për kontrollin, menaxhimin e veprimeve financiare, kontabilizimin dhe pasqyrat financiare si dhe ato për vjeljen e të ardhurave për tatim taksat lokale.

II. Mbi menaxhimin e riskut

Mbi përgatitjen e Strategjisë së Menaxhimit të Riskut

Nga auditimi u konstatua se, nga ana e titullarit të njësisë publike Bashkia Has nuk është hartuar dhe miratuar Strategji e Menaxhimit të Riskut, por është plotësuar vetëm Format i Regjistrimit të Riskut. Kjo sjellë mungesë identifikimi, vlerësimi dhe kontrolli mbi ato ngjarje apo situata të mundshme, që kanë efekt të dëmshëm për përmbushjen e objektivave të njësisë publike. Këto veprime janë në kundërshtim me Ligjin nr. 10296, të datës 08.07.2010, óPër menaxhimin financiar dhe kontrollin, neni 21; Udhëzimi i Ministrisë së Financave nr. 28, datë 15.12.2011 óMbi paraqitjen e deklaratës dhe raportit vjetor për cilësinë e sistemit të kontrollit të brendshëm në njësitë publike; Urdhrin e Ministrit të Financave nr. 8980, datë 15.07.2010.

III. Mbi veprimtaritë e kontrollit

Për vitin 2021, është hartuar Vendimi nr. 34/1, datë 15.01.2020 óPër ngritjen e grupit të menaxhimit strategjik dhe ekupe të menaxhimit të programeve për hartimin e PBA-së 2021-2023, për Bashkinë Has dhe caktimin e Koordinatorit të riskut me urdhër të Kryetarit të Bashkisë nr. 47, datë 01.02.2017, sipas ligjit nr. 10296, datë 08.07.2010 óPër Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin, Kreu II, neni 8 óPërgjegjshmëria menaxheriale e Titullarit, pika 2 dhe 8. b dhe neni 9 óPërgjegjshmëria menaxheriale e nëpunësit autorizues, germa óç.

Nga auditimi u konstatua se, gjatë veprimtarisë së GMS-së, kjo strukturë nuk ka qenë në përputhje me kërkesat ligjore, për arsye se:

1. óGMS, nuk ka miratuar plane zhvillimi strategjike me afat jo më pak se sa 5 vjet, kërkesë e ligjit nr. 68-2017 óPër financat e vetëqeverisjes vendore, neni 32 dhe UMF Plotësues nr. 8 dt. 29.3.2012 óProcedura e përgatitjes së Buxhetit afatmesëm, Kap. V;

2. Nuk janë përcaktuar rregulla me shkrim mbi veprimtaritë e kontrollit dhe ndarja e detyrave në mënyrë që:

a) Ndarjen e detyrave në fushën e dhënies së autorizimit në atë formë, në mënyrë që i njëjti punonjës të mos jetë përgjegjës në të njëjtën kohë për propozimin, miratimin, zbatimin, kontabilitetin dhe kontrollin, sipas udhëzimit të Ministrit të Financave;

b) Nuk është krijuar sistemimi i dy nënshkrimeve, i cili nuk lejon që angazhimi financiar të kryhet pa marrë nënshkrimet e nëpunësit autorizues dhe të nëpunësit zbatues të njësisë.

Këto veprime në kundërshtim me Ligjin nr. 10296, datë 8.07.2010, neni 22.

IV. Informacioni dhe komunikimi

Informimin dhe komunikimin, realizohet sipas shkallës së strukturave, bazuar edhe në rregulloren e brendshme.

Përveç kësaj mënyre, informimi realizohet në faqen zyrtare elektronike të Bashkisë Has si edhe nëpërmjet publikimeve dhe njoftimeve të adresuara për publikun veçanërisht lidhur me vjeljen e detyrimeve për tatim taksat lokale, në zbatim të kërkesave të ligjit nr. 9920, datë 19.04.2008 óPër procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë.

Kriteri: Ligji nr. 10296, datë 8.07.2010, neni 23.

V. Monitorimi

Monitorimi i sistemit të menaxhimit financiar dhe të kontrollit në përgjithësi, realizohet nëpërmjet organizimit të grupeve të punës monitorimit në vijueshmëri ose komisionet përkatëse

si për marrjen në dorëzim të punimeve të kontraktuara, në rastet e identifikimit të detyrimeve për tatim taksat lokale etj.

Një formë e monitorimit, është deklarata e vetëvlerësimit të sisteme të kontrollit të brendshëm, bazuar në Ligjin nr. 10296, datë 8.07.2010, neni 24.

Për sa më lart mban përgjegjësi z. L.M, Kryetar i Bashkisë Has, zj. D.G, Përgjegjës i Sektorit të Burimeve Njerëzore dhe zj. E.C, në cilësinë e Koordinatorit për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin.

Titulli i Gjetjes 1: *Sistemi i Menaxhimit Financiar dhe Kontrollit nuk ka funksionuar në mënyrë efektive.*

- Bashkia Has nuk ka hartuar dhe miratuar Gjurmën e Auditimit në kundërshtim me kërkesat e ligjit për MFK-në;
- Bashkia Has nuk ka hartuar një strategji për menaxhimin e riskut. Jo të gjitha strukturat e bashkisë, njësitë administrative dhe ndërmarrjet e varësisë, kanë hartuar regjistrat e tyre të riskut;
- Grupi i Menaxhimit Strategjik nuk është mbledhur rregullisht si dhe nuk ka hartuar asnjë raport periodik mbi kontabilitetin dhe menaxhimin, progresin e bërë në arritjen e objektivave të Bashkisë Has, identifikimin dhe menaxhimin e risqeve, etj.

Situata:

Nuk është miratuar gjurma e auditimit për të gjitha procedurat, proceset dhe transaksionet që lidhen me veprimtarinë kryesore në njësinë publike, si prokurimet publike, shpenzimet, të ardhurat etj.

Nga titullari nuk është nxjerrë akt i brendshëm ku të përcaktohen detyrat e punonjësit dhe strukturave përkatëse të Bashkisë Has gjatë marrjes dhe dorëzimit të detyrës.

Nga ana e titullarit të njësisë publike Bashkia Has nuk është hartuar dhe miratuar Strategji e Menaxhimit të Riskut, por është plotësuar vetëm Format i Regjistratit të Riskut.

Ndarjen e detyrave në fushën e dhënies së autorizimit në mënyrë që i njëjti punonjës të mos jetë përgjegjës në të njëjtën kohë për propozimin, miratimin, zbatimin, kontabilitetin dhe kontrollin, sipas udhëzimit të Ministrit të Financave.

Kriteret:

- Ligji nr. 10296, datë 08.07.2010 óPër Menaxhimin Financiar dhe Kontrollinó, i ndryshuar, kreu II, neni 8, pika 2, 8b, neni 9 pika ç dhe neni 16 pika 2 dhe 3;
- VKM nr. 124, datë 17.02.2016 óPër pezullimin dhe lirimin nga shërbimi civiló Kreu III, pika 27;
- VKM nr. 171, datë 26.03.2014 óPër transferimin e përkohshëm dhe të përkohshëm të nëpunësve civilë, pezullimin dhe lirimin nga shërbimi civiló, Kreu VII, pika 49, 52, 52;
- Udhëzimi i Ministrisë së Financave nr. 28, datë 15.12.2011 óMbi paraqitjen e deklaratës dhe raportit vjetor për cilësinë e sistemit të kontrollit të brendshëm në njësitë publikeó;
- Ligji nr. 68-2017 óPër financat e vetëqeverisjes vendoreó, neni 32 dhe UMF Plotësues nr. 8 dt. 29.3.2012 óProcedura e përgatitjes së Buxhetit afatmesëmó, Kap. V.

Ndikimi: Nuk janë identifikuar aktivitetet me risk të lartë si rezultat nuk janë marrë masat e duhura për minimizimin e risqeve që ndikojnë në arritjen e objektivave të secilës strukturë. Sistemet e informacionit dhe komunikimit nuk sigurojnë një komunikim efektiv si dhe nuk sigurohet dokumentimi i të gjitha veprimtarive, proceseve dhe transaksioneve për vijueshmërinë dhe monitorimin me qëllim mirë menaxhimin e fondeve publike.

Shkaku: Mosnjohje sa dhe si duhet e ligjit nr. 10296, datë 8.7.2010 óPër menaxhimin financiar dhe kontrollin nga niveli i lartë drejtues, si dhe mungesa e trajnimeve të dedikuara për gjithë stafin menaxhues në drejtim të njohjes së dispozitave të menaxhimit financiar dhe kontrollit dhe të menaxhimit të sistemit buxhetor.

Dorëzimi i detyrës si dhe marrja e saj nga persona të tjerë, nuk është bërë me akte dorëzimi dhe inventarizim përkatës.

Rëndësia: E mesme.

Rekomandimi: Bashkia Has të marrë masa që hartohet dhe miratohet strategjia e rrisht. Titullari i Bashkisë Has të miratojë gjurmën e auditimit për proceset kryesore që kontribuojnë në arritjen e objektivave të njësish dhe që përfshijnë zbatimin e aktiviteteve, programeve dhe projekteve më të rëndësishme.

Koordinatori i Grupit të Menaxhimit Strategjik të organizojë takimet periodike të GMS-së për të siguruar marrjen në kohën dhe formën e duhur të informacioneve cilësore me qëllim vlerësimin e progresit të bërë në arritjen e objektivave të MFK-së.

Spektori i Burimeve Njerëzore në Bashkinë Has të marrë masa që për çdo largim punonjësisht nga puna të ndiqet procedura për dorëzimin e detyrës.

Për organizimin dhe funksionimin e Njësish së Auditit të Brendshëm si dhe zbatimin e rekomandimeve të tyre në Bashkinë Has për vitin 2021.

Nga auditimi i kryer mbi funksionimin e Njësish së Auditit të Brendshëm të Bashkisë Has, u konstatua se, për periudhën objekt auditimi, nuk ka një Njësi të Auditimit të Brendshëm që funksionon në përputhje Ligjin nr. 114/2015, datë 22.10.2015 óPër auditimin e brendshëm në sektorin publik, neni 10, Organizimi i shërbimit të auditimit të brendshëm, pika 1, Të gjitha njësish publike, të përfshira në neni 3, të këtij ligji, duhet të marrin masa për krijimin e shërbimit të auditimit të brendshëm. Njësia e auditit të brendshëm për sa i përket numrit të audituesve që duhet të ketë në strukturë, nuk është ngritur në përputhje me kërkesat e Vendimit Nr. 83, datë 3.2.2016 óPër miratimin e kriterëve të krijimit të njësive të auditimit të brendshëm në sektorin publik, pika 3, ndërsa faktikisht është vetëm një auditues i brendshëm për vitin 2021, i cili ka shkëputur marrëdhëniet e punës (ka dalë në pension) më datë 01.06.2022.

Në zbatim të Ligjit nr. 114/2015 óPër auditimin e brendshëm në sektorin publik, Neni 11, óPërgjegjësitë e titullarëve të njësive publike, titullari i Bashkisë Has nuk ka ngritur një strukturë për auditimin e brendshëm të bashkisë për të siguruar këtë shërbim.

Rezulton se për vitin 2021 nga Bashkia Has nuk është planifikuar dhe realizuar asnjë auditim.

Për sa më lart mban përgjegjësi z. L.M, Kryetar i Bashkisë Has.

Titulli i Gjetjes 2: Mungesë e strukturës së Njësish së Auditit të Brendshëm

Situata: Struktura e auditit të brendshëm për vitin 2021 ka funksionuar vetëm më një auditues, nga tre që përcakton kuadri rregullator në fuqi.

Rezulton se për vitin 2021 nga Bashkia Has nuk është planifikuar dhe realizuar asnjë auditim, duke mos kryer detyrën funksionale dhe duke mos i dhënë titullarit të njësish publike këshilla për përmirësimin e veprimtarisë dhe efektivitetin e sistemit të kontrollit të brendshëm, si dhe siguri për realizimin e objektivave.

Kriteri: Ligji nr. 114/2015, datë 22.10.2015 óPër auditimin e brendshëm në sektorin publik, neni 10, Organizimi i shërbimit të auditimit të brendshëm, pika 1, Të gjitha njësish publike, të

përfshira në neni 3, të këtij ligji, duhet të marrin masa për krijimin e shërbimit të auditimit të brendshëm dhe neni 11, Vendimin Nr. 83, datë 3.2.2016 për miratimin e kriterëve të krijimit të njësive të auditimit të brendshëm në sektorin publik, pika 3.

Ndikimi: Mungesa e ngritjes së strukturës së Njesisë së Auditit të Brendshëm nuk sjell një veprimtari të pavarur që jep siguri objektive dhe këshillim për të përmirësuar performancën e institucionit

Shkaku: Mos ngritje të Njesisë së Auditit të Brendshëm

Rëndësia: E lartë

Rekomandimi: Bashkia Has të marrë masa për ngritjen e strukturës së Njesisë së Auditit të Brendshëm, që të jetë një mbështetës për njësinë e auditimit të brendshëm si dhe një organ i pavarur, monitorues e këshillëdhënës për titullarin e njësisë ose, shërbimi i auditit të brendshëm të kryhet nga njësia e auditit të brendshëm të një njësie tjetër publike, në bazë të një marrëveshje ndërmjet titullarëve të njësive publike përkatëse.

2.2 Mbi planifikimin dhe zbatimin e PBA-së dhe buxhetit vjetor për vitin 2021

1. Programimi i PBA-së 2021-2023

Për hartimin e PBA-së 2021-2023 nga Bashkia Has janë ndjekur dhe zbatuar hapat e më poshtëm:

- Me VKB nr. 34/1, datë 15.01.2020, është ngritur grupi i menaxhimit strategjik (GMS) dhe ekipeve të menaxhimit të programeve për hartimin e PBA-së 2021-2021, për Bashkinë Has;
- VKB nr. 27, datë 22.04.2020, për miratimin e tavaneve të programit buxhetor afatmesëm 2021-2023;
- VKB nr. 60, datë 23.07.2020, për miratimin e tavaneve të programit buxhetor afatmesëm 2021-2023;
- VKB nr. 62, datë 24.12.2019, për Kalendarin orientues për menaxhimin e shpenzimeve vendore gjatë vitit 2020, Bashkia Has, Kalendarin programit buxhetor afatmesëm (PBA) 2021-2023;
- Shkresë dërguar MFE nr. 1938, datë 14.09.2020, për Dërguar Projekt Buxheti Afatmesëm 2021-2023, bashkëlidhur dhe relacioni;
- Kryetari i Bashkisë Has ka miratuar udhëzimin plotësues për përgatitjen e buxhetit të bashkisë me nr. 1689, datë 03.08.2020.

2. Çelja e fondeve buxhetore të vitit dhe ndryshimet sipas akteve normative. Kontrolli i realizimit të shpenzimeve bazuar në nivelin e fondeve të çelura

Për vitin 2021 në Bashkinë Has buxheti është hartuar kryesisht mbi bazën e 22 programeve, përkatësisht: Administrata Vendore, Gjendja Civile, Shërbime Policore Vendore, Shërbimi i Mbrojtjes nga Zjarri dhe Mbrojtja Civile, Bujqësi/Inspektim/Ushqim dhe Mbrojtja e Konsumatorit, Menaxhimi i Infrastrukturës së Ujitjes dhe Kullimit, Administrimi i Pyjeve dhe Kullotave, Rrjeti Rrugor Rural, Menaxhimi i Mbetjeve, Planifikimi Urban Vendor, etj.

Buxheti i vitit 2021, është miratuar me VKB nr. 105, datë 25.12.2020, me shkresën nr. 3/87, datë 08.01.2021, konfirmuar nga Prefekti i Qarkut.

Nga auditimi u konstatua se, buxheti i viteve 2021-2023 është miratuar sipas procedurave dhe kërkesave të ligjit nr. 9936, datë 26.06.2008 "Për menaxhimin dhe zbatimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë" i ndryshuar, ligjit nr. 10296, datë 08.07.2010, "Për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin", ligjit nr. 9632, datë 30.10.2006 "Për sistemin e taksave vendore" i ndryshuar.

Tabela nr. 1: Planifikimi i të ardhurave dhe shpenzimeve për vitin 2021

Planifikimi i të ardhurave 2021		Planifikimi i shpenzimeve 2021	
Burimi i të ardhurave	Vlera në 000/ lekë	Emërtimi i zërave	Vlera në 000/ lekë
Të ardhura të planifikuara për vitin 2021	29,082	Art. 600 Paga	150,158
Të ardhurat e veta të trashëguara nga viti i mëparshëm e të planifikuara për shpenzime për vitin 2021	7,634	Art. 601 Sigurime shoqërore dhe shëndetësore	24,199
Total të ardhurat e veta	36,716	Art. 602 Shpenzime operative	69,098
Të ardhura të trashëguara nga granti i pakushtëzuar	250	Art. 604 Transferime korrente te brendshme	1
Të ardhura të trashëguara nga granti i kushtëzuar (transferata specifike 600, 601, 602 etj.)	-	606 Transferime të buxhetit familjar dhe individë	321,563
Grant i ri i çelur për llogari të vitit 2021	144,202	Art. 230-231 Investime	52,251
Transferta specifike e çelur për llogari të vitit 2021	83,338	Fondi Rezervë + Kontigjencës (609)	3,173
Transferta e pakushtëzuar detyrime (akt normativ)	1,267		
Transferta e kushtëzuar	343,664		
Total të ardhura nga transfertat e buxhetit të shtetit	572,721		
Të tjera (Ambasada japoneze, undp)	11,006		
TOTALI TË ARDHURAVE	620,443	TOTALI SHPENZIMEVE	620,443

Burimi: Bashkia Has

Tabela nr. 2: Planifikimi i të ardhurave dhe shpenzimeve me ndryshimet e buxhetit për vitin 2021

Planifikimi i të ardhurave për vitin 2021, në mijë lekë				Planifikimi i shpenzimeve për vitin 2021, në mijë lekë			
Burimi i të ardhurave	Buxheti fillestar, miratuar me VKB	Buxheti shtesë, miratuar me VKB	Vlera	Emërtimi i zërave	Buxheti fillestar	Buxheti shtesë	Vlerat e buxhetit fillestar + buxheti shtesë
	miratuar me VKB	miratuar me VKB			miratuar me VKB	miratuar me VKB	
	1	2	1+2		3	4	3+4
Të ardhura të planifikuara për vitin 2021	24,630	4,452	29,082	Art. 600 Paga	138,095	12,413	150,508
Të ardhurat e veta të trashëguara nga viti i mëparshëm dhe të planifikuara për shpenzime për vitin 2021	-	7,634	7,634	Art. 601 Sigurime shoqërore dhe shëndetësore	23,324	875	24,199
Total të ardhurat e veta	24,630	12,086	36,716	Art. 602 Shpenzime operative	59,461	9,286	68,747
Të ardhura të trashëguara nga granti i pakushtëzuar	-	250	250	Art. 604 Transferime korrente te brendshme	10	(9)	1
Të ardhura të trashëguara nga transfertat specifike	-	-	-	Art. 606 Transferime te buxhetit familjar dhe individë	258,035	66,702	324,737
Transferta e pa kushtëzuar e çelur për llogari të vitit 2021	144,202	-	144,202	Art. 230-231 Investime	44,045	8,206	52,251

Transferta specifike e çelur për llogari të vitit 2021	80,596	2,742	83,338	Fondi Rezervë + Kontigjencës (609)	-	-	-
Transferta e pakushtëzuar detyrime (akt normativ)	-	1,267	1,267				
Transferta e kushtëzuar	273,542	70,122	343,664				
Total të ardhurat nga transfertat e buxhetit të shtetit	498,340	74,381	572,721				
Të tjera (Ambasada japoneze, undp)	-	11,006	11,006				
TOTALI TË ARDHURAVE	522,970	97,473	620,443	TOTALI SHPENZIMEVE	522,970	97,473	620,443

Burimi: Bashkia Has

Planifikimi dhe realizimi i shpenzimeve për vitin 2021

Për vitin 2021 planifikimi i buxhetit për zërin shpenzime është në vlerën **620,443** mijë lekë, ndërsa realizimi në vlerën **605,348** mijë lekë, ose në masën 98%. Realizimi i buxhetit sipas zërave paraqitet në mënyrë më të detajuar në tabelën në vijim.

Tabela nr. 3: Planifikimi dhe realizimi i shpenzimeve për vitin 2021

Buxheti përfundimtar Plan-Fakt Bashkia Has, për vitin 2021, në mijë lekë						
Nr.	Përshkrimi i shpenzimeve Bashkia pa njësitë vartëse	Plani 2021	Fakti 2021	Realizimi në %	Vlera e mbuluar nga të ardhurat e veta	Vlera e mbuluar nga FZHR dhe granti
1	Art. 600 Paga	150,508	148,710	99%	8,773	139,937
2	Art. 601 Sigurime shoqërore dhe shëndetësore	24,199	24,167	100%	-	24,167
3	Art. 602 Shpenzime operative	68,747	68,747	100%	4,063	64,684
4	Art. 604 Transferta korrente të brendshme	1	1	100%	-	1
5	Art. 606 Transferime të buxhetit familjar dhe individë (PAK)	324,737	321,587	99%	-	321,587
6	Art. 230 Projekte					
7	Art. 231 Investime	52,251	42,136	81%	19,058	23,078
	TOTAL viti 2021	620,443	605,348	98%	31,894	573,454

Burimi: Bashkia Has

Buxheti i vitit 2021 është miratuar me VKB nr. 105, datë 25.12.2020, me shkresën nr. 3/87, datë 08.01.2021, konfirmuar nga Prefekti i Qarkut.

Nga bashkia ndarja e plan buxhetit dhe detajimi në nivel titulli, kapitulli, artikulli dhe nën artikulli është kryer në respektim të disiplinës buxhetore sipas strukturës dhe burimeve të financimit. Në këto programe buxhetore është bërë shpërndarja e fondeve të vënë në dispozicion nga Pushteti Qendror të grandëve nëpërmjet transfertës së pakushtëzuar, transfertës së pakushtëzuar sektoriale, transfertës së kushtëzuar dhe fondeve të krijuara nga burimet e veta, për kryerjen e funksioneve të veta, ato të deleguara dhe të përbashkëta si dhe shpërndarjen e fondeve të grandëve. Gjatë këtij viti, si rezultat i çeljeve të reja në llogarinë e njësisë vendore në thesar dhe rialokimeve të kryera nga vetë bashkia, vlerat përkatëse të buxhetit vjetor kanë pësuar ndryshime në kuptimin e vlerës totale, me VKB nr. 18, datë 30.04.2021, 6Një shtesë në buxhetin

e Bashkisë Has për vitin 2021^o, VKB nr. 34, datë 30.06.2021, ^oShtesë në numrin e punonjësve dhe ndryshimin në buxhetin e Bashkisë Has për vitin 2021^o, VKB nr. 39, datë 30.07.2021, ^oNjë shtesë në numrin e punonjësve dhe ndryshimin në buxhetin e Bashkisë Has për vitin 2021^o, VKB nr. 22, datë 28.05.2021, ^oNjë shtesë në numrin e punonjësve dhe ndryshimin në buxhetin e Bashkisë Has për vitin 2021^o, VKB nr. 62, datë 29.10.2021, ^oDisa ndryshime në buxhetin e Bashkisë Has për vitin 2021^o, VKB nr. 61, datë 29.10.2021, ^oNjë shtesë në buxhetin e Bashkisë Has për vitin 2021^o, VKB nr. 70, datë 26.11.2021, ^oNjë shtesë në buxhetin e Bashkisë Has për vitin 2021^o, VKB nr. 69, datë 26.11.2021, ^oDisa ndryshime në buxhetin e Bashkisë Has për vitin 2021^o dhe VKB nr. 77, datë 22.12.2021, ^oNjë shtesë në buxhetin e Bashkisë Has për vitin 2021^o.

3. Saktësia e realizimit të treguesve buxhetor dhe pasqyrimi në raportet e monitorimit

Treguesit e buxhetit për vitin 2021, është planifikuar në shumën 620,443 mijë lekë prej të cilit janë realizuar 605,348 mijë lekë ose i shprehur në përqindje plani është realizuar në masën 98%, nga të cilat financim me të ardhurat e veta në vlerën 31,894 mijë lekë ose në masën 5% të buxhetit faktik.

Nga Drejtoria e Financës është rakorduar çdo muaj me Degën e Thesarit Has, si për shpenzimet e kryera ashtu edhe për të ardhurat, duke mbajtur akt rakordimet përkatëse, janë ruajtur kufijtë e miratuar të shpenzimeve në total dhe për çdo artikull e nën artikull sipas klasifikimit ekonomik. Në të gjithë periudhën e audituar janë respektuar të gjitha procedurat ligjore për çeljen e fondeve me Degën e Thesarit, duke pasqyruar rregullisht dhe periodikisht ndryshimet në buxhetin fillestar për vitin respektiv të realizuar me VKB, ose të diktuar nga grandet e deleguara nga pushteti qendror. Nga auditimi i dokumentacionit të vënë në dispozicion mbi plan buxhetin dhe detajimin në nivel titulli, kapitulli, artikulli, nën artikulli u konstatua se në të gjitha rastet është respektuar disiplina buxhetore.

Në zbatim të detyrimeve ligjore për monitorimin e zbatimit të buxhetit, ligji nr. 139/2015 ^oPër vetëqeverisjen vendore^o, nenit 44 dhe ligji nr. 68/2017 ^oPër financat e vetëqeverisjes vendore^o, neni 48, Bashkia Has ka përgatitur raportet periodike të monitorimit të zbatimit të buxhetit si vijon:

- Raporti i monitorimit për 4-mujorin e I-^{te} për vitin 2021 dërguar në MFE me shkresën nr. 972 Prot., datë 19.05.2021;
- Raporti i monitorimit për 4-mujorin e II-^{te} për vitin 2021 dërguar në MFE me shkresën nr. 1747 Prot, datë 20.09.2021;
- Raporti i monitorimit për 4-mujorin e III-^{te} për vitin 2021 dërguar në MFE me shkresën nr. 237 Prot, datë 20.02.2022.

Kryetari i Bashkisë Has ka paraqitur në këshill raportet e monitorimit të zbatimit të buxhetit, sipas përcaktimeve ligjit nr. 68/2017 ^oPër financat e vetëqeverisjes vendore^o, neni 48, me konfirmim nga Prefekti i Qarkut Kukës me shkresë nr. 3/4, datë 14.02.2022 të VKB nr. 3, datë 28.01.2022, ^oPër raportin e monitorimit të buxhetit të vitit 2021^o.

Kryetari i Bashkisë Has ka miratuar rregullat specifike dhe procedurale që duhet të ndiqen në procesin e monitorimit të zbatimit të buxhetit. Raportet e monitorimit janë hartuar në përputhje me kërkesat e Shtojcës 2 "Përmbajtja e raportit të monitorimit" dhe Shtojcës 5 "Treguesit e monitorimit të performancës së programeve dhe treguesit financiarë", të Udhëzimit të MFE nr. 22, datë 30.07.2018, "Për procedurat standarde të monitorimit të buxhetit të njësive të vetëqeverisjes vendore". Raportet e monitorimit janë të plota me të gjitha anekset sipas

kërkesave të Ligjit nr. 68/2017 "Për Financat e Vetëqeverisjes Vendore", neni 48 dhe Udhëzimit nr. 22, datë 30.07.2018, "Për procedurat standarde të monitorimit të buxhetit të njësive të vetëqeverisjes vendore", pika 10, 12, 28, 29, 48.

4. Vlerësimi i risqeve buxhetore nga niveli i faturave të pa likuiduaravendimet gjyqësore, vendimet e shpronësimeve

Në PBA 2021-2023 Formatit (C3) amortizimi i detyrimeve të prapambetura deri në fund të vitit 2021 është paraqitur në vlerën 19,089,192.8 lekë, kjo shumë përputhet me të dhënat e rakorduara të Degës së Thesarit që paraqitet në po të njëjtën vlerë.

Tabela nr. 4: Detyrimet e prapambetura në Bashkinë Has

Nr.	EMËRTIMI	DATA	VLERA NË LEKË
1	Kolaudim punimesh	21.11.2018	28,200
2	Shpenzime për ekzekutim V.Gj.	29.12.1994	395,178
3	Rehabilitim rrugësh	03.06.2019	13,168,101
4	Ndërtim Ujësjiellësi	24.09.2018	163,409
5	Rikonstrukcion rruge	21.10.2019	3,173,308.8
6	Shpërblim për fëmijët e lindur të regjistruar brenda afatit ligjor	Tetor 2016 - 31.12.2018	1,050,000
7	Ndërtim ujësjiellësi	20.05.2021	1,110,996
TOTALI			19,089,192.8

Burimi: Bashkia Has

Nga auditimi rezulton se për vitin 2021, vlera e detyrimeve të prapambetura të paraqitura në bilanc në llogarinë 486 përputhet me shumën e detyrimeve të prapambetura të rakorduar me Degën e Thesarit. Kjo vlerë e detyrimeve të prapambetura e paraqitur nga Bashkia Has është 19,089,192.8 lekë.

*Nga auditimi u konstatua se, për shlyerjen e detyrimeve të prapambetura Bashkia Has ka hartuar një plan dhe e ka dërguar me e-mail MFE më datë 23.03.2022, ku parashikon që për vitin 2022 të likuidohen 6,400,309 lekë, në vitin 2023 të likuidohen 6,377,000 lekë dhe në vitin 2024 të likuidohen 6,311,884 lekë. Referuar dokumentacionit të audituar, që disponon Bashkia, lidhur me likuidimin e detyrimeve në çeljen e vitit 2021 rezultojnë në shumën 28,833,238 lekë dhe gjatë këtij viti janë bërë pagesa në vlerën 13,920,155lekë dhe shtesa në vlerën 4,176,110 lekë, si rrjedhojë, **detyrimet më 31.12.2021 janë në vlerën totale 19,089,192.8 lekë.***

Për sa më lart mban përgjegjësi z. L.M, Kryetar i Bashkisë Has dhe z. P.C, Drejtor i Drejtorisë së Financës dhe Taksave.

Vështirësia Financiare e Bashkisë Has

Në UMFE nr. 26, datë 27.09.2019 óProcedura për menaxhimin e vështirësive financiare për njësitë e vetëqeverisjes vendore, trajtohet shkalla e vështirësisë financiare dhe menaxhimi i këtyre vështirësive.

Gjithashtu në ligjin nr. 68/2017 óPër financat e vetëqeverisjes vendore, datë 27.04.2017, kreu XI vështirësitë financiare dhe masat për zgjidhjen e tyre, neni 55 Probleme Financiare, pika 1.

NR.	Emërtimi	Stoku në vlerë	Totali i shpenzimeve të miratuara për NJQV-në	Stoku/Shpenzimeve totale të miratuara të NJQV-së
I	Borxhe (a+b)	0		
II	Detyrime (a+b+c)	19,089,193		
a	Shpenzime kapitale	18,694,015		
a/1	Subjekte private	18,694,015		
b	Vendime gjyqësore	395,178		
b/1	Marrëdhënie pune			
b/2	Mallra dhe shërbime			
b/3	Investime			
b/4	Të tjera	395,178		
III	Totali (I+II)	19,089,193	262,753,000	7.27%

Për Bashkinë Has, totali i shpenzimeve të miratuara nga të ardhurat e veta me VKB për vitin 2021 ka vlerën 262,753,000 lekë, ndërsa stoku i detyrimeve të prapambetura më 31.12.2021, ka vlerën 19,089,193 lekë. Raporti i këtyre treguesve, pra raporti i stokut të detyrimeve të prapambetura me shpenzimeve totale të miratuara, ka vlerën **7%, shifër që e klasifikon Bashkinë Has në njësi të qeverisjes vendore pa probleme financiare.**

Titulli i gjetjes 3: *Risqet buxhetore nga niveli i faturave të pa likuiduara.*

Situata: Nga auditimi u konstatua se nuk janë marrë masa të plota për likuidimin e detyrimeve të prapambetura, pasi nga njëra anë kryhen pagesa gjatë vitit për detyrimet e trashëguara ndër vite, por gjithashtu gjatë vitit buxhetor krijohen detyrime të reja të prapambetura. Në fillim të vitit buxhetor 2021 detyrimeve e prapambetura kanë vlerën 28,833,238 lekë, prej të cilave është likuiduar vlera 13,920,155 lekë, por është krijuar detyrim i ri në vlerën 4,176,110 lekë, duke e çuar vlerën e këtyre detyrimeve më 31.12.2021 në vlerën 19,089,192.8 lekë.

Kriteri: Udhëzimi i MFE nr.9, datë 20.03.2018 óPër procedurat standarde të zbatimit të buxhetitó, pika 153-162, Rubrika - Marrja e angazhimit dhe kryerja e shpenzimeve publike, detyrimet kontraktuale midis palëve, nenin 52 të ligjit nr.9936, datë 26.6.2008 óPër menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisëó, i ndryshuar, UMF nr. 5, datë 27.12.2014 óPër shlyerjen e detyrimeve të prapambeturaó, pikat 82-91.

Ndikimi: Mos shlyerja në kohë të detyrimeve ndaj të tretëve krijon risk për pagesa penalitetesh të panevojshme dhe pasaktësi në vlera dhe mangësi në raportime të detyrimeve të prapambetura.

Shkaku: Moszbatim i kërkesave ligjore për shlyerjen e detyrimeve të prapambetura, vlera jo të besueshme.

Rëndësia: E lartë

Rekomandimi: Kryetari i Bashkisë Has dhe Drejtoria Ekonomike, të marrin masa për likuidimin e vlerës së kontratave të lidhura midis Bashkisë Has dhe kontraktorëve, brenda afatit 30 ditore pas ardhjes së faturës tatimore, duke eliminuar në këtë mënyrë shkakun e krijimit të detyrimeve të reja prapambetura. Lidhja e kontratës të bëhet vetëm pasi fondi që parashikon procedura e prokurimit do të jetë në dispozicion (në llogarinë e thesarit) të autoritetit kontraktor.

Mbi likuidimin e vendimeve gjyqësore në Bashkinë Has

Nga auditimi rezulton se vlera e detyrimeve të prapambetura për vendimet gjyqësore në vitin 2021 është në vlerën 395,178 lekë, për të cilën Bashkia Has ka Vendimin e Gjykatës nr. 940 dhe nr. 1011, datë 16.12.1994 dhe nuk ka dokumentacion tjetër përkatësisht një Urdhër nga zyra përmbarimore që të mund të shlyej detyrimin e krijuar për këtë çështje dhe si rezultat në fund të vitit 2021 rezulton e papaguar vlera 395,178 lekë.

5. Burimi i krijimit të të ardhurave, vlerësimi i mbledhjes së tyre dhe borxhi tatimor.

Struktura e Bashkisë Has për administrimin dhe mbledhjen e taksave dhe tarifave vendore.

Për vitin 2021, Struktura organizative e Bashkisë Has është miratuar me Urdhrin e Kryetarit nr. 09 datë 11.01.2021. Referuar këtij urdhri Drejtoria e Financës dhe Tatim Taksave/Spektori i Tatimeve ka patur në përbërjen e tij 4 punonjës, 1 Përgjegjës Spektori dhe 3 inspektor për tatim taksat vendore.

Parashikimi dhe realizimi i taksave dhe tarifave vendore sipas llojeve

Për vitin 2021 paketa e taksave dhe tarifave vendore në Bashkinë Has është miratuar me VKB-në nr. 104, datë 25.12.2020 óPër miratimin e taksave dhe tarifave vendore në Bashkinë Has për vitin 2021ó, konfirmuar nga Prefekti i Qarkut Kukës me shkresën nr. 3/85 Prot datë 08.01.2021ó.

Tabela nr.5: Parashikimi dhe realizimi i të ardhurave në Bashkinë Has, viti 2021 në mijë lekë

Nr.	TË ARDHURAT	PLAN	FAKT	%
A.1	Të Ardhura nga Taksat Lokale	3,707	1,932	52.12
A.1.1	Taksa vendore mbi biznesin e vogël	400	71	17.75
A.1.2	Taksa mbi pasurinë e paluajtshme	1,677	896	53.43
A.1.2.1	Taksa mbi ndërtesën	1,610	786	48.82
A.1.2.2	Taksa mbi tokën bujqësore	67	49	73.13
A.1.2.3	Taksa mbi truallin	-	61	0.00
A.1.3	Taksa e ndikimit në infrastrukturë nga ndërtimet e reja	1,500	769	51.27
A.1.4	Taksa e tabelës	130	196	150.77
A.2	Të Ardhurat nga Taksat e Ndara	7,450	12,737	170.97
A.2.1	Taksa vjetore për qarkullimin e mjeteve të përdorura	5,000	8,354	167.08
A.2.2	Taksa e rentës minerare	250	-	0.00
A.2.3	Taksa mbi të ardhurat personale	2,200	4,383	199.23
A.3	Të Ardhurat nga Tarifat Vendore	9,341	8,010	85.75
A.3.1	Tarifa e menaxhimit të mbetjeve	4,615	4,407	95.49
A.3.1.1	Tarifa e pastrimit për familjet	1,600	1,011	63.19
A.3.1.2	Tarifa e pastrimit për institucionet	440	520	118.18
A.3.1.3	Tarifa e pastrimit për biznesin	2,575	2,876	111.69

A.3.2	Tarifa për ndriçimin publik	370	363	98.11
A.3.2.1	Tarifa për ndriçimin publik nga institucionet	60	56	93.33
A.3.2.2	Tarifa për ndriçimin publik nga biznesi	310	307	99.03
A.3.3	Tarifa për gjelbërimin	184	214	116.30
A.3.3.1	Tarifa për gjelbërimin nga Institucionet	47	39	82.98
A.3.3.2	Tarifa për gjelbërimin nga bizneset	137	175	127.74
A.3.4	Tarifa për shërbimet administrative të bashkisë	2,602	2,070	79.55
A.3.4.1	Tarifa për vulosje veterinarie të bagëtive të therura	62	27	43.55
A.3.4.2	Tarifa e liqensimit të veprimtarive të transportit	220	202	91.82
A.3.4.3	Tarifa për dhënie liqense për tregtimin e naftës bruto	1,000	651	65.10
A.3.4.4	Tarifa për pyejt dhe kullotat	800	737	92.13
A.3.4.5	Tarifa për shërbimet shtesë nga zjarrëfiksja	20	17	85.00
A.3.4.6	Tarifa për zënien dhe përdorimin e hapsirës publike	500	436	87.20
A.3.5	Tarifa të institucioneve të arsimit, kulturës, sportit etj	300	90	30.00
A.3.5.1	Mensa (Konviktet)	300	90	30.00
A.3.6	Tarifa për furnizimin me ujë dhe kanalizime	140		0.00
A.3.7	Tarifa për shërbimin e ujitjes dhe kullimit	600	477	79.50
A.3.8	Tarifa të tjera	530	389	73.40
A.4	Të Ardhurat e Tjera	2,872	3,545	123.43
A.4.1	Qeraja nga asetet në pronësi të bashkisë	2,772	2,774	100.07
A.4.2	Kundravajtjet administrative (Gjobat)	100	120	120.00
A.4.3	Trasferta dhe ndihma nga njësitë e tjera vendore	-	300	0.00
A.4.4	Grante nga ndihma ndërkombëtare	-	-	0.00
A.4.5	Të tjera	-	351	0.00
	Totali	23,370	26,224	112.21

Burimi: Bashkia Has, përpunoi grupi i auditimit

Referuar të dhënave të paraqitura në tabelën më sipër për periudhën nën auditim realizimi i të ardhurave nga taksat dhe tarifat vendore në Bashkinë Has paraqitet në masën 112%, nga 23,370 mijë lekë të parashikuara janë realizuar në vlerën 26,224 mijë lekë (plus 2,854 mijë lekë).

Taksa mbi tokën bujqësore

Titulli i gjetjes 4: *Mos ngarkesë e familjeve në Bashkinë Has për taksën e tokës bujqësore.*

Situata: Taksa mbi tokën bujqësore llogaritet në bazë të ligjit nr. 9632, datë 30.10.2006, óPër sistemin e taksave vendoreó, i ndryshuar, neni 23⁷.

⁷Ligji nr. 9632, datë 30.10.2006, óPër sistemin e taksave vendoreó, i ndryshuar, neni 23, pika 1, aneksi 1.

Sipas Aneksit 1 të ligjit nr. 9632, datë 30.10.2006, óPër sistemin e taksave vendoreó, Bashkia Has klasifikohet në kategorinë e katërt ku çmimi lekë/ha në vit për tokën bujqësore është si në tabelën më poshtë:

Tabela nr.6: Vlera e taksës së tokës së tokës bujqësore në lekë/hektar/vit

Kategoria e tokës bujqësore	Niveli i taksës së tokës bujqësore sipas VKB-ve (lekë/ha/vit)
I	1,400
II	1,200
III	1,100
IV	1,000
V	900
VI	800
VII-X	700

Referuar VKB-së nr. 104 datë 25.12.2020 óPër miratimin e taksave dhe tarifave vendore në Bashkinë Has për vitin 2021ó, toka bujqësore në Bashkinë Has klasifikohet në kategorinë VII-X me detyrim 700 lekë/ha/vit.

Nga auditimi konstatohet se, në Bashkinë Has familjet nuk ngarkohen për pagesën e taksës së tokës bujqësore si dhe Sektori i Tatimeve nuk ka asnjë informacion lidhur me numrin e familjeve që kanë detyrimin të paguajnë këtë taksë dhe sipërfaqes së tokës bujqësore që familjet zotërojnë me AMTP mbi të cilën llogaritet dhe taksa e tokës bujqësore. Veprime këto në kundërshtim me përcaktimet e ligjit nr. 9632, datë 30.10.2006, óPër sistemin e taksave vendoreó, i ndryshuar, neni 23 dhe VKB-së nr. 104 datë 25.12.2020 óPër miratimin e taksave dhe tarifave vendore në Bashkinë Has për vitin 2021ó pika 4/b. Të vetmet pagesa që bëhen për taksën e tokës bujqësore janë rastet kur qytetarët paraqiten në bashki në mënyrë vullnetare për të paguar taksat dhe tarifave vendore apo për të marrë shërbime dhe nga Sektori i Taksave dhe Tarifave ju mbahet edhe taksa e tokës me vlerë 700 lekë/ha/vit kur bashkia ka të dhëna.

Për veprimet dhe mosveprimet e mësipërme ngarkohet me përgjegjësi, z. P.C me Detyrë Drejtor i Drejtorisë së Financës, Buxhetit, Taksave dhe Tarifave Vendore, z. U.H me detyrë Përgjegjës i Sektorit të Tatim Taksave dhe z. A.P me detyrë Përgjegjës i Sektorit Bujqësor.

Kriteri:Ligji nr. 9632, datë 30.10.2006, óPër sistemin e taksave vendoreó, i ndryshuar, neni 23 dhe VKB nr. 104 datë 25.12.2020 óPër miratimin e taksave dhe tarifave vendore në Bashkinë Has për vitin 2021ó pika 4/b.

Ndikimi: Bashkia Has nuk ka të dhëna se sa është numri i familjeve që zotërojnë tokë bujqësore dhe sa është sipërfaqja që duhet të tatohet referuar paketës fiskale duke sjellë mungesë të ardhurash në buxhetin e bashkisë.

Shkaku: Mos angazhim i strukturave të bashkisë për të krijuar regjistrin e familjeve që kanë në pronësi tokë bujqësore.

Rëndësia:E lartë

Rekomandim:Bashkia Has, Sektori i Taksave dhe Tarifave Vendore në bashkëpunim me Sektorin e Bujqësisë të marrin masa për të identifikuar numrin e familjeve që kanë në pronësi tokë bujqësore si dhe sipërfaqen e saktë që ato zotërojnë, me qëllim krijimin e një regjistri me të dhëna të plota dhe të sakta. Ky regjistër më pas të shërbejë si bazë për të bërë llogaritjen e detyrimeve që ju lindin këtyre familjeve referuar paketës fiskale të miratuar të Bashkisë Has.

Taksa e ndikimit në infrastrukturë

Titulli i gjetjes 5:*Mos arkëtim i taksës së ndërtimeve të reja që pajisen me certifikatën e pronësisë (taksa e legalizimeve).*

Situata: Taksa e ndikimit në infrastrukturë nga legalizimet llogaritet në bazë të përcaktimeve të ligjit nr. 9632, datë 30.10.2006, óPër sistemin e taksave vendoreó, i ndryshuar, neni 9, pika 3/c *“për ndërtesat, të cilat janë në proces legalizimi, taksa e ndikimit në infrastrukturë e ndërtimeve të reja është 0,5 për qind e vlerës së investimit. Leja e legalizimit lëshohet vetëm pasi të jetë vërtetuar pagesa e taksës nga taksapaguesi”* dhe VKM-së nr. 860, datë 10.12.2014óPër përcaktimin e mënyrës së mbledhjes dhe administrimit të të ardhurave për ndërtimet pa leje dhe vlerave të zbatueshme për legalizimó, pika 5 óTaksa vendore e ndikimit në infrastrukturë, për ndërtimet e legalizuara, pavarësisht nga funksioni i tyre, të llogaritet, arkëtohet dhe administrohet nga njësitë e qeverisjes vendore, në përputhje me përcaktimet e ligjit nr. 9632, datë 30.10.2006, “Për sistemin e taksave vendore”, i ndryshuar. Për zbatimin e kësaj pike, drejtoritë e ALUIZNI-t, të vënë në dispozicion të njësisve të qeverisjes vendore, në momentin e dërgimit për regjistrim në ZVRPP, të dhënat e ndërtimeve që pajisen me leje legalizimó. Në Bashkinë Has struktura që administron dokumentacionin dhe përlllogarit vlerën e taksës së ndikimit në infrastrukturë për subjektet që pajisen me certifikatën e pronësisë është Sektori i Planifikimit, të Territorit dhe Urbanistikës dhe Sektori i Tatimeve.

Nga auditimi i ecursisë së pagesave për taksën e ndikimit në infrastrukturë nga legalizimet rezulton se, në Bashkinë Has ka detyrime të pa paguara për objekte që janë legalizuar që nga viti 2017 deri në 31.12.2020 në vlerën **9,282,639 lekë për 239 objekte që përbën të ardhura të munguara në buxhetin e Bashkisë Has**. Për vitin 2021 Bashkia Has nuk ka marrë asnjë shkresë nga ASHK për objektet që mund të jenë legalizuar gjatë këtij viti. Gjithashtu, bashkia nga ana e saj nuk ka dërguar asnjë shkresë drejt ASHK-së për të kërkuar informacion.

Për veprimet dhe mosveprimet e mësipërme ngarkohet me përgjegjësi z. U.H me detyrë Përgjegjës i Sektorit të Tatim Taksave dhe z. N.B me detyrë Përgjegjës i Sektorit të Planifikim Territorit dhe Urbanistikës.

Kriteri:Ligji nr. 9632, datë 30.10.2006,óPër sistemin e taksavevendoreó, i ndryshuar, neni 9, pika 4, neni 27.

Ligji nr. 95/2018 ópër disa ndryshime dhe shtesane ligjin nr. 9632, datë 30.10.2006,óPër sistemin e taksavevendoreó, i ndryshuar, neni 9, pika 3/c.

Ligji nr. 98/2020 ópër disa ndryshime dhe shtesane ligjin nr. 9632, datë 30.10.2006,óPër sistemin e taksavevendoreó, i ndryshuar, neni 1, ónë nenin 27, pika 3, shkronja ócô.

VKM nr. 860, datë 10.12.2014 ó Për përcaktimin e mënyrës sëmbledhjes dhe administrimit të të ardhurave përndërtimet pa leje dhe vleravetë zbatueshme për legalizimó pika 5.

VKB nr. 104 datë 25.12.2020 óPër miratimin e taksave dhe tarifave vendore në Bashkinë Has për vitin 2021ó.

Ndikimi: Mungesë të ardhurash në buxhetin e Bashkisë Has, nga mos arkëtimi i vlerës prej **9,282,639 lekë** për ndërtimet e reja që legalizohen.

Shkaku: Mos marrje e masave efektive nga Sektori i Planifikimit, të Territorit dhe Urbanistikës dhe Sektori i Tatimeve të bërë të mundur pagesën e taksës së legalizimeve.

Rëndësia:E lartë

Rekomandim:Sektori i Planifikimit, të Territorit dhe Urbanistikës në Bashkinë Has të dërgojë periodikisht informacion në Sektorin e Taksave dhe Tarifave Vendore mbi subjektet debitorë për óTaksën e ndikimit në infrastrukturë për legalizimetó dhe në bashkëpunim të marrin masa administrative e ligjore për arkëtimin e taksës së ndikimit në infrastrukturë **për 239 debitorë në vlerën 9,282,639 lekë** si dhe në vijimësi nga të gjitha ndërtimet e reja që legalizohen. Gjithashtu, nga strukturat e Bashkisë Has të bashkëpunohet me Agjencinë Shtetërore të Kadastrës (ASHK),

për të marrë informacion periodik lidhur me legalizimet e reja që kryhen si dhe për bllokimin e veprimeve në dhënien e certifikatës së pronësisë deri në kryerjen e pagesave të taksës së ndikimit në infrastrukturë.

Të ardhurat nga asetet e dhëna me qira

Në kuadër të auditimit të të ardhurave të Bashkisë Has u auditua realizimi i të ardhurave nga asetet e bashkisë të dhëna me qira. Në këtë aspekt u auditua vetëm zbatimi i kushteve të kontratave lidhur me pagesat në afat të detyrimeve të qirasë vjetore për sipërfaqen e marrë me qira dhe jo kushtet e hartimit të kontratave.

Dhënia e aseteve të bashkisë me qira bëhet bazuar në kuadrin ligjor si më poshtë:

- Kodi Civil i Republikës së Shqipërisë, nenet 826-840;
- Ligjin nr. 139/2015, óPër Vetëqeverisjen Vendore;
- VKM nr. 54, datë 5.2.2014 óPër përcaktimin e kriterëve, të procedurës e të mënyrës së dhënies me qira, enfiteozë apo kontrata të tjera të pasurisë shtetërore, e ndryshuar;
- VKM nr. 391 datë 21.06.20006, ndryshuar me VKM nr. 1064, datë 22.12.2010 óPër përcaktimin e tarifave në sektorin e pyjeve dhe të kullotave.

Titulli i gjetjes 6:Të ardhura të munguara nga mos pagesa e qirave të kontratave të aseteve.

Situata:Bashkia Has në zbatim të përcaktimeve ligjore në fuqi⁸ për administrimin e aseteve në pronësi apo në përdorim, dhe krijimit të të ardhurave prej dhënies me qira të tyre ka lidhur 68 kontrata për dhënien me qira të aseteve që ka në pronësi. Këto kontrata janë lidhur bazuar në legjislacionin përkatës në vijimësi me subjekte të ndryshëm fizik/ juridik që kanë shprehur interes, për afate kohore nga 1-30 vjet. Kontratat janë lidhur për shfrytëzimin e sipërfaqeve pyjore dhe kullimore, për aktivitet bujqësor, objekte banimi etj.

Tabela nr. 7: Pagesa e kontratave aktive për asetet e dhëna me qira

Nr.	Subjekti	Kontrata nr. datë	Sip ha	Afati në vite	Vlera Vjetore e Qirasë	Paguar	Debitor 31.12.2021
1	K.G	Nr.4, datë 05.01.2021	8	30	48,000	48,000	0
2	K.N	Nr.794 datë 11.12.2020	1.1607	30	6,964	13,928	
3	S.Xh	ë ë ë ..Datë 16.03.2021	2.15	30	12,900	12,900	0
4	S.N	ë ë ë ..Datë 01.02.2021	1.5	30	7,500	7,500	0
5	G.I	Nr.257, datë 12.06.2013	4	10	28,000	0	84,000
6	2...	Nr.611, datë 01.04.2021	0.125	1	55,000	55,000	55,000
7	F.Shpk	Nr 03, datë 12.01.2015 Nr.03, datë 01.06.2016	0.63 0.63	9 9	465,000 91,350		2,241,900
8	E.C	Nr.1412, datë 03.08.2021	0.73 ha/500 m ²	1	156,940	156,940	0
9	B.	Nr.2408, datë 17.11.2020	1.2	1	105,534	105,534	0
10	F.	Nr.1, datë 29.07.2019	10.160	10	827,515	827,515	2,160,000
11	O.	Nr.4063/6 datë 19.12.2012	0.03	9	261,500	261,500	0
12	Alb Telecom Sh.a	Nr.1836, datë 01.09.2020	0.02	9	160,000	160,000	0
13	V.	Nr.3126, datë 19.06.2019	0.03	1	369,500	369,500	0
14	V.	Nr.22, datë 01.07.2019	7.048	5	549,744	549,744	0
15	V.	Nr.23, datë 01.07.2019	0.05	5	100,000	100,000	0

⁸ Kodi Civil i Republikës së Shqipërisë, nenet 826-840, ligjin nr. 139/2015, óPër Vetëqeverisjen Vendore, neni 36, VKM nr. 54, datë 5.2.2014 óPër përcaktimin e kriterëve, të procedurës e të mënyrës së dhënies me qira, enfiteozë apo kontrata të tjera të pasurisë shtetërore, e ndryshuar, VKM nr. 391 datë 21.06.20006, ndryshuar me VKM nr. 1064, datë 22.12.2010 óPër përcaktimin e tarifave në sektorin e pyjeve dhe të kullotave.

16	N.	Pa kontratë	0.5	1	39,000	39,000	0
17	N.	Pa kontratë	0.5	1	100,000	100,000	0
18	A.	Nr. 1178 prot. datë 04.06.2020	1.4	3	134,400	134,400	0
19	V.	Pa kontratë qiraje	0.672	Akt marr. Nr. 2621, datë 15.12.2020 Nr.1107 datë 18.05.2022	52,416	52,416	52,416
20	Drejtoria Rajonale.Sigurimeve Shoqerore Kukes	Në bazë të VKB-ve Datë 01.01.2021		1	360,000	360,000	0
21	A.K	Datë 01.01.2021/ pa kontratë	0.33	1	25,740	0	128,700
22	A.K	Datë 01.01.2021/ pa kontratë	0.038	1	76,000	0	76,000
23	P.	Nr. 1553 prot. datë 16.07.2020	0.92	1	88,320		88,320
Totali							5,434,436

Burimi: Bashkia Has, përpunoi grupi i auditimit

Nga auditimi rezulton se:

- Qiramarrësi *G.I* nuk ka paguar detyrimin referuar kontratës nr. 257, datë 12.06.2013 në vlerë 84,000 lekë, detyrim ky që është kontabilizuar nga Drejtoria e Financës. Qiramarrësi *G.I* nuk është i përfshirë në listën e debitorëve progresiv.

- Qiramarrësi *F. SHPK* ka lidhur me Bashkinë Has kontratën me nr. 03, datë 12.01.2015 për marrjen e sipërfaqes 0.63 ha për 9 vjet me vlerë vjetore të kontratës 465,000 lekë. Rezulton se kjo kontratë është amenduar me kontratën nr. 3, datë 01.06.2016 ku sipërfaqja e marrë me qira dhe afati nuk ndryshon por ka ndryshuar vlera e kontratës në 91,350 lekë. Rezulton se, amendimi i kontratës nuk është i shoqëruar me asnjë relacion ku të shpjegohen arsyet e ndryshimit të vlerës së qirasë vjetore. Qiramarrësi ka paguar rregullisht detyrimin sipas amendimit të kontratës përkatësisht për 6 vite $x 91,350 = 548,100$ lekë, ndërkohë detyrimi që duhet të paguajë sipas kontratës bazë është 6 vite $x 465,000 = 2,790,000$ lekë. **Diferenca prej 2,241,900 lekë (2,790,000 - 465,000) përbën të ardhura të munguara në buxhetin e Bashkisë Has.** Kjo vlerë detyrimi nuk është e përfshirë në listën e debitorëve progresiv si dhe nuk është kontabilizuar.

Nga auditimi i pagesave të kontratave aktive të qirave rezulton se, 16 qiramarrës kanë paguar rregullisht detyrimin ndaj bashkisë ndërsa 7 qiramarrës nuk kanë paguar detyrimin për vitin 2021 apo edhe më herët në vlerën 5,434,436 lekë që përbën të ardhura të munguara në buxhetin e Bashkisë Has. Gjithashtu, për qiramarrësit që nuk kanë paguar detyrimet e qirasë nga Sektori i Taksave dhe Tarifave nuk është llogaritur kamatëvonesa prej 0.01% për çdo ditë vonesë por jo më shumë se 10% e vlerës së kontratës.

Nga vlera totale e detyrimit për pagesat e qirave të kontratave aktive është e përfshirë te lista e debitorëve progresiv detyrimi për 5 qiramarrës në vlerën 2,560,436 lekë dhe nuk është i përfshirë detyrimi në vlerën **2,325,900 lekë** (84,000 + 2,241,900) që përbën të ardhura të munguara në buxhetin e Bashkisë Has.

Gjithashtu, referuar tabelës më sipër konstatohen 3 subjekte (N., V., A.) të cilat shfrytëzojnë asete të Bashkisë Has dhe nuk kanë një kontratë të nënshkruar me bashkinë, veprime në kundërshtim me përcaktimet e Kodit Civil të Republikës së Shqipërisë, nenet 826-840, ligjit nr. 139/2015, óPër Vetëqeverisjen Vendore, neni 36, VKM-së nr. 54, datë 5.2.2014 óPër

përcaktimin e kriterëve, të procedurës e të mënyrës së dhënies me qira, enfiteozë apo kontrata të tjera të pasurisë shtetërore, e ndryshuar, VKM nr. 391 datë 21.06.20006, ndryshuar me VKM nr. 1064, datë 22.12.2010 për përcaktimin e tarifave në sektorin e pyjeve dhe të kullotave.

Për veprimet dhe mosveprimet e mësipërme ngarkohet me përgjegjësi, z. S.L me Detyrë Drejtor i Drejtorisë së Pyjeve si dhe z. U.H me detyrë Përgjegjës i Sektorit të Tatim Taksave.

Kriteri: Kodi Civil i Republikës së Shqipërisë, nenet 826-840.

Ligji nr. 139/2015 për Vetëqeverisjen Vendore, neni 36.

VKM nr. 54, datë 5.2.2014 për përcaktimin e kriterëve, të procedurës e të mënyrës së dhënies me qira, enfiteozë apo kontrata të tjera të pasurisë shtetërore, e ndryshuar.

VKM nr. 391 datë 21.06.20006, ndryshuar me VKM nr. 1064, datë 22.12.2010 për përcaktimin e tarifave në sektorin e pyjeve dhe të kullotave.

Ndikimi: Mungesë të ardhurash në buxhetin e Bashkisë Has nga mos arkëtimi i detyrimeve nga qiramarrësit.

Shkaku: Strukturat e Bashkisë Has nuk kanë qenë efektive në mbledhjen e detyrimeve të qirave nga subjektet qiramarrëse si dhe nuk kanë respektuar përcaktimet ligjore për dhënien me qira të aseteve të tyre.

Rëndësia: E lartë

Rekomandim 1: Sektori i Taksave dhe Tarifave Vendore në Bashkinë Has, të marrë masat dhe të ndjekë të gjitha hapat ligjorë për arkëtimin e vlerës që lind nga mos pagesa e kontratave të qirasë për qiramarrësin *G.I për vlerën 84,000 lekë* dhe subjektin *F*. ShPK për vlerën **2,241,900 lekë**. Gjithashtu, në vijimësi Sektori i Taksave dhe Tarifave Vendore të ndjekë zbatimin e kushteve të kontratave të qirasë me të gjithë qiramarrësit, si dhe për vonesat në pagesa të llogarisë kamatëvonesat referuar kushteve të kontratave.

Rekomandim 2: Sektori i Taksave dhe Tarifave Vendore në Bashkinë Has, të marrë masa për lidhjen e menjëhershme të kontratave të qirasë me subjektet *ón.ô, óV.ô* dhe *óA.ô*, që kanë në përdorim objekte/prona/sipërfaqe në pronësi të Bashkisë Has.

Taksat dhe tarifat familjare

Titulli i gjetjes 7: *Mos ngarkim i familjeve për detyrimet vendore.*

Situata: Në Bashkinë Has aktualisht familjet ngarkohen me detyrime për tarifën e pastrimit dhe taksën e ndërtesës. Nga të dhënat që disponon Bashkia Has rezulton se kanë paguar detyrimet për këto dy taksa/tarifa 1499 familje me vlerë 1,176,650 lekë. Bashkia Has, Sektori i Tatimeve nuk ka të dhëna lidhur me numrin e familjeve që kanë detyrimin për të paguar tarifën e pastrimit dhe taksën e ndërtesës, nuk ka të dhëna lidhur me nivelet e pritshmërisë së tyre si dhe nuk ka të dhëna se sa është numri i familjeve që janë debitore ndaj bashkisë. Gjithashtu, familjet në Bashkinë Has nuk ngarkohen për detyrimet vendore për taksat dhe tarifat e tjera të miratuara me Vendim të Këshillit Bashkiak, si për shembull taksa e tokës bujqësore, taksa e truallit, tarifën e gjelbërimit, veprime këto në kundërshtim me përcaktimet e VKB-në nr. 104 datë 25.12.2020 për miratimin e taksave dhe tarifave vendore në Bashkinë Has për vitin 2021. Bashkia Has nuk ka agjent tatimor për mbledhjen e taksave/tarifave nga familjet por i mbledh ato me paraqitjen e qytetarëve pranë zyrave të bashkisë/njësive administrative për të marrë shërbime të ndryshme. Sektori i Taksave dhe Tarifave Vendore regjistron vetëm të dhëna lidhur me familjet që paguajnë ndërsa për familjet debitore nuk ka një regjistër. Si rezultat, **procesi i ngarkimit të familjeve për detyrimet vendore nuk është i dokumentuar si dhe nuk dihet numri i familjeve debitore dhe vlera totale që ato kanë ndaj bashkisë.**

Për veprimet dhe mosveprimet e mësipërme ngarkohet me përgjegjësi, z. P.C me Detyrë Drejtor i Drejtorisë së Financës, Buxhetit, Taksave dhe Tarifave Vendore si dhe z. U.H me detyrë Përgjegjës i Sektorit të Tatim Taksave.

Kriteri: VKB-në nr. 104 datë 25.12.2020 óPër miratimin e taksave dhe tarifave vendore në Bashkinë Has për vitin 2021ó.

Ndikimi: Mungesë të ardhurash në buxhetin e Bashkisë Has.

Shkaku: Strukturat e Bashkisë Has nuk kanë respektuar përcaktimet e VKB-së për paketën fiskale duke mos ngarkuar familjet për detyrimet vendore.

Rëndësia: E lartë

Rekomandim: Bashkia Has, Sektori i Taksave dhe Tarifave Vendore të marrë masa për krijimin e regjistrit të taksave dhe tarifave vendore për taksapaguesit e kategorisë familjare me të gjitha të dhënat e nevojshme, i cili të shërbejë si bazë për të bërë llogaritjen e detyrimeve vendore që ju lindin familjeve referuar paketës fiskale të miratuar të Bashkisë Has.

Menaxhimi i borxhit

Titulli i gjetjes 8: *Mbi nivelin e borxhit tatimor në Bashkinë Has dhe masat e marra për uljen e tij.*

Situata: Nga auditimi i dokumentacionit të Sektorit të Taksave dhe Tarifave Vendore u konstatua se subjektet janë njoftuar periodikisht për detyrimet e taksave dhe tarifave vendore, si dhe janë rinjoftuar në rastet e vonësive në pagesat e detyrimeve vendore. Gjendja e debitorëve për subjektet fizik/juridik paraqitet për vitin 2021 paraqitet në vijim.

Nga auditimi rezulton se, vlera totale e borxhit tatimor në mënyrë progresive në Bashkinë Has paraqitet:

Për vitin 2020, borxhi tatimor në Bashkinë Has është në shumën **39,472,122 lekë**

Vlera e borxhit e krijuar gjatë vitit 2021 është 4,166,512 lekë nga të cilat:

- Detyrimet nga taksat dhe tarifat për personat fizikë/juridikë në shumën 3,419,026 lekë;
- Detyrime nga institucionet shtetërore në shumën 104,240 lekë;
- Detyrime nga qiratë e tregut (markata) në shumën 643,246 lekë.

Për vitin 2021 gjenda e debitorëve progresiv në Bashkinë Has është:

- Detyrimet nga taksat dhe tarifat e bizneseve, detyrime nga autorizimet e subjekteve hidrokarbure, detyrime nga kontratat e fondit pyjor kullësor (kontrata aktive dhe jo aktive) rezultojnë në vlerën totale **26,643,184 lekë për 187 biznese;**
- Qira të ambienteve të tregut (Markata) detyrime në vlerën **3,743,941 lekë;**
- Detyrime nga kontratat e aseteve në vlerën **2,325,900 lekë;**
- Detyrime nga institucione publike në vlerën **154,480 lekë.**

Për veprimet dhe mosveprimet e mësipërme ngarkohet me përgjegjësi, z. P.C me Detyrë Drejtor i Drejtorisë së Financës, Buxhetit, Taksave dhe Tarifave Vendore si dhe z. U.H me detyrë Përgjegjës i Sektorit të Tatim Taksave.

Masat e marra për uljen e borxhit

Sektori i Tatim Taksave në Bashkinë Has është përgjegjëse për të mbledhur detyrimet e papaguara në përputhje me përcaktimet ligjore në fuqi. Në zbatim të ligjit nr. 9920, datë 19.5.2008 óPër Procedurat Tatimore në Republikën e Shqipërisëó, i ndryshuar dhe Udhëzimit nr. 24, datë 02.09.2008, hapat që duhet të ndërmerren me qëllim mbledhjen e detyrimeve të papaguara vijnë duke u përshkallëzuar si:

1. Njoftimi dhe kërkesa për të paguar;

2. Urdhri i bllokimit të llogarive bankare të tatimpaguesit;
3. Masa e sigurimit të detyrimit tatimor;
4. Sekuestrimi i pasurisë.

Referuar dokumentacionit të vënë në dispozicion lidhur hapat që janë ndjekur për të mbledhur detyrimet rezulton se, janë njoftuar të gjithë bizneset debitorë për kalimin e afatit të pagesave të detyrimit për taksat dhe tarifatat vendore.

Pas dërgimit të njoftimeve, për subjektet që kanë vazhduar të rezultojnë debitorë për detyrimet vendore, janë nxjerrë urdhrat përkatës për të ndërmarrë masa të tjera bazuar në përcaktimet e kuadrit ligjor të sipër cituar. Përkatësisht, janë nxjerrë urdhrat që ju janë dërguar bankave të nivelit të dytë për bllokimin e llogarive bankare të 52 tatimpaguesve debitorë.

Si rezultat i këtyre masave të marra nga debitorët që rezultojnë në fund të vitit 2020 gjatë vitit 2021 kanë likuiduar detyrimet ndaj bashkisë **25 subjektme vlerë 856,844 lekë**.

Kriteri: Ligji nr. 9920, datë 19.5.2008 óPër Procedurat Tatimore në Republikën e Shqipërisëó i ndryshuar, nenet 89,90,91,93.

Ndikimi: Mungesë të ardhurash në buxhetin e Bashkisë Has.

Shkaku: Mos zbatimi efektiv i kërkesave ligjore për arkëtimin e detyrimeve për taksat dhe tarifatat vendore nga debitorët.

Rëndësia: E lartë

Rekomandim: Sektori i Taksave dhe Tarifave Vendore në Bashkinë Has, të marrë masa për nxjerrjen e njoftimit të vlerësimit tatimor për debitorët, duke ndjekur të gjitha rrugët për arkëtimin e detyrimeve për taksat dhe tarifatat vendore në fund të vitit 2021 në vlerën:

- **26,643,184 lekë** për 187 subjekte private;
- **3,743,941 lekë** për qirata e ambienteve të tregut;
- **2,325,900 lekë** nga kontratat e dhënies me qira të aseteve;
- **154,480 lekë** nga institucione publike;

a-T'u dërgohen bankave të nivelit të dytë urdhër bllokimit e llogarive bankare.

b-Të dërgohet në Drejtorinë Rajonale të Transportit, kërkesa për vendosjen e barrës siguruese (për mjetet) dhe në ASHK (për pasuritë e paluajtshme).

c-Në funksion të mbledhjes së detyrimit të papaguar, Sektori i Taksave dhe Tarifave Vendore, të angazhohet për të verifikuar dhe monitoruar në vend aktivitetin tregtar të tatim paguesit, me qëllim konfiskimin në fund të çdo dite të një shume jo më pak se 50 % të qarkullimit të realizuar.

d- Nëse edhe pas njoftimeve zyrtare subjektet, nuk pranojnë të paguajnë detyrimet, nga ana e Sektorit të Taksave dhe Tarifave Vendore, të merren masa administrative apo sekuestro dhe pas marrjes së këtyre masave të bëhet kallëzim penal.

e-Sektori i Taksave dhe Tarifave Vendore të bashkërendojë punën me QKB Bashkia Has, për mos kalimin e subjekteve debitorë me status pasiv ose mbyllje dhe lejimin e tyre në debitorë të keq.

f- Në regjistrat e debitorëve, të evidentohen vlera e detyrimit të pa arkëtuar, statusi i tyre dhe hapat e ndërmarrë për çdo subjekt në zbatim të ligjit për arkëtimin e debitorëve.

Akt marrëveshjet për pagesën me këste të detyrimeve

Titulli i gjetjes 9: Mos zbatim i detyrimeve të akt marrëveshjeve për pagesën me këste të detyrimeve vendore.

Situata: Në zbatim të ligjit nr. 9920, datë 19.5.2008 óPër Procedurat Tatimore në Republikën e Shqipërisëó i ndryshuar, Bashkia Has ka lidhur marrëveshje për pagesën me këste të detyrimeve të prapambetura me disa subjekte debitorë që sqarohen më të detajuara në vijim.

Tabela nr. 8: Akt marrëveshjet e lidhura në vitin 2021

Nr.	Akt-marrëveshja	Subjekti	Detyrimi	Shuma e	Shuma e	
-----	-----------------	----------	----------	---------	---------	--

			në marrëveshje	paguar në lekë	mbetur në lekë	
1	Nr. 2621 prot, 15.12.2021	V.M	349,200	275,940	73,260	Deri më 16.09.2021
2	Nr. 28 prot, 17.08.2021	R.	124,796	31,120	93,676	Deri më 18.12.2021
3	Nr. 2841 prot, 15.10.2021	E.M	98,000	28,000	70,000	Deri më 15.12.2022
4	Nr. 2697 prot, 03.11.2021	H.U	52,770	31,680	21,090	Deri më 03.11.2022
5	Nr. 2769 prot, 08.11.2021	Sh.D	70,700	36,000	34,700	Deri më 08.10.2022
6	Nr. 2776 prot, 08.11.2021	F.D.	82,897	33,431	49,466	Deri më 08.10.2022
7	Nr. ë prot, 15.12.2021	K.D.	130,754	69,294	61,460	Deri më 15.12.2022
8	Nr. 3176 prot, 29.12.2021	G.D.	120,432	45,602	74,830	Deri më 29.04.2022
Totali				551,067	478,482	

Burimi: Bashkia Has, përpunoi grupi i auditimit

Nga auditimi i zbatimit të kushteve të akt marrëveshjeve rezulton se, nuk kanë zbatuar kushtet e akt marrëveshjes subjekti óV.ô i cili është debitor në vlerën **73,260 lekë** edhe pse duhet të kishte paguar që më datë 16.09.2021 dhe subjekti óR.ô SHPK është debitor në vlerën **93,676 lekë**, ndërkohë që duhet të kishte paguar që më datë 18.12.2021. Nga Bashkia Has, Sektori i Tatim Taksave nuk janë marrë masa për zgjidhjen e marrëveshjes së pagesës me këste në kundërshtim me përcaktimet e ligjit nr. 9920, datë 19.05.2008 óPër Procedurat Tatimore në Republikën e Shqipërisëô i ndryshuar, neni 78.

Për veprimet dhe mosveprimet e mësipërme ngarkohet me përgjegjësi z.U.H me detyrë Përgjegjës i Sektorit të Tatim Taksave.

Kriteri:Ligji nr. 9920, datë 19.05.2008 óPër Procedurat Tatimore në Republikën e Shqipërisëô i ndryshuar, neni 78.

Ndikimi:Mos arkëtim i detyrimeve në mungesë të ardhurash në buxhetin e Bashkisë Has.

Shkaku:Mos zbatim i detyrimeve të akt marrëveshjeve nga subjektet debitore dhe mbikëqyrje jo efektive nga ana e Sektorit të Tatim Taksave.

Rëndësia:E mesme

Rekomandim:Sektori i Taksave dhe Tarifave Vendore të monitorojë me përgjegjësi zbatimin e kushteve të akt marrëveshjeve që ka lidhur me subjektet debitore dhe të marrë masat e duhura në rast të mos zbatimit të kushteve të përcaktuara në akt marrëveshje nga bizneset debitore.

Subjektet që ushtrojnë aktivitet në fushën e hidrokarbureve

Titulli i gjetjes 10: *Mbi pajisjen me autorizim për ushtrimin e aktivitetit të subjekteve që tregtojnë lëndë djegëse.*

Situata: Grupi i auditimit auditoi dokumentacionin lidhur me pajisjen e subjekteve me autorizim për ushtrimin e aktivitetit në zbatim të legjislacionit në fuqipërkatësisht:

- Ligjit nr. 8450, datë 24.2.1999 óPër përpunimin, transportimin dhe tregtimin e naftës, të gazit dhe nënprodukteve të tyreô, i ndryshuar me ligjin nr. 71/2014 óPër disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 8450, datë 24.2.1999, ópër përpunimin, transportimin dhe tregtimin e naftës, gazit dhe nënprodukteve të tyreô, të ndryshuar, neni 4, neni 20/pika 2;

- VKM nr. 344, datë 19.04.2017 óPër disa ndryshime dhe shtesa në VKM nr. 970, datë 02.12.2015, “Për përcaktimin e procedurave dhe të kushteve për dhënien e licencave për tregtimin e naftës bruto dhe nënprodukteve të sajô, pika 2/9 óPagesa për dhënien dhe përsëritjen e licencave për stacionet e shitjes së karburanteve, gazit të lëngshëm, të naftës për automjetet dhe vajrat lubrifikante, është 3,000,000 (tre milionë) lekë për Bashkinë e Tiranës dhe 1,000,000 (një milion) lekë për bashkitë e tjera”.

Referuar dokumentacionit të paraqitur rezulton se, në territorin e Bashkisë Has për periudhën objekt auditimi kanë ushtruar aktivitet në fushën e tregtimit të lëndëve djegëse me pakicë 9 subjekte të paraqitura në tabelën në vijim.

Tabela nr. 9: Subjektet që ushtrojnë aktivitet në shitjen e lëndëve djegëse me pakicë

Nr	Operatori Ekonomik	Adresa	Autorizimi Bazë	Niveli tarifës sipas VKM nr. 344	Pagesa viti 2021	Detyrime për t'u paguar për autorizimet
1	óS.ô shpk	Krumë	10.09.2020 -09.09.2025	1,000,000	200,000	600,000
2	óD.ô shpk	Krumë	18.11.2019 -17.11.2022	1,000,000	200,000	200,000
3	óV.ô shpk	Krumë	01.11.2021 - 16.10.2026	1,000,000	200,000	800,000
4	óE.ô shpk	Krumë	19.11.2020 - 19.11.2025	1,000,000		900,000
5	óK.ô shpk	Golaj	18.04.2018 - 17.04.2021 20.08.2021 - 17.04.2023	1,000,000	200,000	707,000
6	óXh.ô shpk	Vranisht	19.04.2019 - 18.04.2024	1,000,000	200,000	800,000
7	óG.ô shpk	Vranisht	14.03.2015 - 14.03.2020 Ka bërë pagesë soka autorizim	1,000,000	200,000	800,000
8	óH.ô shpk	Golaj	14.01.2020 - 13.01.2025	1,000,000	200,000	800,000
9	óD.ô shpk	Krumë	06.03.2020 - 05.03.2021 29.03.2021 - 28.03.2022	100,000	20,000	0
						5,607,000

Burimi: Bashkia Has

Nga auditimi rezulton se, Bashkia Has ka pajisur rast pas rasti me autorizim/licencë subjektet që ushtrojnë aktivitet për shitjen e lëndëve djegëse me pakicë dhe ka hartuar akt marrëveshje me to lidhur me pagesën e detyrimit për autorizimin. Marrëveshja konsiston në krijimin e mundësisë për subjektet që detyrimin e autorizimit në vlerën prej 1,000,000 lekë për 5 vite ta paguajnë me kështë vjetore në vlerën 200,000 lekë. Konstatohet se 8 subjekte kanë paguar rregullisht detyrimin vjetor për autorizimin/licencën. Subjekti óG.Shô shpk të cilit i ka përfunduar autorizimi më datë 14.03.2020 nuk është pajisur me autorizim të ri nga Bashkia Has në kundërshtim me përcaktimet ligjore, përkatësisht:

- Ligjin nr. 8450, datë 24.02.1999 óPër përpunimin, transportimin dhe tregtimin e naftës, të gazit dhe nënprodukteve të tyreô, i ndryshuar me ligjin nr. 71/2014 óPër disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 8450, datë 24.2.1999, óPër përpunimin, transportimin dhe tregtimin e naftës, gazit dhe nënprodukteve të tyreô, të ndryshuar, neni 4 óUshtrimi i veprimtarive në fushën e përpunimit, transportimit dhe tregtimit të naftës, gazit e nënprodukteve të tyre bëhet vetëm nga persona juridikë, pasi të jenë pajisur paraprakisht me lejet dhe autorizimet përkatëse, sipas përcaktimeve të këtij ligji. Në mungesë të këtyre lejeve dhe autorizimeve, veprimtaria e kryer quhet e paligjshmeô, neni 15 "...Stacionet e shitjes së karburanteve lejohen të ushtrojnë veprimtarinë e tyre vetëm pasi të jenë pajisur nga organi kompetent me autorizimin përkatës, sipas këtij ligji...", neni 20-Autorizimet pika 2, óAutorizimet për personat juridikë, që ushtrojnë veprimtaritë e parashikuara në pikat "ç" dhe "d" të nenit 11⁹, jepen nga organi i pushtetit vendor për një periudhë deri në 5 vjet me të drejtë përsëritjejeô;

⁹Ligji nr. 8450, datë 24.2.1999 óPër përpunimin, transportimin dhe tregtimin e naftës, të gazit dhe nënprodukteve të tyreô, i ndryshuar, neni 11-Personat juridikë, që i nënshtrohen këtij ligji, në përputhje me natyrën e veprimtarisë së ushtruar, klasifikohen si vijon: ç) stacionet e shitjes së karburanteve, që ushtrojnë veprimtarinë e tregtimit të

- VKM nr. 970, datë 02.12.2015, "Për përcaktimin e procedurave dhe të kushteve për dhënien e licencave për tregtimin e naftës bruto dhe nënprodukteve të saj, kreu II, pika 3 *óDhënia e licencave për njësitë e shitjes së lëndëve djegëse, për veprimtarinë e tregtimit për përdorim nga konsumatorët fundorë, bëhet nga organet e qeverisjes vendore.*

Edhe pse nuk është pajisur me autorizim, subjekti óG.Shô SHPK ka paguar vlerën prej 200,000 lekë vlerë për të cilën nuk ka dokumentacion nga Bashkia Has se për cilën periudhë është kjo pagesë. Referuar praktikës që ka ndjekur Bashkia Has duke i lejuar subjektet të paguajnë detyrimin për autorizimin me këste vjetore dhe përfundimit të autorizimit paraardhës (datë 14.03.2020) subjekti óG.Shô SHPK duhet të kishte kryer dy pagesa vjetore dhe jo një sikurse ka kryer. Vlera e mbetur për t'u paguar nga subjektet që janë pajisur me autorizim por me marrëveshje detyrimin e paguajnë me këste është 5,607,000 lekë dhe është e regjistruar të lista e debitorëve progresiv.

Për veprimet dhe mosveprimet e mësipërme ngarkohet me përgjegjësi, z. P.C me Detyrë Drejtor i Drejtorisë së Financës, Buxhetit, Taksave dhe Tarifave Vendore si dhe z. U.H me detyrë Përgjegjës i Sektorit të Tatim Taksave.

Kriteri:Ligji nr. 8450, datë 24.2.1999 óPër përpunimin, transportimin dhe tregtimin e naftës, të gazit dhe nënprodukteve të tyre, i ndryshuar me ligjin nr. 71/2014 óPër disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 8450, datë 24.2.1999, ópër përpunimin, transportimin dhe tregtimin e naftës, gazit dhe nënprodukteve të tyre, të ndryshuar, neni 4, neni 20, pika 2.

Ndikimi:Mungesë të ardhurash në buxhetin e Bashkisë Has.

Shkaku:Puna jo efektive e Sektorit të Tatim Taksave në identifikimin në kohë të përfundimit të afateve të autorizimeve për ushtrimin e aktivitetit si dhe mos ndjekja e hapave ligjorë për subjektet që vazhdojnë të ushtrojnë aktivitet pa autorizim.

Rëndësia:E lartë

Rekomandim:Sektori i Taksave dhe Tarifave Vendore të shqyrtojë dokumentacionin e subjektit óG. Shô SHPK dhe të marrë masa që ky subjekt të pajiset menjëherë me autorizimin/licencën për ushtrimin e aktivitetit duke paguar vlerën e mbetur prej 800,000 lekë ndaj Bashkisë Has për 5 vjet duke filluar nga data 14.03.2020. Gjithashtu, Sektori i Taksave dhe Tarifave Vendore të ndjekë rregullisht pagesat periodike të autorizimeve për të gjithë subjektet e tjera me qëllim që të bëjë të mundur pagesat e plota brenda afateve.

Mbi realizimin e të ardhurave nga Inspektorati i Mbrojtjes së Territorit Bashkia Has

Titulli i gjetjes 11:*Mbi mos funksionimin e IMTV-së në Bashkinë Has.*

Situata: Referuar Urdhrit nr. 09 datë 11.01.2021 óPër strukturën organizative të Bashkisë Has, në Bashkinë Has nuk është e ngritur struktura e Inspektoratit të Mbrojtjes së Territorit Vendor. Në strukturën aktuale janë 2 punonjës të emëruar në pozicionin e Inspektorit të terrenit (1 në Sektorin e Planifikimit të Territorit dhe Urbanistikës dhe 1 në NjA Golaj).

Në Bashkinë Has për vitin 2021 struktura e IMTV-së nuk ka qenë funksionale. Kjo vjen si rezultat i mungesës së një Sektori të Mbrojtjes së Territorit dhe mungesës së Kryeinspektorit, në kundërshtim me përcaktimet e ligjit nr. 9780, datë 06.07. 2007 óPër Inspektimin dhe Mbrojtjen e Territorit nga Ndërtimet e Kundërligjshme, i ndryshuar, **neni 4** *óPranë çdo njësie vendore ngrihet inspektorati i mbrojtjes së territorit, i cili, nëpërmjet kryeinspektorit e inspektorëve,*

karburanteve për automjete; d) njësitë e shitjes së lëndëve djegëse, që ushtrojnë veprimtarinë e tregtimit të tyre për përdorim nga konsumatorët fundorë.

brenda territorit administrativ të kësaj njësie, ushtron përgjegjësinë e kontrollit të territorit dhe zbatimit të ligjshmërisë së standardeve teknike e kushteve zhvillimore në fushën e planifikimit dhe zhvillimit të territorit dhe të atyre të parashikuara shprehimisht në ligje të tjera. Inspektorati i mbrojtjes së territorit i njësisë vendore drejtohet nga kryeinspektori, i cili emërohet nga kryetari i njësisë vendore përkatëse”, neni 13 ó Brenda 10 ditëve nga mbajtja e procesverbalit të konstatimit të kundërvajtjes, Inspektorati Kombëtar i Mbrojtjes së Territorit dhe ai i njësisë vendore nxjerrin vendimin për marrjen e masave përkatëse dhe dhënien e sanksioneve administrative, të cilat nënshkruhen nga kryeinspektoriô, VKM nr. 894, datë 04.11.2015 ó Për unifikimin e procedurave të kontrollit të territorit nga Inspektorati Kombëtar i Mbrojtjes së Territorit dhe ai i Njësisë Vendoreô, **pika 1/b/ii** ... kryen kontrolle në territorin administrativ të njësisë vendore, në bazë të planit mujor të punës, të miratuar nga kryeinspektori, **pika 1/c/i** Inspektorati i Mbrojtjes së Territorit të njësisë vendore realizon kontrolle nëpërmjet ,... një grupi inspektimi, i cili ka në përbërje jo më pak se dy inspektorë; **pika 4...** Inspektorati Kombëtar i Mbrojtjes së Territorit dhe ai i njësisë vendore nxjerrin vendimin për marrjen e masave përkatëse dhe dhënien e sanksioneve administrative, të cilat nënshkruhen nga kryeinspektori. Bashkia Has nuk ka respektuar përcaktimet e ligjit nr. 9780, datë 06.07. 2007 ó Për Inspektimin dhe Mbrojtjen e Territorit nga Ndërtimet e Kundërligjshmeô, i ndryshuar, neni 4. Gjithashtu, nga ana e Kryetarit të Bashkisë Has nuk janë marrë masa për të ngritur Sektorin e Kontrollit të Territorit.

Si përfundim, nga mos funksionimi i plotë i Inspektoratit të Mbrojtjes së Territorit nga Bashkia Has nuk mund të vendosen gjopa apo të merren masa të tjera për veprimet e kundërligjshme të konstatuara në mbrojtjen e territorit.

Për veprimet dhe mosveprimet e mësipërme ngarkohen me përgjegjësi, z. L.M në cilësinë e Titullarit të Bashkisë Has.

Kriteri: Ligji nr. 9780, datë 16.07.2007 ó Për Inspektimin dhe Mbrojtjen e Territorit nga ndërtimet e kundërligjshmeô, i ndryshuar, neni 4, neni 13.

VKM nr. 894, datë 04.11.2015 ó Për unifikimin e procedurave të kontrollit të territorit nga Inspektorati Kombëtar i Mbrojtjes së Territorit dhe ai i Njësisë Vendoreô, pika 1/b/ii, pika 1/c/i , pika 4.

Ndikimi: Nuk kryhet kontrolli i territorit dhe zbatimi i ligjshmërisë dhe i standardeve teknike në fushën e planifikimit dhe zhvillimit të territorit. Nga mos funksionimi i plotë i Inspektoratit të Mbrojtjes së Territorit nga Bashkia Has nuk mund të vendosen gjopa apo të merren masa të tjera për veprimet e kundërligjshme të konstatuara në mbrojtjen e territorit.

Shkaku: Bashkia Has nuk ka zbatuar detyrimet ligjore për inspektimin dhe mbrojtjen e territorit nga ndërtimet e kundërligjshme.

Rëndësia: E lartë

Rekomandim: Kryetari i Bashkisë të marrë të gjitha masat për të krijuar të plotë strukturën e Inspektoratit të Mbrojtjes së Territorit në Bashkinë Has me qëllim zbatimin e ligjshmërisë në fushën e kontrollit dhe zhvillimit të territorit.

2.3 Mbi vlerësimin e raportimit financiar, për të arritur në opinionin për pasqyrat financiare për vitin 2021

Në zbatim të pikës 3 të programit të auditimit nr. 569/1 datë 13.06.2022, u shqyrtua dokumentacioni si më poshtë:

- Lista emërore e punonjësve nga Zyra e Burimeve Njerëzore, ku përfshihen funksioni, niveli i pagës për pozicion, kategoria statusi i punonjësit, dhe kontrata individuale e punonjësve, si dhe urdhrat e emërimit të punonjësve. etj.
- Lista emërore dhe evidenca mbi emërimin e punonjësve nga Zyra e Burimeve Njerëzore dhe kontrata individuale e punonjësve, etj.
- Bilancet kontabël dhe pasqyrat financiare për vitin 2021 dërguar dhe rakorduar me Degën e Thesarit Has.
- Analitikët për vitin 2020 të llogarive;
 - 468 Debitor të ndryshëm
 - 4342 Operacione me shtetin (të drejta)
 - 481 Shpenzime për t'u shpërndarë
 - 486 Shpenzime të periudhave të ardhshme,
 - 202 Studime dhe Kërkime
 - 210 Toka, Troje, Terrene
 - 211 Pyje, Plantacione
 - 212 Ndërtesa e Konstruksione
 - 213 Rrugë, rrjete, vepra ujore
 - 214 Instalime teknike, makineri e pajisje
 - 215 Mjete Transporti
 - 218 Inventari ekonomik
 - 24 AAGJ të dëmtuara
 - 230 SHP.AAGJMM në proces
 - 231 ShP.AAGJMM në proces
 - 401-408 Furnitorë e llogari të lidhura me to
 - 466 Kreditorë për mjete në ruajtje
 - 467 Kreditorë të ndryshëm
 - 475 Të ardhura për t'u regjistruar
- Dokumentet origjinale justifikuese dhe argumentuese të regjistruara për kryerjen e veprimeve financiare kontabël (mandat arkëtime, mandat pagesa, kontrata, fatura, situacione, urdhër shpenzime, fletë hyrje, fletë dalje, etj).
- Situacionet e shpenzimeve për vitin 2021 i rakorduar me Degën e Thesarit Has.

Mbajtja e kontabilitetit është bërë në zbatim të kërkesave të nenit 3, pika 1, të ligjit nr. 9228, datë 29.04.2004 “Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare”, ligjit 25/2018 datë 10.05.2018 “Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare” VKM nr. 783, datë 22.11.2006 “Për përcaktimin e standardeve dhe rregullave kontabël” pjesa e parë “Rregulla të përgjithshme” kapitulli i parë “Mbajtja e kontabilitetit” dhe Planit Kontabël të miratuar për institucionet dhe UMF nr. 14, datë 28.12.2006, “Për përgatitjen dhe raportimin e pasqyrave financiare vjetore, për institucionet qendrore, organet e pushtetit vendor dhe të njësive që varen prej tyre”, ndryshuar me UMF nr. 26, datë 27.12.2007 “Për përgatitjen dhe raportimin e pasqyrave financiare vjetore të institucioneve qendrore, organet e pushtetit vendor dhe njësitë që varen prej tyre si dhe njësive të menaxhimit/zbatimit të projekteve e marrëveshjeve me donatorët e huaj “dhe dhe udhëzimi i MF nr. 08, datë 09.03.2018” Për procedurën e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore të njësive të Qeverisjes së Përgjithshme”, ndryshuar me Udhëzimin e MFE nr. 05, datë 21.02.2022.

Pasqyrat Financiare Vjetore të vitit ushtrimor 2021 janë hartuar dhe depozituar më datën 30.03.2022 në Degën e Thesarit Has, brenda afatit ligjor.

Qëllimi i auditimit: Qëllimi i auditimit të pasqyrave financiare është të rrisim shkallën e besimit të përdoruesve të pasqyrave financiare, nëpërmjet shprehjes së një opinioni nga ana jonë nëse pasqyrat financiare janë përgatitur në të gjitha aspektet materiale, në përputhje me kornizën e zbatueshme të raportimit financiar, si një mekanizëm kontrolli për të siguruar përgjegjshmërinë financiare.

Kjo përgjegjshmëri ka të bëjë drejtpërdrejt me menaxhimin e shëndoshë financiar si dhe me faktin që, rezultatet dhe përdorimi i burimeve janë të paraqitura drejt dhe në përputhshmëri me kornizën e raportimit financiar.

Audituesit shtetëror do të japin sigurinë ose jo nëse informacioni i paraqitur mbi shpenzimin e parave publike në programet publike përfaqëson në mënyrë të përshtatshme situatën financiare.

Objektivat e auditimit: Objektivat specifike të auditimit ose pohimet për marrjen e garancive për besueshmërinë e pasqyrave financiare janë:

- Pohimet rreth klasave të transaksioneve dhe ngjarjeve për periudhën nën auditim si; përkatësia, plotësia, saktësia, periudha, klasifikimi, ligjshmëria dhe rregullsia.
- Pohimet rreth gjendjeve të llogarive në fund të periudhës si; ekzistenca, të drejtat dhe detyrimet, plotësia, vlerësimi dhe alokimi.
- Pohimet rreth prezantimit të shënimeve shpjeguese si: transaksionet, të drejtat dhe detyrimet, plotësia, klasifikimi dhe kuptueshmëria, saktësia dhe vlerësimi.

Dokumentimi i rezultateve të auditimit: Nga audituesit u përgatit dokumentacioni i auditimit i mjaftueshëm dhe i mbështetur në *testet e kontrollit dhe testet thelbësore të transaksioneve* për të mundësuar dhe kuptuar natyrën, kohën dhe shtrirjen e procedurave të auditimit të kryera në përputhje me standardet përkatëse dhe kërkesat e zbatueshme ligjore dhe rregullatorë, rezultatet e këtyre procedurave dhe evidencat e marra të auditimit, si dhe çështje të rëndësishme, që dolën gjatë auditimit, përfundimet e arritura në drejtim të tyre dhe gjykimet e rëndësishme profesionale të bëra në arritjen e këtyre konkluzioneve. Ky dokumentacion është i përshtatshëm dhe i rëndësishëm për të konfirmuar dhe mbështetur opinionet dhe raportin e audituesve dhe shërben si një burim informacioni për përgatitjen e tyre.

Përputhshmëria me kërkesat ligjore për Raportimin Financiar: Përgatitja dhe miratimi i Pasqyrave Financiare, në Bashkinë Has, është realizuar në mbështetje të kërkesave të ligjit nr. 9228, datë 29.04.2004 *“Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare”* i ndryshuar, dhe ligjit 25/2018 datë 10.05.2018 *“Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare”* akteve të tjera nënligjore në fuqi, në funksion të këtij ligji. Pasqyrat financiare janë dorëzuar brenda afateve të parashikuara në ligjet dhe aktet nënligjore të sipërcituara. Pasqyrat financiare janë plotësuar në përputhje me kërkesat ligjore dhe formatet e miratuara nga Ministria e Financave.

Mbajtja e Kontabilitetit dhe Hartimi i Pasqyrave Financiare

Në fund të periudhës ushtrimore 2021 janë plotësuar 7 Formate, (pasqyra financiare), sipas formularëve standard të miratuara me UMF nr.08, datë 09.03.2018 *“Për procedurën e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore të njësive të Qeverisjes së Përgjithshme”*, ndryshuar me Udhëzimin e MFE nr. 05, datë 21.02.2022.

Formati 1 në Pasqyra e Pozicionit Financiar

Formati 2 në Pasqyra e Performancës Financiare

Formati 3 në Pasqyra e Flukseve Monetare (*Cash Flow*)

Formati 4 në Pasqyra e ndryshimeve në Aktivet Neto/ Fondet Neto

Formati 5- Pasqyra e shënimeve shpjeguese

Formati 6 në Pasqyra e investimeve dhe e burimeve të financimit

Formati 7/a në Pasqyra mbi gjendje dhe ndryshimet e aktiveve afatgjata me koston historike

Formati 7/b - Pasqyra mbi gjendje dhe ndryshimet e aktiveve afatgjata me vlerën neto

Formati 8 - Pasqyra mbi numrin e punonjësve dhe fondin e pagave

Mbajtja e kontabilitetit dhe funksionimi i llogarive sintetike me llogaritë analitike.

Në këtë Bashki, kontabiliteti mbahet në mënyrë manuale, që e bën me risk të lart për sa i përket sigurisë në saktësinë e informacionit që marrim nga ky sistem kontabiliteti.

Mbi aktivet e qëndrueshme të trupëzuara dhe të pa trupëzuara.

a. Objektivat e auditimit të aktiveve të qëndrueshme, janë që të sigurohemi se:

Aktivitet ekzistojnë; ato i përkasin subjektit; janë të vlerësuara në mënyrë korrekte; janë regjistruar në mënyrë korrekte; është bërë mirë ndarja midis shpenzimeve dhe aktiveve të qëndrueshme; informacionet që ndodhen në aneksin përkatës janë të plota dhe korrekte.

b. Kontrollat të llogarive dhe dokumenteve

1. Pasqyra e pozicionit financiar (F1)

Aktivitet neto janë të barabarta me Aktivitet-Pasivitet = **2,148,395,154** lekë.

	Viti 2021	Viti 2020
AKTIVET	2,266,926,732	2,330,777,355
PASIVET(DETYRIMET)	118,531,578	130,222,886
AKTIVET NETO/ FONDET (A-B)	2,148,395,154	2,200,554,469

Burimi: Bashkia Has

1.1 Aktivitet afatshkurtra

Aktivitet afatshkurta më datë 31.12.2021 paraqiten në vlerën **155,785,920** lekë dhe përbëhen nga:

- Llogaritë e Klasës 5 óMjetet monetare dhe ekuivalentet e tyre në shumën 22,984,332 lekë;
- Llogaritë e Klasës 3 óGjendje inventari qarkullues në shumën 22,188,858 lekë;
- Llogaritë e Klasës 4 óLlogari të arkëtueshme në shumën 91,523,537 lekë dhe óTë tjera aktive afatshkurtra në shumën 19,089,193 lekë.

- Llogaritë e Klasës 5 “Mjetet monetare dhe ekuivalentet e tyre” përbëhet nga:

Llogaritë kontabël	Emërtimi i llogarive	Viti 2021	Viti i 2020	Diferenca 2021-2020
531	Mjete monetare në arkë	-	-	-
512	Mjete monetare në bankë	-	-	-
520	Disponibilitete në thesar	22,984,332	19,039,888	3,944,444
50	Letra me vlerë	-	-	-
532	Vlera të tjera	-	-	-
54	Akredeitiva dhe paradhënie	-	-	-
59	Provizione zhvlerësimi	-	-	-
	TOTALI	22,984,332	19,039,888	3,944,444

Burimi: Bashkia Has

Vlera e llogarisë 520 óDisponibilitete në thesarô në shumën **22,984,332**lekë, përbëhet nga:

- Llog 466 óKreditorë për mjete në ruajtjeô në shumën 7,918,848 lekë; dhe
- Llog 85 óRezultati i veprimtarisë ushtrimoreô që ndërkohë është në shumën 15,065,484 lekë.

Llogaria 520 óDisponibiliteti në thesarô paraqet gjendjen e saktë në bilanc dhe për rrjedhojë llogaria 85 óRezultati i veprimtarisë ushtrimoreô është pasqyruar saktë në bilanc.

Llogaritë e klasës 5, kanë funksionuar duke u debituar për shtesat në kredi të llogarive përkatëse për të ardhurat dhe grante të ndryshme, si dhe duke u kredituar për pakësimet në debi të llogarive përkatëse të klasës 4.

- Llogaritë e Klasës 3 “Gjendje inventari qarkullues”, përbëhet nga:

Llogaritë kontabël	Emërtimi i llogarive	Viti 2021	Viti 2020	Diferenca 2021-2020
31	Materiale	623,299	431,228	192,071
32	Objekte inventari Inventar i imët	21,565,559	25,206,045	(3,640,486)
33	Prodhime, punime e shërbime në proces			
34	Produkte			
35	Mallra			
36	Gjë e gjallë në rritje e majmëri			
37	Gjendje të pambritura ose pranë të tretëve			
38	Diferenca nga çmimet e magazinimit			
39	Provigjione për zhvlerësim të inventarit(-)			
	TOTALI	22,188,858	25,637,273	(3,448,415)

Burimi: Bashkia Has

Llogaritë e Klasës 3, sipas Pasqyrës së Pozicionit Financiar të Bashkisë Has në 31.12.2021 paraqitet në vlerën **22,188,858 lekë** dhe përbëhet nga:

- Llogaria kontabël 31 óMaterialeô për shumën 623,299 lekë;
- Llogaria kontabël 32 óObjekte inventariô për shumën 21,565,559 lekë;
- Diferenca me vitin e mëparshëm përfaqëson lëvizjen e inventarit në shumën 3,640,486 lekë dhe materialeve në shumën 192,071 lekë, e cila kuadron me llogarinë 63 óNdryshimi i Gjendjes së Inventaritô në shumën 3,448,415 lekë.

- Llogaria 312 “Materiale” ka vlerën 623,299 lekë dhe lëvizjet e kësaj llogarie për vitin 2021 paraqiten në tabelën e mëposhtme:

Lëvizjet e llogarisë	Vlera në lekë
Gjendje në 01.01.2021	431,228
Hyrjet në magazinë gjatë vitit 2021	13,618,372
Dalje nga magazina gjatë vitit 2021	13,426,301
Gjendja në 31.12.2021	623,299

Burimi: Bashkia Has

- Llogaria 327 “Objekte inventari” ka vlerën 21,565,559 lekë dhe përputhet me rezultatin e inventarizimit vjetor dhe nuk ka ndryshime. Lëvizjet e llogarisë 32 óObjekte inventariô paraqiten në tabelën e mëposhtme:

Lëvizjet e llogarisë	Vlera në lekë
Gjendja në 01.01.2021	25,206,045
Hyrje gjatë vitit 2021	593,066
Dalje gjatë vitit 2021	4,233,552
Gjendja në 31.12.2021	21,565,559

Burimi: Bashkia Has

Gjendja e llogarive të mësipërme është e kuadruar me gjendjen e inventarëve. Për kryerjen e tyre është zbatuar udhëzimi i MF nr. 30, datë 27.12.2012 "Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik". Titullari i Bashkisë Has ka nxjerrë Urdhër nr.44, datë 25.01.2022 óPër inventarizimin dhe vlerësimin e aktiveve për vitin 2021ó, ku është përcaktuar komisioni me 34 anëtarë (përfshirë kryetarin e komisionit dhe nën kryetarin) për inventarizimin fizik dhe vlerësimin e aktiveve, shoqëruar me Programin e punës për secilën njësi shpenzuese.

Llogaritë e klasës 3 kanë funksionuar duke u debituar për shtesat në kredi të llogarisë 63 óNdryshimi i gjendjeve të inventaritó dhe duke u kredituar për daljet e inventarit në debi të llogarisë 63 óNdryshimi i gjendjeve të inventaritó.

- Llogaritë Klasës 4 “Llogari të arkëtueshme” & “Të tjera aktive afatshkurtra” përbëhen nga:

Llogaritë kontabël	Emërtimi i llogarive	Viti 2021	Viti 2020	Diferenca 2021-2020
	Llogari të arkëtueshme			
411	Klientë e llogari të ngjashme			
423,429	Personeli, paradhënie, deficite e gjoba	914,949	914,949	0
431	Tatime e taksa	-	-	-
432	Tatime mbledhur nga shteti për llog. Pushtetit Lokal	-	-	-
433	Shpenzime fatkeqësi natyrore që mbulon shteti	-	-	-
435	Sigurime Shoqërore	-	-	-
436	Sigurime Shëndetësore	-	-	-
437,438	Organizma të tjerë shoqërore	-	-	-
44	Institucione të tjera publike	-	-	-
466	Kreditorë për mjete në ruajtje	-	-	-
468	Debitorë të ndryshëm	67,319,252	67,254,420	64,832
4342	Të tjera operatione me shtetin(debitor)	23,289,336	22,064,258	1,225,078
45	Marrëdhënie me instit. brenda dhe jashtë sistemit	-	-	-
49	Shuma të parashikuara për zhvleresim(-)	-	-	-
	TOTALI	91,523,537	90,233,627	1,289,910
	Të tjera aktive afatshkurtra	-	-	-
409	Furnitorë (Debitorë),parapagime pagesa pjesore	-	-	-
473	Llogari të pritjes të marrëdhënieve me thesarin	-	-	-
477	Diferenca konvertimi aktive	-	-	-
481	Shpenzime për tû shpërndarë në disa ushtrime	-	-	-
486	Shpenzime të periudhave të ardhshme	19,089,193	28,833,238	(9,744,045)
	TOTALI	19,089,193	28,833,238	(9,744,045)

Burimi: Bashkia Has

- Llogaria 468 “Debitorë të ndryshëm” në fund të vitit 2021 është në vlerën 67,319,252 lekë. Kjo shumë është rritur krahasuar me tepricën e vitit 2020 dhe debitorët e tatim taksave të krijuara ndër vite në shumën 67,254,420 lekë me 64,832 lekë.

Lëvizjet e llogarisë	Vlera në lekë
Gjendja në 01.01.2021	67,254,420
Shtesa gjatë vitit 2021 debitorët e taksave (D)	4,166,512
Pakësime gjatë vitit 2021 (K)	4,101,680
Gjendja në 31.12.2021	67,319,252

Burimi: Bashkia Has

Gjatë shqyrtimit të llogarive analitike për vitin 2021 janë evidentuar debitorët për taksat dhe tarifatat vendore. Duke rakorduar me zyrën e Taksave dhe Tarifave të Bashkisë Has, janë evidentuar detyrimet për vitin 2021, detyrime të cilat paraqitet si më poshtë vijon:

Debitore Bashkia Has dhe NJA	Gjendja 31.12.2021	Gjendja 31.12.2020
Debitorë Biznes i Madh	5,136,446	2,700,430
Debitorë Biznes i Vogël	1,310,078	718,596
Debitorë nga Taksa e tokës bujqësore	-	-
Debitorë nga Taksat e familjes(asete të mbartura)	-	-
TOTALI	60,807,896	63,900,226

Burimi: Bashkia Has

Titulli i gjetjes 12: *Pasaktësi në llogarinë 468 “Debitor të ndryshëm”*

Situata: Për diferencën prej 6,511,356 lekë e llogarisë 468 óDebitorë të ndryshëmô krahasuar me vlerën e bilancit 67,319,252 lekë me atë analitike prej 60,807,896 lekë, nuk ka informacion justifikues mbi origjinën e krijimit të tyre. Në bilanc nuk janë futur detyrimet e nxjerra nga auditimi i mëparshëm i KLSH mbi individët dhe furnitorët debitor nga mos arkëtimi i dëmeve ekonomike edhe pse janë rekomandime të pranuar për tu zbatuar.

Kriteri: Ligji 10296 datë 08.07.2010 óPër menaxhimin financiar dhe kontrollinô neni 6; të nenit 10 dhe 11, të ligjit nr. 9228, datë 29.4.2004, óPër kontabilitetin dhe pasqyrat financiareô, ligjin nr. 25/2018 datë 10.05.2018 óPër kontabilitetin dhe Pasqyrat Financiareô datë udhëzimin nr.8 datë 09.03.2018 óPër procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në njësitë e qeverisjes së përgjithshmeô, ndryshuar me udhëzimin nr.5, datë 21.02.2022, pika të drejtat dhe detyrimet:

Ndikimi: Ky konstatim jep një paraqitje jo reale të vlerës financiare të pasqyruar në bilanc duke deformuar informacionin dhe gjendjen financiare të raportuar.

Shkaku: Mos njohja dhe mos zbatim i legjislacionit në fushën e kontabilitetit.

Rëndësia: E lartë

Rekomandimi: Nëpunësi Zbatues, të përfshijë në llogarinë 468 óDebitor të ndryshëmô edhe dëmet e konstatuara nga KLSH në auditimet e mëparshme si dhe të justifikojë diferencën prej 6,511,356 lekë të llogarisë 468 óDebitorë të ndryshëmô.

Për veprimet dhe mosveprimet e mësipërme mban përgjegjësi: Drejtoria e Menaxhimit Financiar dhe Buxhetit z. P.C (NZ).

- **Llogaria 4342 “Të tjera operacione me shtetin (debitor)”**, në fund të vitit 2021 paraqitet në vlerën 23,289,336 lekë dhe kuadron me Llogarinë 7206 óFinancim i pritshëm nga buxhetiô të Pasqyrës së Performancës Financiare e cila paraqitet në shumën 23,289,336 lekë. Vlera prej 23,289,336 lekë përfaqëson llogaritë e Klasës së 4 të Pasivit të Pasqyrës Financiare të Pozicionit Financiar, si dhe përbëhet nga:

Lëvizjet e llogarisë	Vlera në lekë
Gjendja në 01.01.2021	22,064,258
Shtesa gjatë vitit 2021 (D)	23,977,256
Pakësime gjatë vitit 2021 (K)	22,752,178
Gjendja në 31.12.2021	23,289,336

Burimi: Bashkia Has

Në mënyrë analitike paraqitet:

Llogaritë kontabël	Emërtimi i llogarive	Viti 2021
401-408	Furnitorë e llogari të lidhura me to	7,821,909
42	Detyrime ndaj personelit	11,388,568
431	Detyrime ndaj shtetit për tatim taksa	619,410
435	Sigurime Shoqërore	3,003,242
436	Sigurime Shëndetësore	456,207
437,438,	Organizma të tjerë shtetërore	0
TOTALI		23,289,336

Burimi: Bashkia Has

- **Llogaria 486 “Shpenzime të periudhave të ardhshme”** në fund të vitit 2021 paraqitet në vlerën 19,089,193 lekë.

Lëvizjet e llogarisë	Vlera në lekë
Gjendja në 01.01.2021	28,833,238
Shtesa gjatë vitit 2021 (D)	4,176,110
Pakësime gjatë vitit 2021 (K)	13,920,155
Gjendja në 31.12.2021	19,089,193

Burimi: Bashkia Has

Vlera e kësaj llogarie në shumën **19,089,193 lekë**, përfaqëson detyrime për shpenzime të kryera, por të pa financuara në vitin ushtrimor. Gjatë vitit 2021 ka patur pakësim (në vlerë absolute) të kësaj llogarie, pasi janë likuiduar një pjesë e konsiderueshme e këtyre detyrimeve.

Emërtimi i llogarive	Vlera
Shenzime gjyqësore	395,178
Shpenzime operative	1,050,000
Shpenzime për investime	13,467,905
TOTALI	19,089,193

Burimi: Bashkia Has

Evidentimi i tyre në Pasqyrat Financiare të vitit 2021, është kryer veçmas në përputhje me Udhëzimin nr 8, datë 09.03.2019, ndryshuar me Udhëzimin e MFE nr. 05, datë 21.02.2022, pika 42 ku cilësohet: *“Të gjitha Njësitë e qeverisjes së përgjithshme duhet të evidentojnë veçmas detyrimet e prapambetura të tyre ndaj të tretëve për shpenzime, shërbime apo investime të kryera, por të pa financuara”*.

Llogaritë e klasës 4, kanë funksionuar duke u debituar për njohjen e të drejtave për t'u arkëtuar në kredi të llogarive të klasës 7 dhe duke u kredituar për arkëtimin e të drejtave në debi të llogarive financiare të klasës 5.

1.2 Aktivet afatgjata

Mbi Aktivet Afatgjata jo materiale (AAJM)

Llogaritë e Klasës 20 óAktivet Afatgjata Jo materiale në vlerën prej **2,629,022 lekë** përbëhen nga:

- **Llog.202 “Studime dhe kërkime”**, në vlerën 2,629,022 lekë.

Lëvizjet e llogarisë	Vlera në lekë
Gjendja në 01.01.2021	3,546,277
Shtesa gjatë vitit 2021 (D)	0000

Pakësime gjatë vitit 2021 (K)	0000
Gjendja në 31.12.2021 (D)	2,629,022

Burimi: Bashkia Has

Testi substancial

Aktive Afatgjata jo materiale në fund të vitit 2021 rezulton në vlerën neto 2,629,022 lekë dhe përbëhet nga Llogaria 202 óStudime e kërkimeô.

Titulli i gjetjes 13: Pasaktësi në llogarinë 202 “Studime dhe kërkime”

Situata: Nga verifikimi i analizës analitike të llogarisë 202 óStudime dhe Kërkimeô, konstatohet se vlera e studimeve dhe projekteve të paraqitura në bilanc, i përkasin edhe objekteve të përfunduara përpara vitit ushtrimor 2021, duke siguruar vlerësimin jo real të llogarisë 202 dhe AAJM, në vlerën 1,613,998 lekë.

Kriteri: Ligji nr. 9228, datë 29.04.2004 óPër kontabilitetin dhe pasqyrat financiareó neni 6,9 dhe 10; UKM nr. 2, datë 08.05.2003 óPër klasifikimin dhe strukturën e kostos së punimeve të ndërtimitô, i ndryshuar, pika ócô, nën pika óbô.

Ndikimi: Ky konstatim jep një paraqitje jo reale të vlerës financiare të pasqyruar në bilanc duke deformuar informacionin dhe gjendjen financiare të raportuar.

Shkaku: Mos njohja dhe mos zbatim i legjislacionit në fushën e kontabilitetit.

Rëndësia: E lartë

Rekomandimi: Nëpunësi Zbatues, të kryej veprimet e sistemimit për llogarinë 202 óStudime dhe Kërkimeô duke siguruar përfshirjen në këtë llogari të studimeve dhe kërkimeve vetëm për objektet ende të papërfunduara në vitin ushtrimor të mbylljes së bilancit.

Për veprimet dhe mosveprimet e mësipërme mban përgjegjësi: Drejtoria e Menaxhimit Financiar dhe Buxhetit z. P.C (NZ).

Mbi Aktive afatgjata financiare

Testet substanciale

Aktive Afatgjata Financiare rezultojnë në fund të viti 2021 me vlerën 0 lekë dhe në fund të vitit 2020 në vlerën 0 lekë, siç shihet edhe në Pasqyrën e Pozicionit Financiar të paraqitur më poshtë:

Nr. Reshti	Referenca e Llogarive	E M E R T I M I	Ushtrimi i Mbyllur	Ushtrimi Paraardhës
59	25-26	3.Aktive Afatgjata Financiare	0	0
60	25	Huadhënie e Nënhuadhënie	0	0
61	26	Pjesëmarrje në kapitalin e vet	0	0

Burimi: Bashkia Has

Bashkia Has, në Qendrën Kombëtare të Biznesit, paraqitet si pjesëmarrëse me 100 % të Ujësjetllës Kanalizime Has Sh.A me NUIS përkatëse J66702907H.

Vlera aksionare që Bashkia Has zotëron në Ujësjetllës Kanalizime Has Sh.A prej vitit 2001 është 77,334,000 lekë e cila është shoqëri aksionere me objekt óShërbimi i furnizimit me ujë të pijshëm i konsumatorëve dhe shitja e tij. Mirëmbajtja e sistemit/eve të furnizimit me ujë të pijshëm. Prodhimi dhe/ose blerja e ujit për plotësimin e kërkesës së konsumatorëve. Shërbimi i grumbullimit, largimit dhe trajtimit të ujërave të ndotura, shitja e tij. Mirëmbajtja e sistemeve të ujërave të ndotura, si dhe të impianteve të pastrimit të tyreô.

Kjo vlerë e kapitalit me 100% aksione në pjesëmarrje të Bashkisë Has në óUjësjejlës Kanalizime Has Sh.A ó nuk paraqitet në aktivet afatgjata financiare të Bilancit kontabël 2021, më konkretisht në llogarinë 26 **“Pjesëmarrje në kapitalet e veta”** në zbatim të Urdhrit të Ministrisë nr. 64 datë 22.07.2014 óPër shpallje të Standardeve Kombëtare të Kontabilitetit të Përmirësuarat me Standardin Kombëtar të Kontabilitetit nr. 5 óAktivet Afatgjata Materiale dhe Aktivet Afatgjata Jo materiale ó pika 55, 56, 57 si dhe me Standardin Kombëtar të Kontabilitetit nr.14 óTrajtimi kontabël i investimeve në pjesëmarrje.

Kapitalit me 100% aksione në pjesëmarrje të Bashkisë Has në óUjësjejlës Kanalizime Has Sh.A përbën investim me vlerë kontabël (kosto) 77,334,000 lekë dhe investitori është Bashkia Has.

Titulli i gjetjes 14: Mbi kontabilizimin e llogarisë 26 **“Aktivet Afatgjata Financiare”**.

Situata: Kapitalit me 100% aksione në pjesëmarrje të Bashkisë Has në óUjësjejlës Kanalizime Has SHA, përbën investim me vlerë kontabël (kosto) 77,334,000 lekë dhe investitori është Bashkia Has, për të cilën nuk janë reflektuar në gjendjen e llogarisë 26 óAktivet Afatgjata Financiare fitim-humbjet nga pjesa e aksioneve për vitet 2001-2021. Kjo procedurë mos pasqyrimi në Aktivet Afatgjata Financiare të Bilancit Kontabël të vlerës së aksioneve të cilat janë investime në pjesëmarrje me vlerë kontabël 77,334,000 lekë përbën shtrembërim të informacionit financiar. Veprimet e mësipërme janë në kundërshtim me Udhëzimin nr.8/2018 óPër procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në NJQP ópika 2.1, ndryshuar me Udhëzimin nr. 5, datë 21.02.2022

Kriteri: UMF nr.64 datë 22.07.2014 óPër shpallje të Standardeve Kombëtare të Kontabilitetit të Përmirësuarat me Standardin Kombëtar të Kontabilitetit nr.5 óAktivet Afatgjata Materiale dhe Aktivet Afatgjata Jo materiale ó pika 55, 56, 57 si dhe me Standardin Ndërkombëtar të Kontabilitetit nr.28 óInvestime në Pjesëmarrje ó pika 35

Ndikimi: Mos regjistrimi në kontabilitet dhe deformim i informacionit financiar për sa i përket gjendjes kontabël të paraqitur në Pasqyrat e Pozicionit Financiar për vitet 2001-2021 të llogarisë 26 óPjesëmarrje në kapitalin e vet, gjendje kjo e nën vlerësuar.

Shkak: Mos njohja dhe mos zbatim i ligjit nr. 9228 datë 29.04.2004 óPër kontabilitetin dhe pasqyrat financiare, urdhrit nr. 64 datë 22.07.2014 óPër shpallje të Standardeve Kombëtare të Kontabilitetit të Përmirësuarat, Standardit Kombëtar të Kontabilitetit nr.5 óAktivet Afatgjata Materiale dhe Aktivet Afatgjata Jo materiale dhe Standardit Ndërkombëtar të Kontabilitetit nr. 28 óInvestime në Pjesëmarrje.

Rëndësia: E lartë

Rekomandimi: Nëpunësi Zbatues të marrë masa për të bërë sistemimet në kontabilitet dhe regjistrimin e pjesëmarrjes 100% në kapitalin aksionar të óUjësjejlës Kanalizime Has SHA me vlerë kontabël 77,334,000 lekë në debi të llogarisë 26 óPjesëmarrje në kapitalin e vet dhe kredi të llogarive financiare të klasës 5, për pjesëmarrjen me kapitalin e vet.

Për veprimet dhe mosveprimet e mësipërme mban përgjegjësi: Drejtoria e Menaxhimit Financiar dhe Buxhetit z. P.C.

Mbi Aktivet e afatgjata materiale (AAM)

- **Llogaritë e Klasës 21 “Aktivet Afatgjata Materiale”,** AAM sipas të dhënave të pasqyruara për vitin ushtrimor 2020, paraqiten në shumën 2,084,278,145 lekë. Në vitin pasardhës 2021, vlera totale e AAM-ve paraqitet në shumën 1,997,421,158 lekë, me një pakësim të AAM-ve në shumën 10,393,120 lekë në total, ku pjesën më të madhe e zënë sistemim veprimi për llogarinë 24 dhe nxjerrjet jashtë përdorimit të AQT në Bashkinë Has dhe amortizimi i tyre .

Duke analizuar veprimet e shitesave dhe pikësimeve të AAM-ve sipas të dhënave të siguruar nga zyra e financës paraqiten si në tabelën më poshtë:

Nr.	Llogaria	Emërtimi	Gjendja me 31.12.2020	SHTESA	PAKSIME	Gjendja me 31.12.2021
1	210	Toka,troje,Terrene	1,074,183	-	-	1,074,183
2	211	Pyje,Kullota Plantacione	0	-	-	0
3	212	Ndërtim e Konstruksione	781,725,198	-	13,859,803	733,469,916
4	213	Rruge,rrjete,vepra ujore	1,240,910,396	14,773,068	227,139	1,193,479,852
5	214	Instalime teknike, makineri,pajisje,vegla pune	27,499,421	892,440	1,969,126	23,275,649
6	215	Mjete transporti	21,070,871	-	6,119,500	19,873,350
7	218	Inventar ekonomik	11,998,076	469,200	4,352,260	5,684,095
		TOTALI	2,084,278,145	16,134,708	26,527,828	1,997,421,158

Burimi: Bashkia Has

- **Llogaria. 210 “Toka, Troje, Terrene”** është në vlerën 1,074,183 lekë e pandryshuar dhe në 2021 njëlloj si vitet e mëparshme, për të cilën nuk ka inventar kontabël dhe as inventar fizik.

Përshkrimi i aktivitetit	Copë	Data e hyrjes, viti	Vlera e shpenz. Kapitale	Vlera e blerjes	Vend-ndodhja	Personi përgjegjës	Vlera e ak.e amortizimit
Shpronësim për interes Publik (Ndërtim rruge e trotuare Qyteti Krume)	1	20/03/2017	1,074,183	1,074,183	Krume, Qytet		0
SHUMA TOTALE 210				1,074,183			

Burimi: Bashkia Has

- **Llogaria 211 “Pyje, Plantacione”** paraqitet e pandryshuar prej 0 lekë e pandryshuar dhe në 2021 njëlloj si vitet e mëparshme, për të cilën nuk ka inventar kontabël, dhe as inventar fizik, por vetëm VKM nr.433, datë 8.6.2016 e transferimit të administrimit të pyjeve dhe kullotave nga MM në administrim të NJQV.

Mungesa e inventarizimit dhe regjistrimit në ASHK të pasurive të njësisë vendore, si toka, troje, terrene, pyje, kullota, plantacione, ka sjellë mos pasqyrimin në pasqyrat financiare të njësisë vendore për vitin 2021, duke bërë që këto pasqyra të mos paraqesin vlerën e saktë të këtyre aseteve të njësisë vendore.

Titulli i gjetjes 15: *Mangësi në regjistrin kontabël për aktivet afatgjata materiale dhe jomateriale*

Situata: Kryetari i Bashkisë Has dhe Nëpunësi Zbatues nuk kanë marrë masa për kryerjen e procesit të inventarizimit të aktiveve për llogarinë 210 “Toka, Troje, Terrene” dhe llogarinë 211 “Pyje, Kullota, Plantacione” të paraqitur 0 lekë në bilanc, në kundërshtim me VKM nr.433, datë 08.06.2016 e transferimit të administrimit të pyjeve dhe kullotave nga MM në administrim të NJQV, Udhëzimin nr.8/2018 për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në NJQP, pika 16,18 dhe VKM nr. 510, datë 10.06.2015 për miratimin e

procedurave për transferimin e të drejtave dhe detyrimeve, personelit, aktiveve, të trupëzuara dhe të patrupëzuara, të arkivave dhe çdo dokumentacioni tjetër zyrtar në njësitë e qeverisjes vendore, të prekura nga riorganizimi administrativo-territorial, Kreu VI óTransferimi i pasurive dhe regjistrimi i pasurive të paluajtshme.

Kriteri: VKM nr. 510, datë 10.06.2015 óPër miratimin e procedurave për transferimin e të drejtave dhe detyrimeve, personelit, aktiveve, të trupëzuara dhe të patrupëzuara, të arkivave dhe çdo dokumentacioni tjetër zyrtar në njësitë e qeverisjes vendore, të prekura nga riorganizimi administrativo-territorial, Kreu VI óTransferimi i pasurive dhe regjistrimi i pasurive të paluajtshme, VKM nr.433, datë 8.6.2016 óPër transferimin në pronësi të Bashkive të Pyjeve dhe të Kullotave Publike, sipas listave të inventarit dhe aktualisht në administrim të Ministrisë së Mjedisit e të ish Komunave/Bashkive.

Ndikimi: Paraqitja në pasqyrat financiare e vlerave përkatëse inventariale, pa kryer më parë inventarizimin e përvitshëm të tyre, sjell mos pasqyrim të saktë të këtyre vlerave, si rrjedhojë e mungesës së informacionit në mënyrë analitike, për secilin aset si pasojë e mungesës së një regjistri kontabël.

Shkaku: Mos njohja dhe mos zbatim i legjislacionit në fushën e kontabilitetit.

Rëndësia: E lartë

Rekomandimi: Kryetari i Bashkisë Has dhe Nëpunësi Zbatues të marrin masa për kryerjen e procesit të inventarizimit të aktiveve afatgjata materiale të pa inventarizuara deri më sot, përkatësisht për zërin 211 óPyje, Kullota, Plantacione dhe zërin 210 óToka, troje, terrene. Të hartohet regjistri i aktiveve për këto prona me të gjithë elementët e nevojshëm, si data e hyrjes ose marrjes në dorëzim, përshkrimi i aktivitetit, vlerën e blerjes, datën e daljes në përdorim, personin përgjegjës, vlerën e akumuluar të amortizimit, kohën e shërbimeve të mirëmbajtjes, etj. *Për veprimet dhe mosveprimet e mësipërme mban përgjegjësi: Drejtoria e Menaxhimit Financiar dhe Buxhetit z. P.C.*

- **Llogaria e aktivitetit 212 “Ndërtesa dhe konstruksione”** e cila pasqyron gjendjen e aseteve për llogari të Bashkisë Has, në fund të vitit 2021 rezulton me një kosto historike 733,469,916 lekë dhe në fund të vitit 2020 rezulton me një kosto historike 781,725,198 lekë. Lista me kosto historike e ndërtesave dhe konstruksioneve së bashku me përlllogaritjen e amortizimit total dhe vjetor për vitin 2021.

Titulli i gjetjes 16: *Mangësi në regjistrin kontabël për aktivet afatgjata materiale dhe jomateriale*

Situata: Aktivet afatgjata materiale të llogarisë 212 óNdërtesa e Konstruksione, janë kontabilizuar në librat e kontabilitetit dhe pasqyrat financiare pa u mbështetur në një dokumentacion vërtetues, siç është titulli i pronësisë, ku gjatë auditimit u evidentua se Bashkia Has nuk ka iniciuar procesin për regjistrimin e tyre.

Kriteri: VKM nr. 510, datë 10.06.2015 óPër miratimin e procedurave për transferimin e të drejtave dhe detyrimeve, personelit, aktiveve, të trupëzuara dhe të patrupëzuara, të arkivave dhe çdo dokumentacioni tjetër zyrtar në njësitë e qeverisjes vendore, të prekura nga riorganizimi administrativo-territorial, Kreu VI óTransferimi i pasurive dhe regjistrimi i pasurive të paluajtshme

Ndikimi: Paraqitja në pasqyrat financiare e vlerave përkatëse inventariale, pa kryer më parë njohjen e pronës dhe statusin juridik të saj, lë hapësirë për interpretim jo të saktë të vlerës së pasqyruar në bilanc.

Shkaku: Mos njohja dhe mos zbatim i legjislacionit në fushën e kontabilitetit.

Rëndësia: E lartë

Rekomandimi: Titullari i Bashkisë Has dhe Nëpunësi Zbatues të marrin masa për nisjen e procesit të regjistrimit pranë ASHK-së së aktiveve afatgjata materiale për llogari të Bashkisë Has.

Për veprimet dhe mosveprimet e mësipërme mban përgjegjësi: Drejtoria e Menaxhimit Financiar dhe Buxhetit z. P.C.

- **Llogaria 215 “Mjete transporti”** paraqet vlerën e mjeteve të transportit në pronësi të Bashkisë Has më datë 31.12.2021 në shumën 30,985,206 lekë. Krahasuar me vitin e mëparshëm 2020 në vlerën 37,104,706 lekë. Që do të thotë se gjatë vitit 2021 ka patur pakësime në Llogarinë 215 (Mjete transporti për vlerën 6,119,500 lekë për sistemim llogaria 24 aktive afatgjatë të dëmtuara). Lista me kosto historike së mjeteve të transportit së bashku me përlllogaritjen e amortizimit total dhe vjetor për vitin 2021.

Lëvizjet e llogarisë	Vlera në lekë
Gjendja në 01.01.2021	37,104,706
Shtesa gjatë vitit 2021 (D)	0
Pakësime gjatë vitit 2021 (K)	6,119,500
Gjendja në 31.12.2021 (D)	30,985,206

Burimi: Bashkia Has

- **Llogaria kontabël 218 “Inventar ekonomik”** përfaqëson inventarin ekonomik në përdorim nga shkollat, kopshtet, çerdhet, njësitë administrative, institucionet e Bashkisë Has. Sipas pasqyrave financiare të Bashkisë Has gjendja e llogarisë 218 më datë 31.12.2021 paraqitet në vlerën 5,684,095 lekë me vlerën neto, rezultati i së cilës paraqitet si në tabelën mëposhtë:

Lëvizjet Llog. 218 “Inventar ekonomik” për vitin 2021, vlera	
Çelje me 01.01.2021	57,241,979
Blerje me pagesë (D)	469,200
Shtesa pa pagesë donacione dhurata	0
Dalje (K)	4,352,260
Amortizimi i vitit i akumuluar 2020	47,674,826
Gjendja me 31.12.2021 (D) Teprica Neto	5,684,095

Burimi: Bashkia Has

Lista me kosto historike inventarit ekonomik së bashku me përlllogaritjen e amortizimit total dhe vjetor për vitin 2021;

Llogaria 218 (Inventar ekonomik) amortizimin e akumuluar vjetor sipas amortizimit të kontabilitetit dhe analizës në regjistrin e aktivitetit paraqitet 47,674,826 lekë duke përdorur normë amortizimi 20% me Vlerë Fillestare dhe 25% me bazë grupimi, në përputhje me UMF nr. 8 datë 09.03.2018 “Për Procedurat e Përgatitjes, Paraqitjes dhe Raportimit të Pasqyrave Financiare Vjetore, pika 36 ku specifikohet “ Në lidhje me amortizimin e aktiveve afatgjata për sektorin publik, amortizimi i këtyre aktiveve duhet të llogaritet sipas normave të përcaktuara”, ndryshuar me UMFE nr.5, datë 21.02.2022

- **Llogaria 24 “Aktive afatgjata të dëmtuara”** paraqet vlerën e aktiveve afatgjata të dëmtuara në pronësi të Bashkisë Has më datë 31.12.2021 në shumën 20,564,113 lekë. Krahasuar me vitin e mëparshëm 2020 në vlerën 0 lekë. Që do të thotë se gjatë vitit 2021 ka patur shtesa në Llogarinë 24 (aktive afatgjata të dëmtuara). Lista me kosto historike e Aktive afatgjata të dëmtuara së bashku me përlllogaritjen e amortizimit total dhe vjetor për vitin 2021.

Lëvizjet e llogarisë	Vlera në lekë
Gjendja në 01.01.2021	0

Shtesa gjatë vitit 2021 (D)	20,564,113
Pakësime gjatë vitit 2021 (K)	0
Gjendja në 31.12.2021 (D)	20,564,113

Burimi: Bashkia Has

- **Llogaria 219 “Amortizimi i AAGJM & AAJM:** Kjo llogari sipas pasqyrave financiare të Bashkisë Has në fund të vitit 2021, paraqitet në vlerën 720,165,461 lekë, rezultati i së cilës ka ardhur i pasqyruar si në tabelën mëposhtë:

Pasqyra statistikore nr. 7.b “Aktivet afatgjata me vlerë neto”

		Teprica ne fillim	Shtesat gjate vitit	Pakësimet gjate vitit	Teprica ne Fund		
Nr.	EMERTIMI	Teprica	Kosto	Kosto	Kosto	Amortizim	Teprica
Reference		Neto	Historike	Historike	Historike	Akumuluar	Neto
Llogaritje							
b	c	3	4	6	8	9	10
20	I. AAGJ/JO MATERIALE	3,546,277	0	0	10,814,027	8,185,005	2,629,022
201	Prime te emisionit dhe rimbursimit te huave	0	0	0	0	0	0
202	Studime dhe kërkime	3,546,277	0	0	9,729,027	7,100,005	2,629,022
203	Koncesione, patenta,licenca e tjera ngjashme	0	0	0	1,085,000	1,085,000	0
21- 28	II. AAGJ/ MATERIALE	2,084,278,145	36,698,821	26,527,827	2,709,401,614	711,980,456	1,997,421,158
210	Toka,troje,Terrene	1,074,183	0	0	1,074,183	0	1,074,183
211	Pyje,Kullota Plantacione	0	0	0	0	0	0
212	Ndërtime e Konstruksione	781,725,198	0	13,859,803	966,447,807	232,977,891	733,469,916
213	Rruge,rrjete,vepra ujore	1,240,910,396	14,773,068	227,139	1,575,810,232	382,330,380	1,193,479,852
214	Instalime teknike,makineri,pajisje,vegla pune	27,499,421	892,440	1,969,126	61,161,153	37,885,504	23,275,649
215	Mjete transporti	21,070,871	0	6,119,500	30,985,206	11,111,856	19,873,350
216	Rezerva shtetërore	0	0	0	0	0	0
217	Kafshe pune e prodhimi	0	0	0	0	0	0
218	Inventar ekonomik	11,998,076	469,200	4,352,259	53,358,920	47,674,825	5,684,095
24	Aktive të Qend.te trupezuara të dëmtuara	0	20,564,113	0	20,564,113	0	20,564,113
28	Caktime	0	0	0	0	0	0
	TOTALI (I + II)	2,087,824,422	36,698,821	26,527,827	2,720,215,641	720,165,461	2,000,050,180

Burimi: Bashkia Has

Përlllogaritja e amortizimit të AAGJM-ve është bërë në përputhje me normat e amortizimit sipas llojit të aktivit të përcaktuar në Udhëzimin nr.8, datë 09.03.2019 óPër procedurat e përgatitjes

dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore, në njësitë e qeverisjes së përgjithshme, pika 36, ndryshuar me UMFE nr.05, datë 21.02.2022

Normat e amortizimit sipas llojit të aktivit të llogaritura nga Bashkia Has, janë si më poshtë:

- ndërtesat dhe konstruksionet, linja teknologjike, makineri e pajisje 5 %
- inventarin ekonomik (aktive të tjera afatgjata materiale mbi baze grupimi) 20 %
- për pajisjet kompjuterike, informatike (mbi bazë grupimi) 25 %
- për mjetet e transportit 13.8 %
- për aktivet afatgjata jomateriale (metoda lineare) 15 %

Mbi Investimet

- **Llogaria 230 dhe 231 "Investime"** për aktive afatgjata jo materiale dhe materiale sipas të dhënave të paraqitura në Pasqyrën e Pozicionit Financiar për vitin 2021, paraqiten në vlerën 111,090,632 lekë. Ky vlerësim financiar përkon me tabelën analitike të AAGJ materiale dhe jomateriale sipas tabelës mëposhtë. Në Pasqyrën statistikore nr. 6 "Investimet dhe burimi i financimit" shpenzimet për investime paraqiten në shumën 111,090,632 lekë.

Nr.	Emërtimi i investimit	Vlera
1	Aktive Afatgjata jomateriale	0
2	Aktive Afatgjata materiale	111,090,632
3	Totali	111,090,632

Burimi: Bashkia Has

Për investimet e kryera gjatë vitit 2021, është debituar saktë llogarinë 231 dhe kredituar llogaritë e klasës 4. Në fund të vitit, me kapitalizimin e tyre është kredituar llogaria 231 dhe është debituar llogaria 20 dhe 21 "Aktive afatgjata". Në mënyrë analitike aktivet afatgjata materiale dhe jomateriale.

1.3 PASIVET (DETYRIMET)

Pasivet Afatshkurtra

- **Llogaritë e klasës 4**, në pasiv të Pasqyrës së Pozicionit Financiar, janë llogari të pagueshme ato paraqesin detyrimet e Bashkisë Has më 31.12.2021, kundrejt furnitorëve, pagat e punonjësve të muajit dhjetor 2021, detyrimet kundrejt tatimeve, sigurimeve shoqërore dhe shëndetësore të muajit dhjetor 2021, kreditorë për mjete në ruajtje të cilat kryesisht kanë të bëjnë me garancitë e kontratave, kreditorë të ndryshëm etj., si më poshtë:

Llogaritë		Viti 2021	Viti 2020	Diferenca/ndryshimi
401-408	Furnitorë e llogari të lidhura me to	7,821,909	7,534,950	286,959
42	Detyrime ndaj personelit	11,388,568	10,799,086	589,482
431	Detyrime ndaj shtetit për tatim taksa	619,410	527,428	91,982
435	Sigurime Shoqërore	3,003,242	2,817,913	185,329
436	Sigurime Shëndetësore	456,207	384,881	71,326
437,438,	Organizma të tjerë shtetërorë	0	0	0
466	Kreditorë për mjete në ruajtje	7,918,848	11,156,021	-3,237,173
467	Kreditorë të ndryshëm	19,089,193	28,833,238	-9,744,045
4341	Operacione me shtetin(detyrime	68,234,201	68,169,369	64,832
	Gjendja më fund të periudhës	118,531,578	130,222,886	-11,691,308

Burimi: Bashkia Has

- **Llogaria 401-408 "Furnitorë e llogari të lidhura me to"**, në fund të vitit 2021 është në vlerën 7,821,909 lekë, paraqet gjendjen e faturave të pa likuiduara nga Bashkia Has më 31.12.2021.

Lëvizja e llogarisë 401-408 óFurnitorë e llogari të lidhura me toó, paraqitet në tabelën si më poshtë:

Lëvizja e Llog. 401-408 “Furnitorë e llogari te lidhura me to”	
Celje e vitit 2021	7,534,950
Shtesa (K)	7,577,232
Pakësime (D)	7,290,273
Gjendja në 31.12.2021 (K)	7,821,909

Burimi: Bashkia Has

Gjendja e llogarisë 401-408 në shumën 7,821,909 lekë përbëhet nga fatura të pa likuiduara për detyrime të muajit dhjetor, por që likuidohen në vitin pasardhës.

- **Llogaria 42, “Detyrime ndaj personelit”,** sipas pasqyrave financiare të paraqitura pranë Bashkisë Has, paraqitet në vlerën 11,388,568 lekë dhe përfaqëson vlerën e pagave të muajit Dhjetor për tû paguar në muajin Janar të vitit pasardhës.
- **Llogaria 431, “Detyrime ndaj shteti për tatim taksa”,** paraqitet në vlerën 619,410 lekë dhe përfaqëson vlerën për tû paguar për taksa e tatime ndaj shtetit për periudhat e kaluara si dhe detyrimet e muajit Dhjetor 2021 të cilat do të paguhën në periudhën pasardhëse.
- **Llogaria 435, “Sigurime shoqërore” dhe llogaria 436 “Sigurime shëndetësore”** paraqet vlerën e pa paguar për sigurime shoqërore e shëndetësore për pagat e muajit Dhjetor 2021 si dhe detyrimet e viteve të kaluara përkatësisht në vlerat 3,003,242 lekë dhe 456,207 lekë.
- **Llogaria 466 “Kreditore për mjete nën ruajtje”,** sipas Pasqyrës së Pozicionit Financiar të Bashkisë Has, në fund të vitit 2021 paraqitet në vlerën 7,918,848 lekë dhe përfaqëson vlerën e garancisë së kontratave në masën 5%, ose shumën 7,918,848 lekë. Një kopje të raporteve të llogarisë 466 dhe nën llogarive përkatëse

Lëvizja e Llog. 466 "Kreditorë për mjete në ruajtje"	
Celje e vitit 2021	11,156,021
Shtesa	1,759,085
Pakësime	4,996,258
Gjendja në 31.12.2021	7,918,848

Burimi: Bashkia Has

Titulli i gjetjes 17:Mbivlerësim i llogarisë 466 Kreditore për mjete nën ruajtje

Situata: Vlera e llogarisë 466 óKreditorë për mjete në ruajtjeónuk është e njëjtë me tepricën për të cilën ne kemi bërë rakordimin e llogarisë 520.

Nga analiza e kësaj llogarie rezultoi se vlera në fund të vitit 2021, ka pasur në përbërje të llogarisë detyrime për garanci punimesh të bashkisë ndaj subjekteve privatë, garanci këto të cilave u ka kaluar afati i përcaktuar në kontratat përkatëse të investimit dhe përsëri janë akoma gjendje në llogarinë 466 si shkak i ish Komunave dhe mungesës së informacionit. Në këtë rast garanci të cilave u ka kaluar afati sipas kontratës së lidhur, janë në vlerën 303,575 lekë pjesa tjetër është në afat.

Kriteri: Ligji nr. 28/2018 datë 10.05.2018 óPër kontabilitetin dhe pasqyrat financiareó neni 5, 6, 7, 9 dhe 10ó ; ligjin 10296 datë 08.07.2010 óPër menaxhimin financiar dhe kontrollinó neni 6, udhëzimin nr.8 datë 09.03.2018 óPër procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në njësitë e qeverisjes së përgjithshmeó seksioni óFunksionimi

kontabël i llogarive të tjera të klasës 4., Llogaria 466 ó Kreditorë për mjete në ruajtje, ndryshuar me UMFE nr.5, datë 21.02.2022.

Ndikimi: Mos regjistrimi në kontabilitet dhe deformim i informacionit financiar për sa i përket gjendjes kontabël të paraqitur në Pasqyrat e Pozicionit Financiar për vitin 2020 të llogarisë 466 óKreditorë për mjete nën ruajtje, gjendje kjo e mbi vlerësuar për 1,169,275 lekë.

Shkaku: Mos njohja dhe mos zbatim i ligjit 9228 datë 29.04.2004 óPër kontabilitetin dhe pasqyrat financiare, urdhrin nr.64 datë 22.07.2014 óPër shpallje të Standardeve Kombëtare të Kontabilitetit të Përmirësuar, Standardit Kombëtar të Kontabilitetit nr.1 óKudri i përgjithshëm për përgatitjen e pasqyrave financiare

Rëndësia: E lartë

Rekomandimi:Drejtorja e Financës dhe Buxhetit të njoftojë subjektet sipas kontratave përkatëse të investimeve, për paraqitjen e dokumentacionit të nevojshëm për kryerjen e veprimeve të likuidimit të garancisë së punimeve në masën 5% me një vlerë totale 303,575 lekë dhe të kryejë sistemimet përkatëse në llogarinë 466 óKreditorë për mjete nën ruajtje.

Për veprimet dhe mosveprimet e mësipërme mban përgjegjësi: Drejtorja e Menaxhimit Financiar dhe Buxhetit z. P.C.

- **Llogaria 467 “Kreditorë të ndryshëm”,** paraqiten faturat e pa likuiduara, vendime gjyqësore (nëse ka), investime dhe shërbime të cilat nuk bëhen hyrje dhe për vitin 2021 paraqiten në shumën 66,194,216 lekë. Lëvizja e kësaj llogarie gjatë vitit 2021 paraqitet si më poshtë:

Lëvizjet e llogarisë	
Gjendja në 01.01.2021	28,833,238
Shtesa gjatë vitit 2021 (d)	4,176,110
Pakësime gjatë vitit 2021(k)	13,920,155
Gjendja në 31.12.2021	19,089,193

Burimi: Bashkia Has

Titulli i gjetjes 18:Nënvlerësim i llogarisë 467 Kreditorë të ndryshëm

Situata: Nga auditimi dhe kontrolli i pagesave për investimet e Bashkisë Has nga sistemi SIFQ i thesarit, kemi identifikuar pagesa faturash të cilat paraqiten të likuiduara në 2022, por të paregjistruara në detyrimet e prapambetura të vitit 2021.

Në mënyrë analitike këto fatura me kompetencë vitin 2021 por të paregjistruara në kontabilitet dhe të likuiduara në 2022, paraqiten si më poshtë:

Faturat e paregjistruara për vitin 2021

ID_FATURE	KODI_INST	KODI_PROJ	FURNITORI	SHUMA	DATA_FUR	DATA_URD	GL_DATE	DATA_KRIJ	DATA_FAT	DATA_EKZI
4839847	2117001	1170089	D E N I S -	3,173,309	21-OCT-19	09-MAR-22	09-MAR-22	09-MAR-22	09-MAR-22	11-MAR-22
				3,173,309						

Burimi : Sistemi SIFQ

Mosparaqitja e tyre në kontabilitet, edhe pse janë kompetencë e vitit ushtrimor 2021 ka nënvlerësuar llogarinë 467 óKreditorë të ndryshëm me **3,173,309 lekë** për vitin 2021. Kjo procedurë mos pasqyrimi në llogarinë 467 óKreditorë të ndryshëm të detyrimeve për faturat e likuiduara në 2022, por me kompetencë vitin 2021, përbën shtrembërim të informacionit financiar, duke qenë se detyrimet e prapambetura për vitin 2021 të përcjella në Ministrinë e Financave janë nënvlerësuar me **3,173,309 lekë**.

Kriteri: Ligji 9228 datë 29.04.2004 óPër kontabilitetin dhe pasqyrat financiare neni 5, 6, 7, 9 dhe 10, ligjin 10296 datë 08.07.2010 óPër menaxhimin financiar dhe kontrollin, urdhrin nr.64

datë 22.07.2014 ó Për shpallje të Standardeve Kombëtare të Kontabilitetit të Përmirësuarâ dhe Standardit Kombëtar të Kontabilitetit nr.1 óKuadri i përgjithshëm për përgatitjen e pasqyrave financiareô ku përcaktohet qartë së detyrimet njihen në momentin që lindin dhe jo në momentin kur kemi nxjerrje të likuiditeteve.

Ndikimi: Mos regjistrimi në kontabilitet dhe deformim i informacionit financiar për sa i përket gjendjes kontabël të paraqitur në Pasqyrat e Pozicionit Financiar për vitin 2021 të llogarisë 467 óKreditore të ndryshëmô, gjendje kjo e nën vlerësuar për 3,173,309 lekë.

Shkaku: Mos njohja dhe mos zbatim i ligjit 9228 datë 29.04.2004 óPër kontabilitetin dhe pasqyrat financiareô, urdhrit nr.64 datë 22.07.2014 óPër shpallje të Standardeve Kombëtare të Kontabilitetit të Përmirësuarâ, Standardit Kombëtar të Kontabilitetit nr.1 óKuadri i përgjithshëm për përgatitjen e pasqyrave financiareô

Rëndësia: E lartë

Rekomandimi: Titullari i Bashkisë Has në bashkëpunim me Drejtorinë e Financës dhe Buxhetit të bëjnë sistemimet për të pasqyruar në llogarinë 467 óKreditore të ndryshëmô detyrimet për faturat e likuiduara **3,173,309 lekë** për vitin 2021. Gjithashtu, pas saktësimit të detyrimeve të prapambetura, duhet të merren masa për raportimin e tyre në Ministrinë e Financave, raportim i cili aktualisht nuk është real.

Për veprimet dhe mosveprimet e mësipërme mban përgjegjësi: Drejtoria e Menaxhimit Financiar dhe Buxhetit z. P.C.

- **Llogaria 85 “Rezultati i ushtrimit”**, paraqitet me teprice kreditore në vlerën 15,065,484 lekë dhe paraqet rezultatin nga funksionimi. Ajo është e barabartë me vlerën e të ardhurave që Bashkia Has trashëgon për tû përdorur në vitin pasardhës sipas dispozitave ligjore në fuqi dhe në përputhje me akt-rakordimin e mbajtur me degën e thesarit mbi fondet që trashëgohe.

2. Pasqyra e Performancës financiare (F2)

-**Të ardhurat dhe shpenzimet**, e paraqitura në Pasqyrën e Performancës Financiare të Bashkisë Has më datë 31.12.2021 janë të kuadruara me Degën e Thesarit Has, konkretisht:

Rakordimi të ardhurave

Emërtimi	Vlera sipas Pasqyrës së Performancës	Dokumentimi	Vlera	Dif
Të ardhurat e krijuara gjatë vitit	40,087,946	Akt rakordimi me Degën e Thesarit	40,087,946	0
Granti nga buxheti	541,637,712	Sipas çeljes së buxhetit nga MFE	541,637,712	0
Financim i pritshëm nga buxheti	23,289,336	Sipas llogarisë 7206	23,289,336	0
Totali të ardhurave	605,014,994	Totali të ardhura	605,014,994	0

Burimi: Bashkia Has

Rakordimi i Shpenzimeve

Emërtimi	Sipas Situacionit	Detyrimet e vitit 2020	Detyrime të vitit 2021	Sipas Pasqyrës së Performancës
600	147,543,091	11,326,514	12,007,978	159,551,069
601	24,169,927	3,202,794	3,459,449	27,629,376
602	69,624,861	7,534,950	7,821,909	77,446,770

604	711	-	-	711
606	321,873,169	-	-	321,873,169
63	3,448,415	-	-	3,448,415
TOTALI	566,660,174	22,064,258	23,289,336	589,949,510

Burimi: Bashkia Has

-Në fund të vitit ushtrimor të dy llogaritë e klasës 6 ôshpenzimetô dhe klasës 7 ôtë ardhuratô, janë mbyllur duke debituar dhe kredituar respektivisht llogarinë 85 ôRezultati i veprimtarisë ushtrimoreô, konkretisht:

Rakordimi të ardhura, shpenzime dhe rezultati

	Emërtimi Burimi	Pasqyra	Situacioni	Diferenca
I	Totali të ardhura	605,014,994	605,014,994	0
II	Shpenzime	589,949,510	589,949,510	0
III	Rezultati i vitit ushtrimor	15,065,484	15,065,484	0
IV	Rezultati i vitit ushtrimor	15,065,484	15,065,484	0

Burimi: Bashkia Has

-Në Pasqyrën e Pozicionit Financiar, llogaria 85 "Rezultati nga veprimtaria" paraqitet në shumën **15,065,484 lekë**, e njëjtë me Pasqyrën e Performancës Financiare.

3. Pasqyra e flukseve monetare (F3)

Pasqyra e Flukseve Monetare, paraqet rrjedhën e likuiditeteve dhe gjendjen më datë 31.12.2021.

Nr. Rubrike	PERMBAJTJA	Periudha Raportuese	Periudha Paraardhëse
(b)	(c)	(1)	(2)
I	Veprimtaritë e shfrytëzimit	4,980,762	258,786
II	Veprimtaritë e investimeve	10,114,527	5,668,778
III	Transferta e të tjera	-29,805	-3,020,044
IV	Teperica në fillim të vitit ushtrimor	7,883,867	5,524,824
V	Teprica e Likuiditeteve në fund të vitit ushtrimor	22,984,332	19,039,888

Burimi: Bashkia Has

-Nga kontrollet e kryera rezultoi se teprica e llogarisë së likuiditeteve më datë 31.12.2020, e paraqitur në këtë pasqyrë rezulton në shumën **15,065,484 lekë** dhe kuadron me tepricën e likuiditeteve të paraqitur në Pasqyrën e Pozicionit Financiar, në Aktiv "Mjetet monetare dhe ekuivalentët e tyre" e cila paraqitet në shumën **15,065,484 lekë**.

Plotësimi i Pasqyrës së Flukseve monetare është bërë në përputhje me kërkesat e përcaktuara në Udhëzimin nr. 8, datë 09.03.2019, Kapitulli III, pika 3.6 ôRregullat e plotësimit të pasqyrës financiare individuale të flukseve monetareô.

Pasqyra e ndryshimeve në aktivet neto/fondet neto (F4)

Referenc	EMËRTIMI	Fonde bazë dhe Grante	Fonde të tjera të veta	Rezultatet e Mbartura Teprioc/Deficit	Rezultatet e Ushtrimit Teprioc/Deficit	GJITHËSEJ Aktive/neto Fonde/ Neto
101	LAKTIVET NETO/FONDET NETO	2,200,554,469			9,934,228	2,210,488,697
	ILNDRYSHIMET NE AKTIVET/				-62,093,543	-62,093,543

	FONDET NETO(1+2)					
	1.NGA BURIME TE BRENDSHME				-62,093,543	-62,093,543
105,	Nga grantet e brendshme kapitale(+)					
1016, 1059	Nga Transfertat e brendshme te AAGJ, Dhurata ne natyre, (+,-)				5,880,243	5,880,243
12	Nga Rezultatet e mbartura(+,-)					
85	Nga Rezultatet e vitit ushtrimor(+,-)				15,065,484	15,065,484
1013	Nga konsumi i AAGJ(-)				-113,419,766	-113,419,766
1015	Nga nxjerrjet jashtë përdorimit dhe dëmtimet(-)				-10,197,266	-10,197,266
	TOTALI	2,200,554,469			-52,159,315	1,148,395,154

Burimi: Bashkia Has

-Nga verifikimi i kryer rezultoi se vlera totale e Aktiveve neto/fonde neto të paraqitura në "Pasqyrën e ndryshimeve në aktivet neto/fondet neto", është e barabartë me vlerën e tyre të paraqitur në pasqyrën e "Pozicionit financiar", në shumën **1,148,395,154 lekë**. Në këtë pasqyrë janë paraqitur saktë grantet bazë (çelja e vitit), rezultati i vitit të mëparshëm si dhe rezultatet e ushtrimit.

-Vlera prej 30,879,955 lekë, përfaqëson gjithë shtesat e aktiveve neto/fonde neto gjatë vitit ushtrimor, të pasqyruara në të njëjtën vlerë edhe në Librin e madh në kredi të llogarisë 101 "Fonde bazë".

-Vlera prej 113,419,766 lekë, përfaqëson amortizimin vjetor.

-Vlera prej 10,197,266 lekë, përfaqëson nxjerrjet jashtë përdorimit.

-Nga auditimi rezultoi se fondet neto të pasqyruara në Pasqyrën "Ndryshimi në fondet neto/aktivet neto" në shumën **1,148,395,154 lekë** kuadron me pasqyrimin e tyre në pasqyrën e "Pozicionit financiar".

Plotësimi i Pasqyrës së Aktiveve neto/Fonde neto është bërë në përputhje me kërkesat e përcaktuara në Udhëzimin nr. 8, datë 09.03.2019, Kapitulli III, pika 3.5 óRregullat e plotësimit të pasqyrës financiare individuale të ndryshimeve në Aktivet neto/Fondet neto, ndryshuar me Udhëzimin nr.5, datë 21.02.2022.

2.4 Mbi zbatimin e rekomandimeve të lëna në auditimet e mëparshme

1. Auditimi i fundit në Bashkinë Has

Auditimi i fundit në Bashkinë Has është kryer në vitin 2021 për periudhën 01.01.2018-31.12.2020, raporti përfundimtar dhe rekomandimet janë dërguar me shkresën nr. 866/07 datë 30.12.2021. Nga verifikimi i dokumentacionit konstatohet se, në përfundim të auditimit janë rekomanduar gjithsej:

- 13 masa organizative, pranuar nga subjekti;
- 2 masa shpërbllim dëmi me vlerë 1,196,339 lekë, pranuar nga subjekti.
- 6 masa për uljen e borxhit tatimor në shumën 79,841,672 lekë, pranuar nga subjekti.

2. Hartimi i Planit të Veprimit dhe respektimi i afatit prej 20 ditë për kthimin e përgjigjes për zbatimin e rekomandimeve.

Në zbatim të ligjit nr. 154/2014 óPër organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit, neni 15, germa j, Bashkia Has duhet të hartojë planin e veprimit për zbatimin e rekomandimeve brenda 20 ditëve nga marrja e raportit përfundimtar të auditimit. Nga auditimi u konstatua se, Bashkia Has për zbatimin e rekomandimeve të KLSH-së të dërguara me shkresën nr. 866/07 datë 30.12.2021 nuk ka kthyer përgjigje në KLSH brenda afatit ligjor prej 20 ditësh.

Ndërkohë rezulton se ka hartuar Planin e Veprimit për zbatimin e rekomandimeve duke përcaktuar edhe strukturat përgjegjëse sipas llojit të rekomandimit.

3. Respektimi i afatit ligjor prej 6 muajsh nga data e marrjes së njoftimit të raportit të auditimit, për raportimin në KLSH, të ecurisë së zbatimit të rekomandimeve të lëna nga auditimi i mëparshëm.

Referuar shkresës nr. 866/07 datë 30.12.2021 për dërgimin e Raportit Përfundimtar dhe Rekomandimeve nuk është plotësuar ende afati 6 mujor për të raportuar lidhur me plotësimin e përcaktimeve të ligjit nr. 154/2014 óPër organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit, neni 30, pika 2, óSubjekti i audituar, brenda 6 muajve nga data e njoftimit të raportit të auditimit, i raporton Kontrollit të Lartë të Shtetit mbi ecurinë e zbatimit të rekomandimeve të dhëna.

4. Mbi raportimin rregullisht në Këshillin Bashkiak të ecurisë të zbatimit të rekomandimeve të KLSH

Titulli i gjetjes 19: Mos raportim në KB mbi ecurinë e zbatimit të rekomandimeve të KLSH-së.

Situata: Bashkia Has ka hartuar planin e veprimit të zbatimit të rekomandimeve të dërguara nga KLSH me shkresën nr. 866/07 datë 30.12.2021, por nuk ka raportuar në Këshillin Bashkiak mbi rezultatet e zbatimit të këtyre rekomandimeve, veprime këto në kundërshtim me ligjin nr. 68/2017, datë 27.04.2017 óPër financat e vetëqeverisjes vendore, neni 50, pika 5, “Për të gjitha raportet e auditimit të jashtëm, të kryera nga Kontrolli i Lartë i Shtetit ..., kryetari i njësisë së vetëqeverisjes vendore përgatit një plan veprimi për zbatimin e rekomandimeve të raportit të auditimit dhe raporton rregullisht në këshillin e njësisë për progresin në zbatimin e tij”.

Kriteri: Ligji nr. 68/2017, datë 27.04.2017 óPër financat e vetëqeverisjes vendore, neni 50, pika 5.

Ndikimi: Mos zbatimi i rekomandimeve të lëna nga KLSH në auditimin e fundit sjell që disa aktivitete në Bashkinë Has të kryhen në kundërshtim me përcaktimet ligjore dhe të kenë ndikime financiare në vijimësi.

Shkaku: Mos angazhim sa duhet i strukturave të Bashkisë Has me qëllim zbatimin e rekomandimeve të KLSH-së.

Rëndësia: E mesme

Rekomandim: Bashkia Has të marrë masa për të kryer raportimin periodik në Këshillin Bashkiak lidhur me ecurinë e zbatimit të rekomandimeve të lëna nga KLSH në përfundim të çdo auditimi.

5. Mbi nivelin e zbatimit të rekomandimeve të lëna në auditimin e fundit në Bashkinë Has

Titulli i gjetjes 20: Mbi nivelin e zbatimit të rekomandimeve të lëna në auditimin e fundit.

Situata:

Në përfundim të auditimit në Bashkinë Has me shkresën nr. 866/07 datë 30.12.2021 janë dërguar rekomandimet si vijon:

Masa organizative

Në auditimin e fundit KLSH i ka rekomanduar Bashkisë Has 13 masa organizative, të cilat janë pranuar plotësisht.

1.Gjetje nga auditimi: Në rubrikën, aktivet afatshkurtra, nën/rubrika, llogari të arkëtueshme, gjendja e llog.(468) óDebitorë të ndryshëm në pasqyrat e pozicionit financiar të periudhës ushtrimore më datë 31.12.2019 paraqitet në vlerën 62,238,492 lekë, ndërsa në datën 31.12.2020 paraqitet në vlerën 67,254,420 lekë me diferencë shtesë të detyrimeve ndaj bashkisë shuma prej 5,015,928 lekë e cila përfaqëson detyrime të pa likuiduar nga subjektet ekonomik e familjare për

nivelin e taksave e tarifa vendore deri në datën 31.12.2020. Detyrimet për periudhën raportuese gjendje datë 31.12.2020 me vlerë 67,254,420 lekë nga 1,298 persona e subjekte e përbërë nga;

-Debitorë rekomanduar nga KLSH, vlera prej 48,597,195 lekë.

-Penalitete të vendosura nga APP, vlera prej 3,592,000 lekë.

-Debitorë për taksat e tarifave vendore, vlera prej 13,363,124 lekë.

-Debitorë të ndryshëm të mbartur, vlera prej 1,702,210 lekë.

-Nga analiza e kësaj llogarie rezulton se:

Bazuar mbi të dhëna e gjendjes debitorë që Sektori Taksave e Tarifave vendore ka raportuar me evidencë për viti 2020, ka rezultuar shtesë në detyrime vlera 7,345,245 lekë, ndërsa gjendja debitor shtesë e raportuar në pasqyrat financiare (*bilanci*) është me vlerën 5,015,928 lekë, pra ndërmjet gjendjes debitorë në pasqyrat financiare dhe gjendjes debitorë e pasqyruar nga sektori taksave tarifave vendore rezulton diferencë e pa argumentuar vlera 2,329,317lekë(7,345,245-5,015,928), për pasojë në këtë llogari nuk janë pasqyruar të gjitha detyrimet debitorë të lindura nga mos pagimi i nivelit të taksave e tarifave vendore për subjektet private, në këto kushte pasqyrat e pozicionit financiar për periudhën raportuese ushtrimore viti 2020 nuk pasqyrojnë vërtetësi në gjendjen e detyrimeve debitorë të subjekteve, për mospagimin e nivelit të taksave e tarifave vendore ndaj njësisë publike bashkia HAS, në mospërputhje me UMFE nr. 08, datë 09.03.2018 “Për procedurën e përgatitjes, paraqitjes e raportimit e të pasqyrave financiare vjetore të njësisë të Qeverisjes së Përgjithshme”, aneksi 1, pika 3.3.

1.1 Rekomandimi: Titullari i Bashkisë Has, Drejtoria e Financës dhe Sektori Taksave e Tarifave Vendore të analizojnë me përgjegjësi dhe të marrin masa të menjëhershme për të sistemuar diferencën e pa argumentuar e rezultuar ndërmjet gjendjes debitorë në pasqyrat financiare dhe gjendjes debitorë e pasqyruar nga sektori taksave tarifave vendore në vlerën prej **2,329,317 lekë** detyrime debitorë, nga mos pagimi nivelit të taksa/tarifa nga bizneset dhe subjektet familjarë, bazuar në listën e personave e subjekteve debitorë.

Nga auditimi rezulton se rekomandimi nuk është zbatuar.

2.Gjetje nga auditimi: Në rubrikën, aktivet afatgjata, nën/rubrika, aktive afatgjata jo materiale, gjendja e llog. (202) ó*Studime dhe kërkime* në pasqyrat e pozicionit financiar të periudhës raportuese ushtrimore paraqitet më datë 31.12.2019 në vlerën 4,534,307 lekë, ndërsa në datën 31.12.2020 në vlerë 3,546,277 me diferencë më e vogël për 988,031 lekë e cila përfaqëson vlerën e amortizimit i llogaritur për viti ushtrimor 2020.

-Nga analiza e kësaj llogarie konstatohet se:

-Vlera prej 9,729,027 lekë me kosto historike i përket 27 projekteve për investimet që janë kryer në objekte të cilat ka përfunduar zbatimi i punimeve dhe janë marr në dorëzim nga Bashkia, pra kjo vlerë duhet të ishte e sistemuar në llogarinë përkatëse të investimit që është përfunduar, si pjesë e koston totale të objekteve në bashkëlidhur. Për pasojë në këtë rast pasqyrat financiare nuk pasqyrojnë vërtetësinë e gjendjes së aktiveve, në mospërputhje me UKM nr.02, datë 08.05.2003 ó*Për klasifikimin dhe strukturën e koston së punimeve të ndërtimit* i ndryshuar, pika ócô, nënpika óbô.

2.1 Rekomandimi: Titullari Bashkisë Has dhe Drejtoria e Financës të marrin masa për sistemimin e llog. (202) ó*Studime dhe kërkime* dhe të paraqesë në këtë llogari vetëm vlerat e projekteve, për të cilat investimet e lidhura me to nuk kanë përfunduar. Kjo llogari të pakësohet për vlerën **9,729,027 lekë** dhe të shtohet në vlerën e investimit të përfunduara sipas objektit përkatës.

Nga auditimi rezulton se rekomandimi nuk është zbatuar.

3.Gjetje nga auditimi: Në rubrikën, aktivet afatgjata, nën/rubrika, aktive afatgjata jo materiale, gjendja e llog. (203) *óKoncesione, Patenta, Licenca e të ngjashmeô*, në pasqyrat e pozicionit financiar të periudhës raportuese ushtrimore më datë 31.12.2019 paraqitet në vlerë neto 0(Zero) e pa ndryshuar në datën 31.12.2020 e cila përfaqëson veprimet e amortizimit të akumuluar e publikuar në vlerën e mbetur 0 (zero) në pasqyrat financiare. Në këtë llogari është e pasqyruar vlera me kosto historike në shumë 1,085,000 lekë për 3 projekte të hartuara, të transferuara me pasqyra financiare ish/Komuna Fajza, në bashki Has, pas konsolidimit pasqyrave financiare.

-Nga analiza e kësaj llogarie rezulton se:

-Vlera prej 1,085,000 lekë me kosto historike i përket 3 projekteve në investimet e kryera për objekte të cilat kanë përfunduar punimet të marra në dorëzim nga bashkia Has, pra kjo vlerë duhet të ishte sistemuar në llogarinë përkatëse të investimit të përfunduar si pjesë e koston totale të objekteve. Për pasojë në këtë rast pasqyrat financiare, nuk pasqyrojnë vërtetësinë e gjendjes së aktiveve, në mospërputhje me UKM nr.2, datë 08.05.2003 *óPër klasifikimin dhe strukturën e koston së punimeve të ndërtimitô* i ndryshuar, pika 6c, nënpika 6b.

3.1 Rekomandimi: Titullari i Bashkisë Has, Drejtoria e Financës të marrin masa për sistemimin e llog. (203) *óKoncesione, Patenta, Licenca e të ngjashmeô*, duke e pakësuar këtë llogari me vlerën 1,085,000 lekë dhe shtuar në vlerën e investimit të përfunduar sipas objektit përkatës.

Nga auditimi rezulton se rekomandimi nuk është zbatuar.

4.Gjetje nga auditimi: Në rubrikën, aktivet afat gjata, nën/rubrika, aktive afat gjata materiale, gjendja e llog. (210) *óToka, Troje, Terreneô*, në pasqyrat e pozicionit financiar të periudhës raportuese ushtrimore paraqitet më datë 31.12.2019 në vlerën 1,074,183 lekë e pa ndryshuar në datën 31.12.2020. Në këtë llogari nuk është përfshirë dhe pasqyruar vlera e investimeve të kryera ndër vite, kryesisht për truall nën objekte, rrugë e terrene mbi të cilat është investuar për të mira publike, asete në pronësi të bashkisë.

-Nga analiza e kësaj llogarie rezulton se:

a) Në këtë llogari nuk është e përfshirë dhe pasqyruar vlera e trojeve nën objektet ndërtimore cilat kanë kaluar në pronësi të Bashkisë Has, përkatësisht me VKM nr.946, datë 02.09.2009 *óPër miratimin e listës përfundimtare të pronave të paluajtshme publike, shtetërore, që transferohen në pronësi ose në përdorim të Bashkisë Krumë, qarku Kukësô*; i ndryshuar me VKM nr.540, datë 27.07.2026 *óPër disa ndryshime dhe shtesa në VKM nr.946, datë 02.09.2009 “Për miratimin e listës përfundimtare të pronave të paluajtshme publike, shtetërore, që transferohen në pronësi ose në përdorim të Bashkisë Krumë, qarku Kukësô*; VKM nr.105, datë 03.02.2008 *óPër miratimin e listës së inventarit të pronave të paluajtshme, shtetërore që transferohen në pronësi ose në përdorim të Komunës Golaj, të qarkut të Kukësô*; VKM nr.792, datë 16.11.2006 *óPër miratimin e listës së inventarit të pronave të paluajtshme shtetërore në Komunën Gjinaj, qarku Kukësô*, VKM nr.425, datë 08.04.2008 *óPër miratimin e listës së inventarit të pronave të paluajtshme, shtetërore që transferohen në pronësi ose në përdorim të Komunës Fajzë, të qarkut të Kukësô*, në mospërputhje me UMFE nr.08, datë 09.03.2018 *óPër procedurën e përgatitjes, paraqitjes e raportimit e të pasqyrave financiare vjetore të njësive të Qeverisjes së Përgjithshmeô*, Kap.(II), pika 11, aneksi (1), pika 2, Klasa 2; pika 30.

b) Nuk është kryer inventarizimi fizik dhe vlerësimi i trojeve me komision të ngritur nga titullari i njësive vendore, në mospërputhje me UMFE nr.30, datë 27.12.2011 *óPër menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publikô*, Kap. IV, pikat 74; 96.

4.1 Rekomandimi: Titullari i Bashkisë Has, Drejtoria e Financës të marrin masa për të pasqyruar në llog. (210) *óToka, Troje, Terreneô* edhe vlerën e trojeve nën objektet ndërtesa e pasqyruar në llog. (212) *óNdërtime e konstruksioneô*, të cilat me VKM kanë kaluar në pronësi si asete publike të Bashkisë Has, njëkohësisht të kryhet procesi i inventarizimit fizik i trojeve me komision inventarizimi.

Nga auditimi rezulton se rekomandimi nuk është zbatuar.

5.Gjetje nga auditimi: Në rubrikën, aktivet afatgjata, nën/rubrika, aktive afatgjata materiale, gjendja e llog. (211) *óPyje, kullota, plantacioneô*, në pasqyrat e pozicionit financiar të periudhës raportuese ushtrimore paraqitet më datë 31.12.2019 në vlerë 0 lekë, vlerë e pa ndryshuar edhe në datën 31.12.2020. Në këtë llogari nuk është e pasqyruar vlera e inventarit të pyjeve, kullotave e plantacionet e transferuara nga shërbimi pyjor në bashkia Has.

-Nga analiza e kësaj llogarie konstatohet se:

a) Në këtë llogari nuk është pasqyruar vlera e pyjeve, kullotave e plantacioneve të transferuara si asete në pronësi të Bashkisë Has sipas VKM nr.433, datë 08.06.2016 *óPër transferimin në pronësi të Bashkive të Pyjeve dhe të Kullotave Publike, sipas listave të inventarit e aktualisht në administrim të Ministrisë së Mjedisit e ish/Komuna/Bashkiô*, pika 42, shtojca nr.40 me listën e inventarit të pyjeve dhe kullotave që transferohen në pronësi të Bashkisë Has, me nr nga 1(një) deri 1242 (*njëmijë e dyqind e dyzet e dy*) dhe VKM nr.684, datë 02.09.2020 *óPër disa shtesa e ndryshime në VKM nr.433, datë 08.06.2016 “Për transferimin në pronësi të Bashkive të Pyjeve dhe të Kullotave Publike, sipas listave të inventarit dhe aktualisht në administrim të Ministrisë së Mjedisit e ish/Komunave/Bashkiveô*, pika 42, shtojca nr.40 me listën e inventarit të pyjeve dhe kullotave që transferohen në pronësi të Bashkisë Has, me nr. nga 1(një) deri 1209 (*njëmijë e dyqind e nëntë*). Sipas këtij vendimi dhe atij të ndryshuar rezulton se, bashkia Has ka në pronësi gjithsej **33860 ha**, nga të cilët 25,763 ha pyje; 7,545 ha kullota, 552 ha sipërfaqe jo produktive (*shkëmbore*), në mospërputhje me UMF nr.08, datë 09.03.2018 *óPër procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në njësitë e Qeverisjes së Përgjithshmeô*, Kap.II, Pika 11, aneksi 1, pika 2, Klasa 2.

b) Nuk është kryer inventarizimi dhe vlerësimi Pyjeve e Kullotave me komision të ngritur nga Titullari i Institucionit, ndërsa llog. (211) *óPyje, kullota, plantacioneô* nuk paraqet vlerën e saktë të pasurisë së njësisë vendore, në mospërputhje me UMFE nr. 08, datë 09.03.2018 *óPër procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në njësitë e Qeverisjes së Përgjithshmeô*, Kap.II, Pika 11, aneksi 1, Pika 2, Klasa 2; UMF nr.30, datë 27.12.2011 *óPër menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publikô*, kap IV. pika 74, 96.

5.1 Rekomandimi: Titullari Bashkisë Has, Drejtoria e Financës në bashkëpunim me Sektorin Juridik dhe Drejtorinë e Pyjeve dhe Kullotave, të marrin masa për inventarizimin fizik të pronave asete publike në pronësi të Bashkisë Has, si dhe të bëhet pasqyrimi i saktë i tyre në dokumentet kontabël i vlerës së administruar në llog. (211) *óPyje, kullota, plantacioneô*.

Nga auditimi rezulton se rekomandimi nuk është zbatuar.

6.Gjetje nga auditimi: Në rubrikën, aktivet afatgjata, nën/rubrika, aktive afatgjata materiale, gjendja në llog. (212) *óNdërtime e konstruksioneô*, në pasqyrat e pozicionit financiar të periudhës raportuese ushtrimore paraqitet më datë 31.12.2019 në vlerën 831,238,056 lekë, ndërsa në datë 31.12.2020 në vlerën 781,725,198 lekë me diferencë vlera 49,512,858 lekë e cila përfaqëson vlerën e investimeve të kryera për gjatë vitit për ndërtime e rikonstruksione me vlerë 317,086 lekë, norma e amortizimit vjetor me vlerë 198,582,412 lekë, si dhe pakësim nga nxjerrja jashtë

përdorimit me vlerë 11,668,061 lekë, më konkretisht objektet; óGodina e shkollës 9/vjeçare Letajô e vlerësuar meurdhër nr.715, datë 27.09.2019 dhe óGodina e kopshtit Krumë, arkiva Krumë dhe Zyra e gjendjes civileô e vlerësuar me urdhër nr.716, datë 27.09.2019.

-Nga analiza e kësaj llogarie konstatohet se:

a) Në këtë llogari nuk është pasqyruar e saktë vlera për çdo aktiv afat gjatë, që ka pësuar ndryshime për gjatë periudhës së më passhme nëpërmjet kryerjes së investimit shtesë, si vlera e rikonstruksionit të objektit, vlera mbikëqyrjes e kolaudimit të objekteve, pasi përmirësimet, riparimet e mirëmbajtje e aktiveve që kanë kosto të mëpasshme duhet ti shtohen koston fillestare AAGJM^{së}. Investimet në total shtesë deri në 31.12.2020 janë në vlerën 980,307,610 lekë për 139 objekte të evidentuar, në mospërputhje me UMFE nr.8, datë 09.03.2018 óPër procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në njësitë e Qeverisjes së Përgjithshmeô, Kap. (II), pika 11, aneksi 1, pika 2 Klasa 2, germa ðö

b) Nuk është kryer inventarizimi dhe vlerësimi AAGJM me komision të ngritur nga Titullari Institucionit, në mospërputhje me ligjin nr.25/2018, datë 10.05.2018 óPër kontabilitetin dhe pasqyrat financiareô, neni 15, pika 1; 2; UMFE nr. 30, datë 27.12.2011óPër menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publikô, Kap.IV, pika 74;96; UMF nr. 30, datë 27.12.2011óPër menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publikô, Kap. (IV), pika 74; 96.

6.1 Rekomandimi: Titullari Bashkisë Has dhe Drejtoria Financës të marrin masa për pasqyrimin e saktë në dokumentet kontabël të vlerës së secilit aktiv afatgjatë material për llog. (212) óNdërtime e konstruksioneô, duke shtuar në vlerën fillestare, vlerën e shpenzimit i cili përbën investim të ri për secilin objekt (rikonstruksion etj). Nëpunësi autorizues e Nëpunësi zbatues të marrin masa për ngritjen e komisionit për inventarizimin fizik të aktiveve afatgjata materiale (AAGJM) në përfundim komisioni të hartojë relacion për titullarin në lidhje me rezultatet e inventarizimit.

Nga auditimi rezulton se rekomandimi nuk është zbatuar.

7.Gjetje nga auditimi: Në rubrikën, aktivet afatgjata, nën/rubrika, aktive afatgjata materiale, gjendja në llog.(213) óRrugë, rrjete vepra ujoreô, në pasqyrat e pozicionit financiar të periudhës raportuese ushtrimore paraqitet më datë 31.12.2019 në vlerë 1,278,801,884 lekë, ndërsa në datë 31.12.2020 në vlerë 1,240,910,396 lekë me diferencë vlera 37,891,488 lekë e cila përfaqëson vlerën e investimeve të kryera gjatë vitit 2020 në rrugë, rrjete e vepra ujore dhe pakësim për vlerën e amortizimit gjatë periudhës raportuese.

-Nga analiza e kësaj llogarie konstatohet se:

a) Nuk këtë llogari nuk është pasqyruar e saktë, vlera për çdo aktiv afat gjatë që ka pësuar ndryshime gjatë periudhës së mëpasshme nëpërmjet kryerjes së investimeve shtesë, si vlera e rikonstruksioneve të objekteve, vlera mbikëqyrjes dhe kolaudimit të objekteve, pasi përmirësimet, riparimet dhe mirëmbajtjet e aktiveve që kanë një kosto të mëpasshme, duhet ti shtohen koston fillestare të AAGJM^{së}. Investimeve shtesë në total deri në 31.12.2020 janë në vlerë 1,561,264,303 lekë për 268 raste, në mospërputhje me UMFE nr. 8, datë 09.03.2018 óPër procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në njësitë e Qeverisjes së Përgjithshmeô, Kap. (II), pika 11, Aneksi 1, pika 2, Klasa 2, germa ðö

b) Nuk është kryer inventarizimi dhe vlerësimi AAGJM^{ve} me komision të ngritur nga Titullari Institucionit, në mospërputhje me ligjin nr.25/2018, datë 10.05.2018 óPër kontabilitetin e pasqyrat financiareô, neni 15, pikat 1; 2; UMFE nr. 30, datë 27.12.2011 óPër menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publikô, Kap. (IV), pika 74 dhe 96; UMF nr. 08, datë 09.03.2018

óPër procedurën e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit e të pasqyrave financiare vjetore të njësive të Qeverisjes së Përgjithshmeó, pika 36.

7.1 Rekomandimi: Titullari Bashkisë Has dhe Drejtoria e Financës të marrin masa për pasqyrimin e saktë në dokumentet kontabël të vlerës së secilit aktiv afatgjatë material për llog. (213) *óRrugë, rrjete vepra ujoreó*, duke shtuar në vlerën e tij fillestare, vlera e shpenzimit që përbën investim të ri për secilin objekt. Nëpunësi autorizues e Nëpunësi zbatues të marrin masa për ngritjen e komisionit për inventarizimin fizik të aktiveve afatgjata materiale (*AAGJM*) në përfundim komisioni të hartojë relacion për titullarin në lidhje me rezultatet e inventarizimit.

Nga auditimi rezulton se rekomandimi nuk është zbatuar.

8.Gjetje nga auditimi: Në rubrikën, aktivet afatgjata, nën/rubrika, aktive afatgjata materiale, gjendja në llog. (215) *óMjete transportió* në pasqyrat e pozicionit financiar të periudhës raportuese ushtrimore paraqitet më datë 31.12.2019 në vlerën 22,179,865 lekë, ndërsa në datën 31.12.2020 në vlerën 21,070,871 lekë me diferencë për 1,108,994 lekë e cila përfaqëson vlerën e mjeteve ndër vite, shtesa gjatë periudhës e pakësim nga amortizimi për periudhën raportuese ushtrimore.

Nga analiza e kësaj llogarie konstatohet se:

a) Në këtë llogari është pasqyruar gabim edhe vlera prej 10,375,500 lekë për 6(*gjashtë*) mjete transporti të cilat nuk janë në gjendje pune, por të dëmtuara pra është kryer kontabilizim i gabuar në llog. (215) *óMjete Transportió*, ndërkohë që duhej të ishte kryer regjistrimi e kontabilizimi në llog. (24) *óAktive afatgjata të dëmtuaraó*, për këto mjete.

b) Amortizimi për mjetet është llogaritur në vlerën 16,033,835 lekë, përfshirë edhe për mjetet e dëmtuara, në mospërputhje me UMFE nr.8, datë 09.03.2018 *óPër procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në njësitë e Qeverisjes së Përgjithshmeó*, Kap. (II), pika 11, aneksi 1, pika 2/1, germa óeó, pika 36.

8.1 Rekomandimi: Titullari i Bashkisë Has, Drejtoria e Financës të marrin masa për zbatimin e procedurave ligjore për të sistemuar me veprime kontabël (*AAGJM*) me inventarizim fizik dhe evidentimin të 6 (gjashtë) mjeteve të transportit të dëmtuar, duke kredituar llog. (215) *óMjete Transportió* e debituar llog. (24) *óAktive afatgjata të dëmtuaraó* për 10,375,500 lekë.

Nga auditimi rezulton se rekomandimi është zbatuar.

9.Gjetje nga auditimi:Në rubrikën, aktivet afatgjata, nën/rubrika, investime, gjendja në llog.(231) *óPër aktive afatgjata materialeó* në pasqyrat e pozicionit financiar të periudhës raportuese ushtrimore paraqitet më datë 31.12.2019 në vlerën 12,280,822 lekë, ndërsa në datën 31.12.2020 në vlerë 79,208,907 lekë me diferencë për 66,928,085 lekë e cila përfaqëson vlerën e investimeve në proces të cilat nuk kanë përfunduar brenda vitit ushtrimor dhe do të kenë financime të tjera deri në përfundimin e tyre, kur ato të kthehen aktive dhe kalojnë te llogaritë Klasa (2) *óAktive afatgjata materialeó*.

-Nga analiza e kësaj llogarie konstatohet se:

-Drejtoria e financës ka të analizuar e dokumentuar në mënyrë analitike e justifikuese vlerën e pasqyruar të pozicionit financiar për periudhën raportuese ushtrimore viti 2020 për 7 (*shtatë*) objekte me vlerë 79,208,907 lekë, ndërsa për 2(dy) objekte me vlerë 415,942 lekë nuk disponohet me analizë asnjë dokument justifikues nga periudhat para ardhëse të transferuara nga pasqyra e pozicionit financiar të ish/Komunës Golaj gjatë periudhës konsolidimit në pasqyrat e pozicionit financiar në bashkia Has, veprim në mospërputhje me UMFE nr.8, datë 09.03.2018 *óPër procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në*

njësitë e Qeverisjes së Përgjithshme, Kap.(II), pikat 6; 11, aneksi 1, pika 2, Klasa 2, nënpika 2.1, paragrafi; *óTrajtimi kontabël dhe funksionimi grupi (20) óAktive afatgjata jo materiale* dhe pika 18.

9.1 Rekomandimi: Titullari i Bashkisë Has dhe Drejtoria e Financës të marrin masa për të evidentuar dhe dokumentuar në mënyrë analitike, vlerën e investimeve në proces të cilat nuk kanë përfunduar brenda vitit ushtrimor dhe të pasqyruara edhe këto në llog. (231) *óPër aktive afatgjata materiale* në vlerën **79,208,907 lekë**.

Nga auditimi rezulton se rekomandimi është zbatuar.

10.Gjetje nga auditimi: Në rubrikën, pasivet afat shkurtra, nën/rubrika, llogari të pagueshme, gjendja në llog. (466) *óKreditorë për mjete në ruajtje*, në pasqyrat e pozicionit financiar, paraqitet në vlerë 11,156,021 e cila përfaqëson ngurtësimin, detyrime të bashkisë ndaj OE për 5% garanci për punimet në objekte të ndryshme ndër vite. Gjatë periudhës raportuese ushtrimore viti 2020, sektori financës ka dokumentuar ngurtësime në vlerën prej 5,018,649 lekë për 8 OE, ndërsa ka kryer likuidime në vlerën prej 9,994,996 lekë për 3 OE, pasqyruar në akt-rakordimet me dega e thesarit Has:

-për 5% e ngurtësimeve progresive në vlerën 5,018,649 lekë deri më 31.12.2020.

-5% e likuidimeve progresive në vlerën 9,994,996 lekë deri më 31.12.2020.

Ndërmjet vlerës së ngurtësimeve prej 5,018,649 lekë e likuidimeve në vlerë 9,994,996 lekë, rezulton diferencë për 11,156,021 lekë e cila përfaqëson gjendjen e llog. (466) *óKreditorë për mjete në ruajtje* në datën 31.12.2020 për detyrime të krijuara për gjatë vitit ushtrimor 2020.

-Nga analiza e kësaj llogarie, konstatohet se:

-Në pasqyrat e pozicionit financiar kjo llogari paraqitet në vlerë 11,156,021 lekë, vlerë e cila rakordon me gjendjen e pasqyruar e analizuar në mënyrë analitike për çdo objekt ndërtimi dhe operator ekonomik, si pasojë e mos pasqyrimit në akt-rakordimet dhe në evidencat analitike për të gjithë operatorët ekonomik detyrimin që bashkia Has në lidhje me vlerën e garancisë për punimet e përfunduara, apo ato në proces. Për 12 objekte të përfunduara të cilat bashkia i ka marrë në dorëzim pasqyrohet me vlerën 7,256,213 lekë, ndërsa nuk është bërë zhbllokimi i vlerës sepse fondet gjenden të ngurtësuar në degën e thesarit Has, megjithëse është përmbushur afati i garancisë së punimeve sipas kushteve të kontratës.

Nga Sektori Urbanistikës e Drejtoria e Financës, nuk janë marrë masa për bërë zhbllokimin e këtyre fondeve, nuk është bërë njoftim subjekteve për paraqitjen e dokumentacionit të duhur me qëllim likuidimin e vlerës së ngurtësuar, ose përdorimin për interes publik të këtyre fondeve, bazuar në kushtet e kontratës të lidhur me subjektet sipërmarrëse, veprime në mospërputhje me UMFE nr. 08, datë 09.03.2018 *óPër procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në Njësitë e Qeverisjes së Përgjithshme*, Kap. (III), pika 30; 50 e UKM nr.3, datë 15.02.2011 *óPër mbikëqyrjen dhe kolaudimin e punimeve të ndërtimit* ndryshuar, Kap. (II), pika 10.

10.1 Rekomandimi: Titullari i Bashkisë Has, Drejtoria e Financës të marrin masa për sistemimin e llog. (466) *óKreditorë për mjete në ruajtje* për të evidentuar e dokumentuar në mënyrë analitike për diferencën në vlerën **7,256,213 lekë** e pa analizuar në mënyrë analitike, megjithëse është përmbushur afati i garancisë së punimeve sipas kushteve të kontratës. Të analizojë në origjinë të krijimit të tyre, cilat janë shkaqet e mos likuidimit të vlerës e cila përfaqëson vlerën e garancisë së punimeve për 12objekte të përfunduara të marra në dorëzim. Titullari dhe Drejtoria e financës të marrin masa për likuidimin e vlerës së mësipërme, duke

analizuar më parë gjendjen nëse është përmbyllur garancia e defekteve të punimeve dhe nëse janë bërë korrigjimet e punimeve për çdo kontratë së cilës nuk i është likuiduar kjo garanci.

Nga auditimi rezulton se rekomandimi nuk është zbatuar.

11.Gjetje nga auditimi: Nga procesi auditimit mbi realizimin e treguesve të buxhetit u konstatua se, si rezultat i mos realizimit të të ardhurave nga njësia vendore janë krijuar detyrime të prapambetura të pa likuiduara ndaj të tretëve, duke paraqitur risk për buxhetin e vitit në vazhdim, sepse ky buxhet i miratuar do të përdoret jo për të financuar nevojat reale të vitit buxhetor ushtrimor, por për të likuiduar detyrime të prapambetura për investime, mallra e shërbimet, apo dëm shpërblim për zbatim të vendimeve gjyqësore të formës së prerë, ku gjendja progresive e detyrimeve të pa likuiduara në datë 31.12.2020 pasqyrohen në vlerën **36,368,188 lekë** sa më poshtë;

-Detyrime për investime në vlerën 25,425,844lekë;

-Detyrime për mallra e shërbime në vlerën 10,547,166lekë;

-Detyrime për vendimet gjyqësore në vlerën 395,178lekë;

Të cilat zvogëlojnë fondet në dispozicion për periudhën ushtrimore për investime dhe shpenzime të tjera në interes të komunitetit të Bashkisë Has, veprime në mospërputhje me neni (50) *óAngazhimet buxhetoreô*, neni (52) *óKryerja e shpenzimeveô*, ligji nr.9936, datë 26.06.2008 *óPër menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisëô* i ndryshuar, neni (56), ligji nr.68/2017, datë 27.04.2017 *óPër financat e vetëqeverisjes vendoreô*, pika (62); UMFE nr.02, datë 06.02.2012 *óPër procedurat standarde të zbatimit të buxhetitô*; UMF nr.5, datë 27.12.2014 *óPër shlyerjen e detyrimeve të prapambeturaô*, UMFE (plotësues) nr. 02, datë 10.01.2018 *óPër buxhetin e vitit 2018ô*, pikat (82-91) *óDetyrimet e prapambetura të Njësive të Vetëqeverisjes Vendoreô*; neni 70, të VKM nr.914, datë 29.12.2014 *óPër miratimin e rregullave të prokurimit publikô* i ndryshuar.

11.1 Rekomandimi: Titullari Njesisë publike e qeverisjes vendore Bashkia Has, për detyrimet e faturave të pa likuiduara me gjendje progresive deri në datë 30.12.2020 në shumën **36,368,188 lekë** të analizojë situatën, të nxjerr përgjegjësitë, të ndërpresë praktikën e krijimit të detyrimeve të reja të prapambetura dhe të marr masa për likuidimin e tyre, ndërsa të mos ketë angazhime të reja buxhetore pa fonde në dispozicion, për këtë qëllim kërkohet që;

1-Titullari i bashkisë për daljen nga kjo situatë financiare të përgatis plan dhe ta dërgoj në Këshillin e Bashkisë për të shqyrtuar e miratuar brenda 15 ditëve nga data e paraqitjes së tij, plani të dërgohet në Ministrinë e Financave dhe Ekonomisë me qëllim që mund të japë rekomandime konkrete për rregullimin e situatës financiare, ndërsa njësia vendore të mos marrë asnjë angazhim buxhetor, pa pasur fonde në dispozicion.

2-Titullari bashkisë të analizojë rastin e vendimit gjyqësor, të nxjerr arsyet e përgjegjësitë për humbjen e tyre dhe efektin negativ që ka dhënë ky vendim në buxhetin e njësisë vendore. Sektori juridik të ndjek procesin në shkallët e gjykimit deri me rekurs. Në rastet e largimeve të punonjësve nga puna, sektori juridik dhe Titullari bashkisë të zbatojnë të gjitha procedurat e nevojshme të afateve për njoftim.

Nga auditimi rezulton se rekomandimi është zbatuar.

12.Gjetje nga auditimi: Bashkia Has është audituar nga ana e KLSH në vitin 2018 dhe në vijim është bërë verifikimi i zbatimit të rekomandimeve ku konstatohet se;

-Nga 13 masa organizative të rekomanduara e të pranuar, janë zbatuar plotësisht 4 masa, janë në proces zbatimi 5 masa dhe nuk janë zbatuar 4 masa.

-Nga 9 masa për shpërblim dëmi në vlerën 16,717 mijë lekë e kontabilizuar, por pa arkëtim.

-Nga Agjencia e Prokurimit Publik është dërguar vendimi nr.12, datë 12.02.2019, në të cilin ka vendosur të dënojë me gjobë 11 punonjës në vlerën 2,490,000 lekë, ndërsa ka filluar arkëtimin nga 2 punonjës në masën 600,000 lekë dhe ka mbetur pa arkëtuar vlera prej 1,890,000 lekë.

12.1 Rekomandimi: Titullari Bashkisë Has të analizojë e nxjerrë përgjegjësitë për moszbatimin e rekomandimeve të lëna nga KLSH në auditimin e mëparshëm. Të vazhdojë ndjekja dhe zbatimin e masave që rezultojnë ende të pa zbatuara, apo të përshpejtojë ato rekomandime që janë në proces. Për të cilat Titullari i njësive vendore të hartojë një program pune të veçantë.

Nga auditimi rezulton se rekomandimi nuk është zbatuar.

13. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i ushtruar në sistemi elektronik (*E-leje*) për oponencën teknike të objektit në emër të zhvilluesit *óEnti Kombëtar i Banesave (EKB)* ô me datë aplikimi 21.08.2020 me sipërfaqe ndërtimi prej 3,258.2m², me numër pasurie 4/250, në ZK 2282, me sipërfaqe të përgjithshme trualli për 1190m², sipërfaqe të gjurmës 399 m², në pronësi shtet. Është dhënë leja zhvillimore nr. 3, datë 24.03.2020; leja e ndërtimit nr. 2 Prot, datë 18.09.2020 óPër ndërtim të ri me sipërfaqe më të madhe se 250 m² për objekt banimi dhe shërbimi 8kat +1 Kat nëntokëô u konstatua se; Oponenca teknike e dorëzuar për objektin e ndërtuar në bashkinë Has nuk i përket këtij objekti, ndërsa dorëzuar oponencë për një objekt tjetër me emërtim;*óObjekt banimi dhe shërbimesh 8 kate dhe 1 kat parkimi nëntoke*”,objekt i ndërtuar në qytetin e Gramshit, pra objekti i ndërtuar në territorin e bashkisë Has është pa oponencë teknike, veprim në mospërputhje me ligjin nr.107/2014 *óPër planifikimin dhe zhvillimin e territoritô*; ligji nr.8402, datë 10.09.1998 " Për kontrollin dhe disiplinimin e punimeve të ndërtimit ", i ndryshuar; VKM nr.1055, datë 22.12.2010 *óPër vendosjen e oponencës teknike për projektet e veprave të ndërtimitô*; Urdhri Ministrit nr.197, datë 09.10.2014 *óPër miratimin e kushteve të përgjithshme të marrëveshjes për kryerjen e oponencës teknike për projektet e veprave të ndërtimitô*.

13.1 Rekomandimi: Titullari i Bashkisë Has, Sektori i Planifikimit e Urbanistikës të marrin masa të menjëhershme për të saktësuar oponencën teknike dhe të përshtatë atë me objektin e ndërtuar në territorin e Bashkisë Has, në të kundërt të aplikojë masa administrative nga zhvilluesi (EKB) për kundërvajtjen e konstatuar e parashikuar në ligjin nr.107/2014 *óPër planifikimin dhe zhvillimin e territoritô*, neni (51), pika (1), germa (gj).

Nga auditimi rezulton se rekomandimi nuk është zbatuar.

Masa për shpërblim dëmi

KLSH i ka rekomanduar Kryetarit të Bashkisë Has, 2 masa për shpërblim dëmi në vlerën **1,196,339 lekë**, nga të cilat është pranuar rekomandimi për vlerën 1,120,950 lekë dhe nuk është pranuar rekomandimi për vlerën 75,389 lekë.

1.Gjetje nga auditimi: Nga procesi auditimit mbi vlerësimin e realizimit e të ardhurave për periudhën raportuese (2018-2019-2020) mbi dokumentacionin e vendosur në dispozicion u konstatua se, Bashkia Has ka dhënë në përdorim asete pronë publike nga sipërfaqe e fondit pyjor/kullosor për ndërtim HECⁱ në territorin e Bashkisë Has, për të cilën me operatorin ekonomik *óF.ô SHPK* ka lidhur 1(një) aneks kontratë qiraje, në të cilën vlera e nivelit të tarifës e përlllogaritur në këtë aneks kontratë është e pa argumentuar dhe e pa saktë, për pasojë vlera prej 1,120,950lekë konsiderohet dëm ekonomik i shkaktuar për buxhetin e Bashkisë Has, në mospërputhje me VKM nr. 391, datë 21.06.2006 *óPër përcaktimin e tarifave në sektorin e pyjeve dhe kullotaveô* i ndryshuar me VKM nr.1064, datë 22.12.2010 *óPër disa ndryshime në VKM nr.*

391, datë 21.06.2006 “Për përcaktimin e tarifave në sektorin e pyjeve dhe kullotave”, pika (2), lidhja (2), nenet (11;12).

1.1 Rekomandimi: Titullari Bashkisë Has, Sektori Juridik, Drejtoria e Pyjeve e Kullotave dhe Drejtoria e Financës, të analizojnë situatën dhe të marrin masa të menjëhershme për të përllogaritur sa më të saktë nivelin e tarifës dysHEME për dhënë në përdorim të sipërfaqes nga fondi pyjor/kullosor me kontratë të lidhur për ndërtimin e HCE^{it} në territorin e bashkisë Has, dhe për të kërkuar nga operatori ekonomik óF.ô SHPK kthim të vlerës prej **1,120,950 lekë e konsideruar dëm ekonomik për buxhetin e Bashkisë Has**, si diferencë në vlerësim të nivelit të tarifës së përllogaritur.

Nga auditimi rezulton se rekomandimi nuk është zbatuar.

2.Gjetje nga auditimi: Nga procesi inventarizimit fizik i aktive afatshkurtër, inventar qarkulluese karezultuar një diferencë në mungesë, ndërmjet gjendjes fizike dhe gjendjes kontabile (*vlera historike*) në 4 artikuj me vlerë **75,389 lekë i konsideruar dëm ekonomik**, vlerë e pa sistemuar në kontabilitet në llog.(468) óDebitor të ndryshëm në ngarkim të personit material përgjegjës në Njësia Administrative Gjinaj në shkollë Kishaj vlera prej **56,689 lekë** dhe shkarkimi menjëherë i saj nga kontabiliteti në llog.(218), si dhe në bashkia Has, Sektori komunal vlera prej **18,700 lekë** dhe shkarkimi menjëherë i saj nga kontabiliteti në llog.(327).

2.1 Rekomandimi: Bashkia Has, Drejtoria e Financës të marrë masa dhe të sistemojë në kontabilitet në llog. (468) óDebitor të ndryshëm **vlerën prej 75,389 lekë e konsideruar dëm ekonomik** në ngarkim të personave material përgjegjës, për mungesë rezultuar nga inventarizimi fizik i aktiveve, ndërmjet gjendjes fizike dhe kontabile (*vlera historike*) për 4 artikujt óinventar ekonomikô.

Rekomandimi nuk është pranuar nga Bashkia Has.

Masa për uljen e borxhit tatimor

KLSH i ka rekomanduar Kryetarit të Bashkisë Has, 6 masa për uljen e borxhit tatimor në vlerën **79,841,672lekë**, nga të cilat janë pranuar plotësisht 5 rekomandime dhe është pranuar pjesërisht rekomandimi për vlerën 897,500 lekë.

1.Gjetje nga auditimi: Nga procesi auditimit u konstatua se, nga të ardhurat në zbatim të nivelit për taksat e tarifave vendore të miratuara me VKB në paketat fiskale janë krijuar detyrime debitorë në datën 31.12.2020 të pasqyruara me vlerë progresive për 10,362,754 lekë e ardhur e munguar për buxhetin e njësisë vendore, nga mos likuidimi i detyrimeve nga subjektet ekonomik e subjekte familjare, pa përfshirë taksën për tokenë bujqësore. Mos arkëtimi i detyrimeve për nivelin e taksave e tarifave vendore, përveç se është mos përmbushje e detyrës funksionale nga punonjësit e Sektorit të Taksave e Tarifave Vendore, njëkohësisht krijon mungesë financiare në treguesit në buxhet me pasojë ulje e nivelit të investimeve dhe të shpenzimeve të tjera që njësia vendore ka parashikuar në shërbim të komunitetit, veprime janë në mospërputhje me ligjin nr. 8652, datë 31.07.2000 óPër organizimin dhe funksionimin e Qeverisjes Vendoreë i ndryshuar; nene (4), (26), (32), (34), të ligjit nr. 9632, datë 30.10.2006 óPër sistemin e taksave vendoreë, nene (70), (91), Kreu (XI) óMbledhja me forcë e detyrimeve tatimoreë të ligjit nr. 9920 óPër Procedurat Tatimore në Republikën e Shqipërisëë i ndryshuar; ligjin nr.10926, datë 08.07.2010 óPër menaxhimin financiar dhe kontrollinë i ndryshuar; neni (12), UMFE nr. 24, datë 02.09.2008 dhe UMFE nr. 01, datë 17.01.2019 óPër zbatimin e buxhetit të vitit 2019ë.

1.1 Rekomandimi: Titullari i Bashkisë Has, Sektori Taksave e Tarifave Vendore të analizojë situatën dhe të marrë masa të menjëhershme, për arkëtimin e detyrimeve debitoare të rezultuara nga mos pagesa e nivelit të taksave e tarifave vendore të parashikuara në paketa fiskale për subjekte ekonomike që ushtrojnë aktivitet për qëllime biznesi dhe nga subjekte familjare me vlerën *prej 10,362,754 lekë*, si dhe përlllogaritjen të detyrimeve të lindura nga mos realizimi i nivelit për taksën e tokës nga subjekte familjare debitor ndaj njësisë vendore Bashkia Has.

Nga auditimi rezulton se rekomandimi është në proces dhe është trajtuar më gjerësisht në raportin e auditimit rubrika e auditimit të të ardhurave dhe masat e marra për menaxhimin e borxhit tatimor.

2.Gjetje nga auditimi: Nga procesi auditimit mbi vlerësimin e realizimin e të ardhurave për periudhën raportuese (2018-2019-2020) mbi dokumentacionin e vendosur në dispozicion u konstatua se; nga Sektori Taksave e Tarifave Vendore në Bashkinë Has nuk është programuar e miratuar me VKB edhe niveli tarifës për dhënie (*licencë/autorizim*) në tregtimin e naftës bruto e nënproduktet e saj dhe lëndë djegëse për operatorëve ekonomik që tregtojnë në stacione karburant për konsumatorët fundorë, ndërkohë që në territorin e bashkisë Has e ushtrojnë këtë aktivitet 9 (nëntë) OE, ndërsa Sektori Taksave e Tarifave Vendore ka pajisur me autorizime bazë, apo ka rinovuar autorizimin me afat 5(*pesë*) vite kalendarik vetëm 8 (tetë), si dhe likuidimi nivelit të tarifës përkatëse menjëherë për 5 (pesë) vite kalendarik, për pasojë vlera totale 7,980,000*lekë*, konsiderohet e ardhur e munguar e pa planifikuara për buxhetin e bashkisë Has, në mospërputhje me neni 35, i ligjit nr.9632, datë 30.10.2006 *óPër Sistemin e Taksave Vendore*ô i ndryshuar; Kap.(II); Kap.(III), pika 4: Kap (II), pika (1), germa (b); pika (15) të VKM nr. 970, datë 02.12.2015 *óPër përcaktimin e procedurave dhe të kushteve për dhënien e licencave për tregtimin e naftës bruto dhe nënprodukteve të sajô* i ndryshuar me VKM nr.344, datë 19.04.2017 *óPër ndryshimi VKM nr.970, datë 2.12.2015“Për përcaktimin e procedurave dhe të kushteve për dhënien e licencave për tregtimin e naftës bruto dhe nënprodukteve të sajô*.

2.1 Rekomandimi: Titullari i Bashkisë Has, Sektori Taksave e Tarifave Vendore të analizojë situatën dhe të marrin masa të menjëhershme për të rinovuar e pajisur me (*licencë/autorizim*) me afat 5 (*pesë*) vite kalendarike, ndërkohë që operatorët ekonomik të cilët ushtrojnë aktivitet për qëllime biznesi me veprimtari tregtimi në stacione karburanti e gaz i lëngshëm për përdorim nga konsumatorët fundorë në territorin e bashkisë Has, të cilët bashkia i ka pajisur me afat për 1(një) vit kalendarik, si pasojë e mos administrimit të autorizimit bazë, apo të mos pagesës së nivelit të tarifës përkatëse pas rinovimit të autorizimit bazë e pa përfshirë në paketat fiskale, për pasojë shuma e përlllogaritur prej 7,980,000 *lekë*, konsiderohet e ardhur e munguar e pa programuar për buxhetin e Bashkisë Has.

Nga auditimi rezulton se rekomandimi është në proces dhe është trajtuar më gjerësisht në raportin e auditimit rubrika e auditimit të të ardhurave.

3.Gjetje nga auditimi: Nga procesi i auditimit periudha raportuese (2018-2019-2020) i kryer mbi dokumentacionin e vendosur në dispozicion u konstatua se, nga Sektori Taksave e Tarifave, nuk ka përlllogaritur e aplikuar nivelin e tarifës për pastrim, ndriçim e gjelbërim për OE të cilët kanë kryer punime ndërtimi në territorin e bashkisë dhe njësitë administrative në vartësi, ku 9 OE që kanë lidhur kontrata për punë publike me Bashkinë Has, përpara fillimit të punimeve nuk kanë aplikuar në QKB për hapje në vendin e ushtrimit të veprimtarisë i ndryshëm nga selia (sipas vendndodhjes së objektit të kontratës), për pasojë edhe nuk janë ngarkuar me detyrime për nivelin e tarifave të pastrimit, gjelbërimit dhe ndriçimit të miratuara me paketën fiskale nga KB

Has në vlerën 897,500lekë e cila konsiderohet e ardhur e munguar për Buxheti Bashkisë Has, në mospërputhje me Kreun VII, neni 35; pika (1/1), neni 43, i ligjit nr. 9920 datë 19.05.2008 *óPër procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë* i ndryshuar, ligjit nr. 9632, datë 30.10.2006 *óPër sistemin e taksave vendore* i ndryshuar, UMFE nr. 24, datë 02.09.2008 i ndryshuar dhe VKB nr. 52, datë 20.12.2017, VKB nr. 67, datë 11.12.2018, VKB nr. 60, datë 24.12.2019 *óPër miratimin e paketës fiskale*, Pika (1) *óTarifat Vendore*, për periudhat raportuese viti (2018-2019-2020).

3.1 Rekomandimi: Titullari Bashkisë Has, Sektori Taksave e Tarifave Vendore të analizojnë situatën dhe të marrin masa të menjëhershme për të përlogaritur detyrimin që rrjedh nga mos aplikimi dhe mos zbatimi i nivelit për tarifën vendore nga 9 OE edhe me seli jashtë territorit të Bashkisë Has, të cilët ushtrojnë aktivitetet dhe kanë lidhur kontrata punë publike nga fondet e aplikuar për investime në Bashkinë Has, për pasojë shuma **897,500 lekë, konsiderohet e ardhur e munguar për Buxhetin e Bashkisë Has**. Rekomandimi është pranuar pjesërisht nga Bashkia Has.

Nga auditimi rezulton se rekomandimi nuk është pranuar nga Bashkia Has.

4. Gjetje nga auditimi: Nga procesi auditimit për periudhën raportuese (2018-2019-2020) i kryer mbi dokumentacionin e vendosur në dispozicion u konstatua se, Sektori i Taksave e Tarifave nuk ka realizuar të ardhura vendore nga zbatimi i nivelit të taksës së ndikimit në infrastrukturë për ndërtimet informate (*pa leje*) të kryera në territorin e bashkisë Has, nga subjekte ekonomike dhe subjekte familjarë në vlerë totale 3,671,328 lekë e konsideruar e ardhur e munguar e paplanifikuar për buxheti Bashkisë Has e pa kontabilizuar, në mospërputhje me ligji nr. 8652, datë 31.07.2000 *óPër organizimin dhe funksionimin e Qeverisjes Vendore* i ndryshuar; ligji nr. 9920, datë 19.05.2008 *óPër Procedurat Tatimore në Republikën e Shqipërisë* i ndryshuar; pika (2), neni 27 të ligjit nr. 9632, datë 30.10.2006 *óPër Sistemin e Taksave Vendore* i ndryshuar; neni 23 të ligjit nr. 9482, datë 03.04.2006 *óPër legalizimin, urbanizimin dhe integrimin e ndërtimeve pa leje* i ndryshuar me ligjin nr. 9786, datë 19.07.2007; ligjin nr.9895, datë 09.06.2008; Vendimi nr.3, datë 02.02.2009 i Gjykatës Kushtetuese; ligjin nr. 10099, datë 19.03.2009; ligjin nr. 10169, datë 22.10.2009; ligjin nr.10219, datë 04.02.2010; ligjin nr.141/2013, datë 02.05.2013; ligjin nr.50/2014 dhe ligjin nr.62/2015; VKM nr.860, datë 10.12.2014 *óPër përcaktimin e mënyrës së mbledhjes dhe administrimit të të ardhurave për ndërtimet pa leje e vlerave të zbatueshme për legalizim* i ndryshuar.

4.1 Rekomandimi: Bashkia Has, Sektori i Taksave e Tarifave Vendore të analizojë situatën dhe të marrë masa të menjëhershme për të analizuar dhe kërkuar pagesën e nivelit të taksës së ndikimit në infrastrukturë për ndërtimet informale (*pa leje*) të kryera nga subjekte ekonomike dhe subjekte familjare në territori bashkisë Has e parashikuar edhe në paketat fiskale shuma prej **3,671,328 lekë e konsiderohet e ardhur e munguar për buxheti bashkisë Has**.

Nga auditimi rezulton se rekomandimi është në proces dhe është trajtuar më gjerësisht në raportin e auditimit rubrika e auditimit të të ardhurave.

5.Gjetje nga auditimi: Nga procesi auditimit mbi dokumentacionin vendosur në dispozicion për periudhën raportuese (2018-2019-2020) u konstatua se, Sektori i Planifikimit të Territorit dhe Urbanistikës ka konstatuar kundërvajtje administrative me (*pezullim e ndërtim pa leje, etj*) në 46 proces verbale konstatimi, ndërkohë dhe nuk ka vendosur penalitete, për ndërtime të kundërligjshme nga persona fizik, juridik e familjar për rastin evidentuar *ópezullim punime* , duhej të ishte vendosur penalteti me vlerë minimale 100,000 lekë, për pasojë 46 subjekte duhet

të penalizohen me 100,000 lekë x 46 objekte në total vlera prej = 4,600,000 lekë, konsiderohet e ardhur e munguar e pa planifikuar për buxhetin e bashkisë, veprim në mospërputhje me pikën 8 óKryerje punimesh pa lejeó, neni 82, ligji nr.10119, datë 23.04.2009 óPër planifikimin e Territoritó në germa (a) ódënohet me gjobë nga 100,000 deri në 30% të vlerës totale të punimeve të ndërtimitó.

5.1 Rekomandimi: Bashkia Has, Sektori Planifikimit të Territorit dhe Urbanistikës, të analizojë situatën dhe të marrë masa të menjëhershme për të kontabilizuar vlerën e penalitetit sipas vlerës së masës së gjobës dhe të kërkojë arkëtimin e shumës **4,600,000 lekë e konsideruar e ardhur e munguar e pa planifikuar për buxheti Bashkinë Has.**

Nga auditimi rezulton se rekomandimi nuk është zbatuar.

6.Gjetje nga auditimi:Nga procesi auditimit mbi dokumentacionin e vendosur në dispozicion për periudhën raportuese objekt auditimi (2018-2019-2020) u konstatua se; Bashkia Has me operatorë ekonomik me status óaktivó, të cilët kryejnë aktivitetet për qëllime biznesi në fushën e mineraleve në territorin e bashkisë Has, janë të pajisur me leje minerare nga (MEI) për sipërfaqen e fondit pyjor/kullësor sipas lejeve në total për 746,2 ha, ndërsa bashkia ka lidhur kontrata qiraje për dhënie në përdorim të sipërfaqes së fondit pyjor/kullësor vetëm për 189,67ha dhe ka krijuar të ardhura në vlerën 4.932.750 lekë me diferencë sipërfaqe e pa kontraktuar, ndërsa e shfrytëzuar prej 556,53 ha. Në këto kushte bashkia Has për mos lidhje të kontratës për të gjithë sipërfaqen e lejeve minerare, ka krijuar të ardhura të munguara të pa planifikuara për buxhetin e bashkisë në vlerën prej 52,330,090 lekë, në mospërputhje me pika (2); lidhja nr.2, pika (6/1); pika (9/4), të VKM nr.391, datë 21.06.2006 óPër përcaktimin e tarifave në sektorin e pyjeve dhe të kullotaveó i ndryshuar me VKM nr. 1064, datë 22.12.2010 óPër disa ndryshime në VKM nr.391, datë 21.06.2006 “Për përcaktimin e tarifave në sektori pyjeve dhe kullotaveó.

6.1 Rekomandimi: Titullari i Bashkisë Has, Sektori Juridik, Drejtoria e Pyjeve e Kullotave dhe Drejtoria e Financës të analizojnë situatën dhe të marrin masa të menjëhershme për të kërkuar nga operatorët ekonomik që ushtrojnë aktivitetet për qëllime biznesi në fushën e mineraleve dhe të pajisur me leje minerare e miratuar nga (MEIT) për të lidhur kontrata qiraje me të gjithë OE dhe për të gjithë sipërfaqen e dhënë në përdorim për t'u shfrytëzuar nga fondi pyjor/kullësor, brenda territorit të bashkisë Has në sipërfaqen totale prej 746,2 ha e pa kontraktuar me diferencë në vlerën **prej 52,330,090 lekë e konsideruar e ardhur e munguar për Buxhetin e Bashkisë Has.**

Nga auditimi rezulton se rekomandimi nuk është zbatuar.

Masa Disiplinore

KLSH i ka rekomanduar Kryetarit të Bashkisë Has, marrjen e masave disiplinore për 8 punonjës, ku për 4 punonjës marrëdhëniet e punës rregullohen me legjislacionin e nëpunësit civil dhe 4 punonjës që marrëdhëniet e punës rregullohen sipas Kodit të Punës.

Për punonjësit që marrëdhëniet e punës rregullohen me legjislacionin e Nëpunësit Civil:

të fillojnë procedurat për dhënie e masave disiplinore për **4 (katër) punonjës**, si më poshtë:

1.Z. U.H, me detyrë Përgjegjës i Sektorit të Taksave dhe Tarifave Vendore;

2.Znj. M.R me detyrë Inspektore e Taksave dhe Tarifave Vendore;

3.Znj. S.Xh me detyrë Inspektore e Taksave dhe Tarifave Vendore;

4.Znj.E.S me detyrë Specialiste e financës.

Për punonjësit që marrëdhëniet e punës rregullohen sipas Kodit Punës.

të fillojnë procedurat për dhënie e masave disiplinore për **4 (katër) punonjës**, si më poshtë:

1.Z. A.R me detyrë Inspektor i Taksave dhe Tarifave Vendore;

2. Z. E. M me detyrë Administrator NjA Golaj;
3. Z. M.K me detyrë Administrator NjA Fajza;
4. Z. I.Ll me detyrë Administrator NjA Gjinaj;

Për punonjësit e sipër cituar, Bashkia Has me Urdhër nr. 03, datë 05.01.2022 óPër ngritjen e komisionit disiplinoró, ka dhënë masat:

- a) óPezullim nga e drejta e ngritjes në detyrë, përfshirë rritjen në shkallën e pagës për një periudhë deri në dy viteó;
- b) óVërejtje me paralajmërimó.

Masë disiplinore nuk është dhënë për punonjësen Merita Rahmani e cila është larguar nga detyra referuar Urdhrit nr. 142, datë 01.04.2021.

Nga auditimi rezulton se rekomandimi është zbatuar.

Në përfundim nga auditimi rezultoi se:

Raporti përfundimtar dhe rekomandimet janë dërguar në Bashkinë Has me shkresën nr. 866/07 datë 30.12.2021, pra më datë 30.06.2022 janë bërë 6 muaj nga data e dërgimit. Grupi i auditimit zhvilloi auditimin mbi nivelin e zbatimit të rekomandimeve të lëna nga auditimi i fundit i KLSH-së ku rezulton se, nga Bashkia Has kanë filluar të merren disa masa lidhur me zbatimin e rekomandimeve. Përkatësisht:

- Është hartuar plani i veprimit më datë 05.01.2022 ku është përcaktuar struktura ose punonjësi përgjegjës për zbatimin e rekomandimit si dhe janë shprehur mbi pranimin ose jo të rekomandimeve. Rezulton se nga 21 rekomandime të lëna në total, **nuk është pranuar rekomandimi 2.1**-Masa për shpërblim dëmi -óBashkia Has, Drejtoria e Financës të marrë masa dhe të sistemoj në kontabilitet në llog. (468) “Debitor të ndryshëm” **vlerën prej 75,389 lekë e konsideruar dëm ekonomik** në ngarkim të personave material përgjegjës, për mungesë rezultuar nga inventarizimi fizik i aktiveve, ndërmjet gjendjes fizike dhe kontabile (vlera historike) për 4 artikujt “inventar ekonomikó, si dhe **është pranuar pjesërisht rekomandimi 3.1**- Masa për uljen e borxhit tatimor/të ardhura të munguara - óTitullari Bashkisë Has, Sektori Taksave e Tarifave Vendore të analizojnë situatën dhe të marrin masa të menjëhershme për të përlllogaritur detyrimin që rrjedh nga mos aplikimi dhe mos zbatimi i nivelit për tarifën vendore nga 9 OE edhe me seli jashtë territorit të bashkisë Has, të cilët ushtrojnë aktivitet dhe kanë lidhur kontrata punë publike nga fondet e aplikuara për investime në bashkinë Has, për pasojë shuma **897,500 lekë, konsiderohet e ardhur e munguar për Buxhetin e Bashkisë Has**”.

- Janë nxjerrë urdhrat nr. 38/1/2/3/4/5/6/7/8, datë 21.01.2022 óPër realizimin e detyrave të lëna nga KLSH referuar Raportit Përfundimtar të Auditimitó. Në këto urdhra janë ngritur grupet e punës për të marrë masat për zbatimin e rekomandimeve.

- Lidhur me pikën D óMasa disiplinoreó nuk është përfshirë në planin e veprimit të hartuar nga Bashkia Has për marrjen e masave për të arritur zbatimin e rekomandimeve, por nga dokumentacioni i audituar ky rekomandim është zbatuar.

- Nga 13 masa organizative, janë zbatuar 3 rekomandime dhe 10 rekomandime nuk janë zbatuar.

- Nga masat për shpërblim dëmi, masa me vlerën 75,389 lekë nuk është pranuar nga Bashkia Has, ndërsa për masën me vlerë 1,196,339 lekë nuk është zbatuar.

Në përfundim:

-Nuk janë pranuar gjithsej 2 rekomandime, 1 rekomandim shpërblim dëmi 2.1 dhe 1 rekomandim për uljen e borxhit 3.1;

-Janë zbatuar gjithsej 4 rekomandime, 3 rekomandime organizative 8.1, 9.1, 11.1 si dhe 1 rekomandim disiplinor - pika D.

-Nuk janë zbatuar 13 rekomandime 10 organizative, përkatësisht me numër 1.1, 2.1, 3.1, 4.1, 5.1, 6.1, 7.1, 10.1, 12.1, 13.1, 1 rekomandim shpërblim dëmi, përkatësisht numër 1.1 dhe 2 rekomandime për uljen e borxhit tatimor, përkatësisht me numër 5.1, 6.1.

- Janë në proces zbatimi 3 rekomandime, 3 rekomandime për uljen e borxhit, përkatësisht me numër 1.1, 2.1 dhe 4.1.

- Gjithashtu, rekomandimet referuar afateve të zbatimit dhe çështjeve që adresojnë janë trajtuar gjatë auditimit të pikave të programit të auditimit sikurse janë rekomandimet që lidhen me hartimin e pasqyrave financiare, rekomandimeve që lidhen me uljen e borxhit tatimor etj.

Për veprimet dhe mos veprimet e mësipërme ngarkohen me përgjegjësi:

1. Z. L.M, Kryetar i Bashkisë Has;
2. Z. U.H, në cilësinë e personave të ngarkuar për zbatimin e rekomandimeve;
3. Zj. E.C, në cilësinë e personave të ngarkuar për zbatimin e rekomandimeve;
4. Zj. S.Xh, në cilësinë e personave të ngarkuar për zbatimin e rekomandimeve;
5. Z. P.C, në cilësinë e personave të ngarkuar për zbatimin e rekomandimeve;
6. Z. N.B, në cilësinë e personave të ngarkuar për zbatimin e rekomandimeve;
7. Zj. E.S, në cilësinë e personave të ngarkuar për zbatimin e rekomandimeve;
8. Zj. E.M, në cilësinë e personave të ngarkuar për zbatimin e rekomandimeve;
9. Z. S.L, në cilësinë e personave të ngarkuar për zbatimin e rekomandimeve.

Kriteri:Ligji nr. 154/2014, datë 27.11.2014 óPër organizimin dhe funksionimin e Kontrollin të Lartë të Shtetit, neni 15, germa j dhe neni 30 pika 2.

Ndikimi:Mos zbatimi i rekomandimeve të lëna nga KLSH në auditimin e fundit ka sjellë që strukturat e Bashkisë Has në fusha dhe aspekte të caktuara vijnë veprimtarinë në kundërshtim me përcaktimet ligjore.

Shkaku:Mos angazhim sa duhet i strukturave të Bashkisë Has.

Rëndësia: E lartë

Rekomandim:Bashkia Has të marrë masat për zbatimin e rekomandimeve të pa zbatuara, të lëna nga KLSH në auditimin e mëparshëm si vijon:

1. Të zbatojë urdhrat nr. 38/1 deri në 38/8, datë 21.01.2022 óPër realizimin e detyrave të lëna nga KLSH referuar Raportit Përfundimtar të Auditimit nr. 866/07 datë 30.12.2021ô.

2.Drejtoria e Financës të sistemojë diferencën e pa argumentuar e rezultuar ndërmjet gjendjes debitorë në pasqyrat financiare dhe gjendjes debitorë e pasqyruar nga sektori i taksave dhe tarifave vendore në vlerën prej 2,329,317 lekë detyrime debitorë.

3. Drejtoria e Financës të sistemojë llog. (203) óKoncesione, Patenta, Licenca e të ngjashmeô;

4. Drejtoria e Financës të pasqyrojnë saktë në dokumentet kontabël vlerën e secilit aktiv afatgjatë material për llog. (213) óRrugë, rrjete vepra ujoreô;

5. Titullari i Bashkisë Has, Sektori i Planifikimit e Urbanistikës të marrin masa të menjëhershme lidhur me lejen zhvillimore nr. 3, datë 24.03.2020; leje ndërtimi nr. 2 Prot, datë 18.09.2020 óPër ndërtim të ri me sipërfaqe më të madhe se 250 m² për objekt banimi dhe shërbimi 8 kat+1 Kat nëntokëô, për të saktësuar oponencën teknike dhe të përshtatë atë me objektin e ndërtuar në territorin e Bashkisë Has, në të kundërt të aplikojë masa administrative nga zhvilluesi (EKB) për kundërvajtjen e konstatuar e parashikuar në ligjin nr. 107/2014 óPër planifikimin dhe zhvillimin e territorit, neni (51), pika (1), germa (gj).

6. Drejtoria e Financës të sistemojë në kontabilitet në llog. (468) *óDebitor të ndryshëmô vlerën prej 75,389 lekë e konsideruar dëm ekonomik* në ngarkim të personave material përgjegjës, për mungesë rezultat nga inventarizimi fizik i aktiveve, ndërmjet gjendjes fizike dhe kontabile (*vlera historike*) për 4 artikujt *óinventar ekonomikô*.

7. Titullari Bashkisë Has, Sektori Taksave dhe Tarifave Vendore të analizojnë situatën dhe të marrin masa të menjëhershme për të përllogaritur detyrimin që rrjedh nga mos aplikimi dhe mos zbatimi i nivelit për tarifat vendore nga 9 OE edhe me seli jashtë territorit të Bashkisë Has, të cilët ushtrojnë aktivitetet dhe kanë lidhur kontrata punë publike nga fondet e aplikuara për investime në Bashkinë Has, në shumën **897,500 lekë**.

8. Bashkia Has, Sektori Planifikimit Territorit Urbanistikës, të analizojë situatën dhe të marrë masa të menjëhershme për të kontabilizuar vlerën e penalitetit sipas vlerës së masës së gjobës dhe të kërkojë arkëtimin e shumës **4,600,000 lekë**.

9. Titullari i Bashkisë Has, Sektori Juridik, Drejtoria e Pyjeve e Kullotave dhe Drejtoria e Financës të analizojnë situatën dhe të marrin masa të menjëhershme për të kërkuar nga operatorët ekonomik që ushtrojnë aktivitetet për qëllime biznesi në fushën e mineraleve dhe të pajisur me leje minerare e miratuar nga (MEIT) për të lidhur kontrata qiraje me të gjithë OE dhe për të gjithë sipërfaqen e dhënë në përdorim për t'u shfrytëzuar nga fondi pyjor/kullosor, brenda territorit të Bashkisë Has në sipërfaqen totale prej **746,2 ha** e pa kontraktuar me diferencë në vlerën **prej 52,330,090 lekë**.

10. Titullari Bashkisë Has të analizojë e nxjerrë përgjegjësitë për moszbatimin e rekomandimeve të lëna nga KLSH në auditimet e mëparshme. Të vazhdojë ndjekja dhe zbatimi i masave që rezultojnë ende të pa zbatuara, apo të përshpejtojnë ato rekomandime që janë në proces. Titullari i njësisë vendore të hartojë një program pune të veçantë: *për 9 masa për shpërblim dëmi* në vlerën 16,717 mijë lekë e kontabilizuar, por pa arkëtuar; lidhur me zbatimin e vendimit nr. 12, datë 12.02.2019 dërguar nga Agjencia e Prokurimit Publik, në të cilin është vendosur të dënohen me gjobë 11 punonjës në vlerën 2,490,000 lekë, ndërsa ka filluar arkëtimi nga 2 punonjës në masën 600,000 lekë dhe ka mbetur pa arkëtuar vlera prej 1,890,000 lekë.

IV. GJETJE DHE REKOMANDIME

Për përmirësimin e gjendjes, rekomandojmë marrjen e masave si më poshtë:

A. MASA ORGANIZATIVE

1. **Gjetje nga auditimi:** Nga auditimi u konstatua se Bashkia Has nuk ka ngritur një sistem efektiv të menaxhimit financiar dhe kontrollit të brendshëm, duke mos hartuar një kuadër të plotë rregullash të shkruara për këtë qëllim.

Nuk është miratuar gjurma e auditimit për të gjitha procedurat, proceset dhe transaksionet që lidhen me veprimtarinë kryesore në njësinë publike, si prokurimet publike, shpenzimet, të ardhurat etj.

Nga titullari nuk është nxjerrë akt i brendshëm ku të përcaktohen detyrat e punonjësit dhe strukturave përkatëse të Bashkisë Has gjatë marrjes dhe dorëzimit të detyrës.

Nga ana e titullarit të njësisë publike Bashkia Has nuk është hartuar dhe miratuar Strategji e Menaxhimit të Riskut, por është plotësuar vetëm Format i Regjistrimit të Riskut.

Ndarjen e detyrave në fushën e dhënies së autorizimit në mënyrë që i njëjti punonjës të mos jetë përgjegjës në të njëjtën kohë për propozimin, miratimin, zbatimin, kontabilitetin dhe kontrollin, sipas udhëzimit të Ministrit të Financave.

Këto veprime janë në kundërshtim me:

- Ligjin nr. 10296, datë 08.07.2010 óPër Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin, i ndryshuar, kreu II, neni 8, pika 2, 8b, neni 9 pika ç dhe neni 16 pika 2 dhe 3;
- VKM nr. 124, datë 17.02.2016 óPër pezullimin dhe lirim nga shërbimi civiló Kreu III, pika 27;
- VKM nr. 171, datë 26.03.2014 óPër transferimin e përkohshëm dhe të përkohshëm të nëpunësve civilë, pezullimin dhe lirim nga shërbimi civiló, Kreu VII, pika 49, 52, 52;
- Udhëzimin e Ministrisë së Financave nr. 28, datë 15.12.2011 óMbi paraqitjen e deklaratës dhe raportit vjetor për cilësinë e sistemit të kontrollit të brendshëm në njësitë publikeó;
- Ligjit nr. 68-2017 óPër financat e vetëqeverisjes vendoreó, neni 32 dhe UMF Plotësues nr. 8 datë 29.3.2012 óProcedura e përgatitjes së Buxhetit afatmesëmó, Kap. V. *(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.1 faqe 14-19 të Raportit Përfundimtar të Auditimit)*.

1.1 Rekomandim: Bashkia Hastë marrë masa që hartohet dhe miratohet strategjia e risku. Titullari i Bashkisë Has të miratojë gjurmën e auditimit për proceset kryesore që kontribuojnë në arritjen e objektivave të njësisë dhe që përfshijnë zbatimin e aktiviteteve, programeve dhe projekteve më të rëndësishme.

Koordinatori i Grupit të Menaxhimit Strategjik të organizojë takimet periodike të GMS-së për të siguruar marrjen në kohën dhe formën e duhur të informacioneve cilësore me qëllim vlerësimin e progresit të bërë në arritjen e objektivave të MFK-së.

Spektori i Burimeve Njerëzore në Bashkinë Has të marrë masa që për çdo largim punonjësisht nga puna të ndiqet procedura për dorëzimin e detyrës.

Menjëherë dhe në vijimësi

2. Gjetje nga auditimi: Struktura e auditit të brendshëm për vitin 2021 ka funksionuar vetëm më një auditues, nga tre që përcakton kuadri rregullator në fuqi. Rezulton se për vitin 2021 nga Bashkia Has nuk është planifikuar dhe realizuar asnjë auditim, duke mos kryer detyrën funksionale dhe duke mos i dhënë titullarit të njësisë publike këshilla për përmirësimin e veprimtarisë dhe efektivitetin e sistemit të kontrollit të brendshëm, si dhe siguri për realizimin e objektivave.

Këto veprime janë në kundërshtim me Ligjin nr. 114/2015, datë 22.10.2015 óPër auditimin e brendshëm në sektorin publikó, neni 10, Organizimi i shërbimit të auditimit të brendshëm, pika 1, Të gjitha njësitë publike, të përfshira në neni 3, të këtij ligji, duhet të marrin masa për krijimin e shërbimit të auditimit të brendshëm dhe neni 11, Vendimin Nr. 83, datë 3.2.2016 óPër miratimin e kriterëve të krijimit të njësive të auditimit të brendshëm në sektorin publikó, pika 3. *(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.1 faqe 14-19 të Raportit Përfundimtar të Auditimit)*.

2.1 Rekomandim: Bashkia Has të marrë masa për ngritjen e strukturës së Njesisë së Auditit të Brendshëm, që të jetë një mbështetës për njësinë e auditimit të brendshëm si dhe një organ i pavarur, monitorues e këshillëdhënës për titullarin e njesisë ose, shërbimi i auditit të brendshëm të kryhet nga njësia e auditit të brendshëm të një njësie tjetër publike, në bazë të një marrëveshje ndërmjet titullarëve të njësive publike përkatëse.

Menjëherë dhe në vijimësi

3. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi u konstatua se nuk janë marrë masa të plota për likuidimin e detyrimeve të prapambetura, pasi nga njëra anë kryhen pagesa gjatë vitit për detyrimet e trashëguara ndër vite, por gjithashtu gjatë vitit buxhetor krijohen detyrime të reja të prapambetura. Në fillim të vitit buxhetor 2021 detyrimeve e prapambetura kanë vlerën 28,833,238 lekë, prej të cilave është likuiduar vlera 13,920,155 lekë, por është krijuar detyrim i ri në vlerën 4,176,110 lekë, duke e çuar vlerën e këtyre detyrimeve më 31.12.2021 në vlerën 19,089,192.8 lekë.

Detyrimet e reja të prapambetura janë krijuar nga mos realizimi i të ardhurave dhe nga marrja e angazhimeve buxhetore pa pasur fonde në dispozicion, veprime të cilat janë në kundërshtim me kërkesat e Udhëzimit të MFE nr.9, datë 20.03.2018 óPër procedurat standarde të zbatimit të buxhetit, pika 153-162, Rubrika - Marrja e angazhimit dhe kryerja e shpenzimeve publike, detyrimet kontraktuale midis palëve, nenin 52 të ligjit nr.9936, datë 26.6.2008 óPër menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë, i ndryshuar, UMF nr. 5, datë 27.12.2014 óPër shlyerjen e detyrimeve të prapambetura, pikat 82-91. *(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.2 faqe 19-38 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*

3.1 Rekomandim: Kryetari i Bashkisë Has dhe Drejtoria Ekonomike , të marrin masa për likuidimin e vlerës së kontratave të lidhura midis Bashkisë Has dhe kontraktorëve, brenda afatit 30 ditor pas ardhjes së faturës tatimore, duke eliminuar në këtë mënyrë shkakun e krijimit të detyrimeve të reja prapambetura. Lidhja e kontratës të bëhet vetëm pasi fondi që parashikon procedura e prokurimit do të jetë në dispozicion (në llogarinë e thesarit) të autoritetit kontraktor.

Menjëherë dhe në vijimësi

4. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi konstatohet se në Bashkinë Has nuk është hartuar regjistër dhe nuk llogaritet detyrim për kategorinë e taksapaguesve familjar për taksën mbi tokën bujqësore. Sektori i taksave dhe tarifave vendore nuk ka informacion lidhur me numrin e familjeve që kanë detyrimin të paguajnë këtë taksë dhe sipërfaqes së tokës bujqësore që familjet zotërojnë me AMTP mbi të cilën llogaritet taksa e tokës bujqësore. Veprimet e mësipërme janë në kundërshtim me përcaktimet e ligjit nr. 9632, datë 30.10.2006, óPër sistemin e taksave vendore, i ndryshuar, neni 23 dhe VKB-së nr. 104 datë 25.12.2020 óPër miratimin e taksave dhe tarifave vendore në Bashkinë Has për vitin 2021, pika 4/b. *(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.2 faqe 19-38 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*

4.1 Rekomandim: Bashkia Has, Sektori i Taksave dhe Tarifave Vendore në bashkëpunim me Sektorin e Bujqësisë të marrin masa për të identifikuar numrin e familjeve që kanë në pronësi tokë bujqësore si dhe sipërfaqen e saktë që ato zotërojnë, me qëllim krijimin e një regjistri me të dhëna të plota dhe të sakta. Ky regjistër më pas të shërbejë si bazë për të bërë llogaritjen e detyrimeve që ju lindin këtyre familjeve referuar paketës fiskale të miratuar të Bashkisë Has.

Menjëherë dhe në vijimësi

5. Gjetje nga auditimi: Bashkia Has, Sektori i Taksave dhe Tarifave Vendore nuk ka të dhëna lidhur me numrin e familjeve që kanë detyrimin për të paguar tarifën e pastrimit, ndriçimit, gjelbërimit dhe taksën e ndërtesës, nuk ka të dhëna lidhur me nivelet e pritshmërisë së tyre si dhe nuk ka të dhëna se sa është numri i familjeve që janë debitore ndaj bashkisë. Gjithashtu, familjet në Bashkinë Has nuk ngarkohen për detyrimet vendore për taksat dhe tarifatat tjera të miratuara me Vendim të Këshillit Bashkiak, si, taksa e truallit, veprime këto në kundërshtim me përcaktimet e VKB-në nr. 104 datë 25.12.2020 óPër miratimin e taksave dhe tarifave vendore në Bashkinë Has për vitin 2021. Sektori i Taksave dhe Tarifave Vendore regjistron vetëm të dhëna

lidhur me familjet që paguajnë ndërsa për familjet debitore nuk ka një regjistër. Si rezultat, **procesi i llogaritjes së detyrimit të familjeve për taksat dhe tarifave vendore nuk është i dokumentuar, duke sjellë si pasojë mos njohjen e numrit të familjeve debitore dhe vlerën totale që ato kanë ndaj bashkisë.** *(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.2 faqe 19-38 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*

5.1 Rekomandim: Bashkia Has, Sektori i Taksave dhe Tarifave Vendore të marrë masa për krijimin e regjistrimit të taksave dhe tarifave vendore për taksapaguesit e kategorisë familjare me të gjitha të dhënat e nevojshme, i cili të shërbejë si bazë për të bërë llogaritjen e detyrimeve vendore që ju lindin familjeve referuar paketës fiskale të miratuar të Bashkisë Has.

Brenda muajit Mars 2023

6. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i zbatimit të kushteve të akt marrëveshjeve që Bashkia Has ka lidhur me subjektet debitore rezulton se dy prej tyre nuk kanë zbatuar kushtet e akt marrëveshjes. Subjekti *ÓV.Mô* i cili është debitor në vlerën **73,260 lekë** edhe pse duhet të kishte paguar që më datë 16.09.2021 dhe subjekti *ÓR.* SHPK është debitor në vlerën **93,676 lekë**, ndërkohë që duhet të kishte paguar që më datë 18.12.2021. Nga Bashkia Has, Sektori i Taksave dhe Tarifave Vendore nuk janë marrë masa për zgjidhjen e marrëveshjes së pagesës me këste në kundërshtim me përcaktimet e ligjit nr. 9920, datë 19.05.2008 *óPër Procedurat Tatimore në Republikën e Shqipërisë* dhe ndryshuar, neni 78. *(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.2 faqe 19-38 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*

6.1 Rekomandim: Sektori i Taksave dhe Tarifave Vendore të monitorojë me përgjegjësi zbatimin e kushteve të akt marrëveshjeve që ka lidhur me subjektet debitore dhe të marrë masat e duhura në rast të mos zbatimit të kushteve të përcaktuara në akt marrëveshje nga bizneset debitore.

Menjëherë dhe në vijimësi

7. Gjetje nga auditimi: Në Bashkinë Has për vitin 2021 nuk është ngritur si strukturë e veçantë Inspektorati i Mbrojtjes së Territorit Vendor. Në strukturën aktuale të bashkisë identifikohen 2 punonjës të emëruar në pozicionin e inspektorit të terrenit (1 në Sektorin e Planifikimit të Territorit dhe Urbanistikës dhe 1 në NjA Golaj). Këto punonjës edhe pse me detyrë inspektor terreni nuk e bëjnë funksionale strukturën e IMTV-së si rezultat i mungesës së Kryeinspektorit, i cili ka kompetencat ligjore për të nënshkruar marrjen e masave dhe dhënien e sanksioneve administrative. Veprimet e mësipërme janë në kundërshtim me përcaktimet e ligjit nr. 9780, datë 06.07. 2007 *óPër Inspektimin dhe Mbrojtjen e Territorit nga Ndërtimet e Kundërligjshme*, i ndryshuar, neni 4, neni 13, si dhe VKM nr. 894, datë 04.11.2015 *óPër unifikimin e procedurave të kontrollit të territorit nga Inspektorati Kombëtar i Mbrojtjes së Territorit dhe ai i Njësisë Vendore*, pika 1/b/ii, pika 1/c/i, pika 4. Nga mos funksionimi i plotë i Inspektoratit të Mbrojtjes së Territorit nga Bashkia Has nuk mund të vendosen gjopa apo të merren masa të tjera për veprimet e kundërligjshme të konstatuara në mbrojtjen e territorit. *(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.2 faqe 19-38 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*

7.1 Rekomandim: Kryetari i Bashkisë të marrë të gjitha masat për të krijuar të plotë strukturën e Inspektoratit të Mbrojtjes së Territorit në Bashkinë Has me qëllim zbatimin e ligjshmërisë në fushën e kontrollit dhe zhvillimit të territorit.

Brenda muajit Dhjetor 2022

8. Gjetje nga auditimi: Llogaria 468 óDebitor të ndryshëm, në pasqyrat financiare ka vlerën 67,319,252,lekë, ndërsa analiza e kësaj llogarie në librat e kontabilitetit ka vlerën 60,807,896 lekë, situatë e cila tregon se për diferencën prej 6,511,356 lekë midis këtyre dy vlerave, nuk ka dokumentacion justifikues, i cili të shpjegojë origjinën e krijimit të këtij detyrimi ndaj njësisë vendore. Në bilanc nuk janë futur detyrimet e nxjerra nga auditimi i mëparshëm i KLSH-së mbi individët dhe furnitorët debitor nga mos arkëtimi i dëmeve ekonomike edhe pse janë rekomandime të pranura për tu zbatuar. *(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.3 faqe 38-56 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*

8.1 Rekomandim: Nëpunësi Zbatues, të përfshijë në llogarinë 468 óDebitor të ndryshëm edhe dëmet e konstatuara nga KLSH në auditimet e mëparshme si dhe të justifikojë diferencën prej 6,511,356 lekë të llogarisë 468 óDebitorë të ndryshëm.

Në mbyllje të pasqyrave financiare të vitit 2022

9. Gjetje nga auditimi: Nga verifikimi i analizës analitike të llogarisë 202 óStudime dhe Kërkime, konstatohet se vlera e studimeve dhe projekteve të paraqitura në bilanc, i përkasin edhe objekteve të përfunduara përpara vitit ushtrimor 2021, duke kryer vlerësimin jo real të llogarisë 202 dhe AAJM, në vlerën 1,613,998 lekë. *(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.3 faqe 38-56 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*

9.1 Rekomandim: Nëpunësi Zbatues, të kryej veprimet e sistemit për llogarinë 202 óStudime dhe Kërkime duke siguruar përfshirjen në këtë llogari të studimeve dhe kërkimeve vetëm për objektet ende të papërfunduara në vitin ushtrimor të mbylljes së bilancit.

Në mbyllje të pasqyrave financiare të vitit 2022

10. Gjetje nga auditimi: Bashkia Has është aksionere 100% e shoqërisë óUjësjiellës Kanalizime Has ShA, në vlerën e investimit prej 77,334,000 lekë, por nga auditimi i pasqyrave financiare u konstatua se nuk janë reflektuar në gjendjen e llogarisë 26 óAktivet Afatgjata Financiare fitim-humbjet nga pjesa e aksioneve për vitet 2001-2021. Veprimet e mësipërme janë në kundërshtim me Udhëzimi nr. 8/2018 óPër procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në NJQPôpika 2.1, ndryshuar me Udhëzimin nr. 5, datë 21.02.2022. *(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.3 faqe 38-56 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*

10.1 Rekomandim: Nëpunësi Zbatues të marrë masa për të bërë sistemit në kontabilitet dhe regjistrimin e pjesëmarrjes 100% në kapitalin aksionar të óUjësjiellës Kanalizime Has SHA me vlerë kontabël 77,334,000 lekë në debi të llogarisë 26 óPjesëmarrje në kapitalin e vetë dhe kredi të llogarive financiare të klasës 5, për pjesëmarrjen me kapitalin e vet.

Në mbyllje të pasqyrave financiare të vitit 2022

11. Gjetje nga auditimi: Kryetari i Bashkisë Has dhe Nëpunësi Zbatues nuk kanë marrë masa për kryerjen e procesit të inventarizimit të aktiveve për llogarinë 210 óToka, Troje, Terrene dhe llogarinë 211 óPyje, Kullota, Plantacione të cilat në pasqyrat financiare paraqiten në vlerën zero lekë. Mos kryerja e inventarizimit ka sjellë mos njohjen e gjendjes faktike të këtyre pronave në terren, si ekzistenca fizike e ndërtesave, nëse ka prona të zaptuara në mënyrë të pa ligjshme etj. Veprimet e mësipërme janë në kundërshtim me VKM nr. 433, datë 08.06.2016 e transferimit të administrimit të pyjeve dhe kullotave nga MM në administrim të NJQV, Udhëzimin nr. 8/2018 óPër procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në NJQPô, pika 16,18 dhe VKM nr. 510, datë 10.06.2015 óPër miratimin e procedurave për transferimin e të drejtave dhe detyrimeve, personelit, aktiveve, të trupëzuara dhe të patrupëzuara, të arkivave dhe

çdo dokumentacioni tjetër zyrtar në njësitë e qeverisjes vendore, të prekura nga riorganizimi administrativo-territorial, Kreu VI óTransferimi i pasurive dhe regjistrimi i pasurive të paluajtshme. (Më hollësisht trajtuar në pikën 2.3 faqe 38-56 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

11.1 Rekomandim: Kryetari i Bashkisë Has dhe Nëpunësi Zbatues të marrin masa për kryerjen e procesit të inventarizimit të aktiveve afatgjata materiale të pa inventarizuara deri më sot, përkatësisht për zërin 211 óPyje, Kullota, Plantacione dhe zërin 210 óToke, troje, terrene. Të hartohet regjistri i aktiveve për këto prona me të gjithë elementët e nevojshëm, si data e hyrjes ose marrjes në dorëzim, përshkrimi i aktivitetit, vlerën e blerjes, datën e daljes në përdorim, personin përgjegjës, vlerën e akumuluar të amortizimit, kohën e shërbimeve të mirëmbajtjes, etj.

Në mbyllje të pasqyrave financiare të vitit 2022

12. Gjetje nga auditimi: Aktivet afatgjata materiale të llogarisë 212 óNdërtesa e Konstruksione në vlerën 733,469,916 lekë, janë kontabilizuar në librat e kontabilitetit dhe pasqyrat financiare pa u mbështetur në një dokumentacion vërtetues, siç është titulli i pronësisë, ku gjatë auditimit u evidentua se Bashkia Has nuk ka iniciuar procesin për regjistrimin e tyre. (Më hollësisht trajtuar në pikën 2.3 faqe 38-56 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

12.1 Rekomandim: Titullari i Bashkisë Has dhe Nëpunësi Zbatues të marrin masa për nisjen e procesit të regjistrimit pranë ASHK-së së aktiveve afatgjata materiale për llogari të Bashkisë Has.

Menjëherë dhe në vazhdimësi

13. Gjetje nga auditimi: Bashkia Has nuk ka marrë masa të plota për likuidimin në afat të detyrimit prej 5% të mbajtur si garanci punimesh nga kontraktorët të cilët kanë kryer punime në investime të ndryshme të realizuara në këtë njësi vendore.

Llogaria 466 óKreditorë për mjete në ruajtje dhe cila rezultoi se vlera në fund të vitit 2021, ka pasur në përbërje të llogarisë detyrime për garanci punimesh të bashkisë ndaj subjekteve private, garanci këto të cilave u ka kaluar afati i përcaktuar në kontratat përkatëse të investimit dhe përsëri janë akoma gjendje në llogarinë 466 si shkak i ish Komunave dhe mungesës së informacionit. Në këtë rast garanci të cilave u ka kaluar afati sipas kontratës së lidhur, janë në vlerën 303,575 lekë. (Më hollësisht trajtuar në pikën 2.3 faqe 38-56 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

13.1 Rekomandim: Drejtoria e Financës dhe Buxhetit të njoftojë subjektet sipas kontratave përkatëse të investimeve, për paraqitjen e dokumentacionit të nevojshëm për kryerjen e veprimeve të likuidimit të garancisë së punimeve në masën 5% me një vlerë totale 303,575 lekë dhe të kryejë sistemimet përkatëse në llogarinë 466 óKreditorë për mjete nën ruajtje.

Në mbyllje të pasqyrave financiare të vitit 2022

14. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi dhe kontrolli i pagesave për investimet e Bashkisë Has nga sistemi SIFQ i thesarit, janë identifikuar pagesa faturash të cilat paraqiten të likuiduara në 2022, por të paregjistruara në detyrimet e prapambetura të vitit 2021. Mosparaqitja e tyre në kontabilitet, edhe pse janë kompetencë e vitit ushtrimor 2021 ka nënvlerësuar llogarinë 467 óKreditorë të ndryshëm me **3,173,309 lekë** për vitin 2021. Kjo procedurë mos pasqyrimi në llogarinë 467 óKreditorë të ndryshëm të detyrimeve për faturat e likuiduara në 2022, por me kompetencë vitin 2021, përbën mos pasqyrim të drejtë të informacionit financiar, duke qenë se detyrimet e prapambetura për vitin 2021 të përcjella në Ministrinë e Financave janë nënvlerësuar

me **3,173,309 lekë**. *(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.3 faqe 38-56 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*

14.1 Rekomandim: Titullari i Bashkisë Has në bashkëpunim me Drejtorinë e Financës dhe Buxhetit të bëjnë sistemimet për të pasqyruar në llogarinë 467 óKreditorë të ndryshëm detyrimet për faturat e likuiduara **3,173,309 lekë** për vitin 2021. Gjithashtu, pas saktësimit të detyrimeve të prapambetura, duhet të merren masa për raportimin e tyre në Ministrinë e Financave, raportim i cili aktualisht nuk është real.

Në mbyllje të pasqyrave financiare të vitit 2022

15. Gjetje nga auditimi: Bashkia Has ka hartuar planin e veprimit të zbatimit të rekomandimeve të dërguara nga KLSH me shkresën nr. 866/07 datë 30.12.2021, por nuk ka raportuar në Këshillin Bashkiak mbi rezultatet e zbatimit të këtyre rekomandimeve, veprime këto në kundërshtim me ligjin nr. 68/2017, datë 27.04.2017 óPër financat e vetëqeverisjes vendore, neni 50, pika 5. *(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.4 faqe 56-73 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*

15.1 Rekomandim: Bashkia Has të marrë masa për të kryer raportimin periodik në Këshillin Bashkiak lidhur me ecurinë e zbatimit të rekomandimeve të lëna nga KLSH në përfundim të çdo auditimi.

Menjëherë dhe në vijimësi

16. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi mbi nivelin e zbatimit të rekomandimeve të lëna nga auditimi i fundit i KLSH-së rezulton se nga 21 rekomandime të lëna niveli i realizimit është si vijon:

- Nga 13 masa organizative janë zbatuar 3 masa (rekomandimet 8.1, 9.1, 11.1) dhe nuk janë zbatuar 10 masa organizative (rekomandimet 1.1, 2.1, 3.1, 4.1, 5.1, 6.1, 7.1, 10.1, 12.1, 13.1):

1.1 Rekomandimi: Titullari i Bashkisë Has, Drejtoria e Financës dhe Sektori Taksave e Tarifave Vendore të analizojnë me përgjegjësi dhe të marrin masa të menjëhershme për të sistemuar diferencën e pa argumentuar e rezultuar ndërmjet gjendjes debitorë në pasqyrat financiare dhe gjendjes debitorë e pasqyruar nga sektori taksave tarifave vendore në vlerën prej **2,329,317 lekë** detyrime debitorë, nga mos pagimi nivelit të taksa/tarifa nga bizneset dhe subjektet familjarë, bazuar në listën e personave e subjekteve debitorë.

2.1 Rekomandimi: Titullari Bashkisë Has dhe Drejtoria e Financës të marrin masa për sistemimin e llog. (202) óStudime dhe kërkime dhe të paraqesë në këtë llogari vetëm vlerat e projekteve, për të cilat investimet e lidhura me to nuk kanë përfunduar. Kjo llogari të pakësohet për vlerën **9,729,027 lekë** dhe të shtohet në vlerën e investimit të përfunduar sipas objektit përkatës.

3.1 Rekomandimi: Titullari i Bashkisë Has, Drejtoria e Financës të marrin masa për sistemimin e llog. (203) óKoncesione, Patenta, Licenca e të ngjashme, duke e pakësuar këtë llogari me vlerën **1,085,000 lekë** dhe shtuar në vlerën e investimit të përfunduar sipas objektit përkatës.

4.1 Rekomandimi: Titullari i Bashkisë Has, Drejtoria e Financës të marrin masa për të pasqyruar në llog. (210) óToka, Troje, Terrene dhe vlerën e trojeve nën objektet ndërtesa e pasqyruar në llog. (212) óNdërtime e konstruksione, të cilat me VKM kanë kaluar në pronësi si asete publike të Bashkisë Has, njëkohësisht të kryhet procesi i inventarizimit fizik i trojeve me komision inventarizimi.

5.1 Rekomandimi: Titullari Bashkisë Has, Drejtoria e Financës në bashkëpunim me Sektorin Juridik dhe Drejtorinë e Pyjeve dhe Kullotave, të marrin masa për inventarizimin fizik të pronave

asete publike në pronësi të Bashkisë Has, si dhe të bëhet pasqyrimi i saktë i tyre në dokumentet kontabël i vlerës së administruar në llog. (211) *óPyje, kullota, plantacioneô*.

6.1 Rekomandimi: Titullari Bashkisë Has dhe Drejtoria Financës të marrin masa për pasqyrimin e saktë në dokumentet kontabël të vlerës së secilit aktiv afatgjatë material për llog. (212) *óNdërtime e konstruksioneô*, duke shtuar në vlerën fillestare, vlerën e shpenzimit i cili përbën investim të ri për secilin objekt (*rikonstruksion etj*). Nëpunësi autorizues e Nëpunësi zbatues të marrin masa për ngritjen e komisionit për inventarizimin fizik të aktiveve afatgjata materiale (*AAGJM*) në përfundim komisioni të hartojë relacion për titullarin në lidhje me rezultatet e inventarizimit.

7.1 Rekomandimi: Titullari Bashkisë Has dhe Drejtoria e Financës të marrin masa për pasqyrimin e saktë në dokumentet kontabël të vlerës së secilit aktiv afatgjatë material për llog. (213) *óRrugë, rrjete vepra ujorëô*, duke shtuar në vlerën e tij fillestare, vlera e shpenzimit që përbën investim të ri për secilin objekt. Nëpunësi autorizues e Nëpunësi zbatues të marrin masa për ngritjen e komisionit për inventarizimin fizik të aktiveve afatgjata materiale (*AAGJM*) në përfundim komisioni të hartojë relacion për titullarin në lidhje me rezultatet e inventarizimit.

10.1 Rekomandimi: Titullari i Bashkisë Has, Drejtoria e Financës të marrin masa për sistemimin e llog. (466) *óKreditorë për mjete në ruajtjeô* për të evidentuar e dokumentuar në mënyrë analitike për diferencën në vlerën 7,256,213 lekë e pa analizuar në mënyrë analitike, megjithëse është përmbushur afati i garancisë së punimeve sipas kushteve të kontratës. Të analizojë në origjinë të krijimit të tyre, cilat janë shkaqet e mos likuidimit të vlerës e cila përfaqëson vlerën e garancisë së punimeve për 12 objekte të përfunduara të marra në dorëzim. Titullari dhe Drejtoria e financës të marrin masa për likuidimin e vlerës së mësipërme, duke analizuar më parë gjendjen nëse është përmbyllur garancia e defekteve të punimeve dhe nëse janë bërë korrigjimet e punimeve për çdo kontratë së cilës nuk i është likuiduar kjo garanci.

12.1 Rekomandimi: Titullari Bashkisë Has të analizojë e nxjerrë përgjegjësitë për moszbatimin e rekomandimeve të lëna nga KLSH në auditimin e mëparshëm. Të vazhdojë ndjekja dhe zbatimin e masave që rezultojnë ende të pa zbatuara, apo të përshpejtojë ato rekomandime që janë në proces. Për të cilat Titullari i njësisë vendore të hartojë një program pune të veçantë.

13.1 Rekomandimi: Titullari i Bashkisë Has, Sektori i Planifikimit e Urbanistikës të marrin masa të menjëhershme për të saktësuar oponencën teknike dhe të përshtatë atë me objektin e ndërtuar në territorin e Bashkisë Has, në të kundërt të aplikojë masa administrative nga zhvilluesi (EKB) për kundërvajtjen e konstatuar e parashikuar në ligjin nr. 107/2014 *óPër planifikimin dhe zhvillimin e territoritô*, neni (51), pika (1), germa (gj).

- Nga 2 masa për shpërblim dëmi, rekomandimi 1.1 nuk është zbatuar, ndërsa 2.1 nuk është pranuar:

1.1 Rekomandimi: Titullari Bashkisë Has, Sektori Juridik, Drejtoria e Pyjeve e Kullotave dhe Drejtoria e Financës, të analizojnë situatën dhe të marrin masa të menjëhershme për të përllogaritur sa më të saktë nivelin e tarifës dysHEME për dhënë në përdorim të sipërfaqes nga fondi pyjor/kullosor me kontratë të lidhur për ndërtimin e HCE^{it} në territorin e bashkisë Has, dhe për të kërkuar nga operatori ekonomik *óF.ô SHPK* kthim të vlerës prej 1,120,950 lekë e konsideruar dëm ekonomik për buxhetin e Bashkisë Has, si diferencë në vlerësim të nivelit të tarifës së përllogaritur.

2.1 Rekomandimi: Bashkia Has, Drejtoria e Financës të marrë masa dhe të sistemojë në kontabilitet në llog. (468) *óDebitor të ndryshëmô* vlerën prej 75,389 lekë e konsideruar dëm ekonomik në ngarkim të personave material përgjegjës, për mungesë rezultuar nga inventarizimi

fizik i aktiveve, ndërmjet gjendjes fizike dhe kontabile (*vlera historike*) për 4 artikujt *inventar ekonomik*.

- Nga 6 masa për uljen e borxhit tatimor nuk është pranuar 1 masë (rekomandimi 3.1), nuk janë zbatuar 2 masa (rekomandimet 5.1, 6.1) si dhe janë në proces zbatimi 3 masa (rekomandimet 1.1, 2.1, 4.1):

1.1 Rekomandimi: Titullari i Bashkisë Has, Sektori Taksave e Tarifave Vendore të analizojë situatën dhe të marrë masa të menjëhershme, për arkëtimin e detyrimeve debitore të rezultuara nga mos pagesa e nivelit të taksave e tarifave vendore të parashikuara në paketa fiskale për subjekte ekonomike që ushtrojnë aktivitet për qëllime biznesi dhe nga subjekte familjare me vlerën prej 10,362,754 lekë, si dhe përlllogaritjen të detyrimeve të lindura nga mos realizimi i nivelit për taksën e tokës nga subjekte familjare debitor ndaj njësisë vendore Bashkia Has.

2.1 Rekomandimi: Titullari i Bashkisë Has, Sektori Taksave e Tarifave Vendore të analizojë situatën dhe të marrin masa të menjëhershme për të rinovuar e pajisur me (*licencë/autorizim*) me afat 5 (*pesë*) vite kalendarike, ndërkohë që operatorët ekonomik të cilët ushtrojnë aktivitet për qëllime biznesi me veprimtari tregtimi në stacione karburanti e gaz i lëngshëm për përdorim nga konsumatorët fundorë në territorin e bashkisë Has, të cilët bashkia i ka pajisur me afat për 1(një) vit kalendarik, si pasojë e mos administrimit të autorizimit bazë, apo të mos pagesës së nivelit të tarifës përkatëse pas rinovimit të autorizimit bazë e pa përfshirë në paketat fiskale, për pasojë shuma e përlllogaritur prej 7,980,000 lekë, *konsiderohet e ardhur e munguar e pa programuar për buxhetin e Bashkisë Has.*

3.1 Rekomandimi: Titullari Bashkisë Has, Sektori Taksave e Tarifave Vendore të analizojnë situatën dhe të marrin masa të menjëhershme për të përlllogaritur detyrimin që rrjedh nga mos aplikimi dhe mos zbatimi i nivelit për tarifën vendore nga 9 OE edhe me seli jashtë territorit të Bashkisë Has, të cilët ushtrojnë aktivitet dhe kanë lidhur kontrata punë publike nga fondet e aplikuar për investime në Bashkinë Has, për pasojë shuma 897,500 lekë, *konsiderohet e ardhur e munguar për Buxhetin e Bashkisë Has. Rekomandimi është pranuar pjesërisht nga Bashkia Has.*

4.1 Rekomandimi: Bashkia Has, Sektori i Taksave e Tarifave Vendore të analizojë situatën dhe të marrë masa të menjëhershme për të analizuar dhe kërkuar pagesën e nivelit të taksës së ndikimit në infrastrukturë për ndërtimet informale (*pa leje*) të kryera nga subjekte ekonomik dhe subjekte familjare në territori bashkisë Has e parashikuar edhe në paketat fiskale shuma prej 3,671,328 lekë *e konsiderohet e ardhur e munguar për buxhetin e Bashkisë Has.*

5.1 Rekomandimi: Bashkia Has, Sektori Planifikimit të Territorit dhe Urbanistikës, të analizojë situatën dhe të marrë masa të menjëhershme për të kontabilizuar vlerën e penalitetit sipas vlerës së masës së gjobës dhe të kërkojë arkëtimin e shumës 4,600,000 lekë *e konsideruar e ardhur e munguar e pa planifikuar për buxhetin e Bashkinë Has.*

6.1 Rekomandimi: Titullari i Bashkisë Has, Sektori Juridik, Drejtoria e Pyjeve e Kullotave dhe Drejtoria e Financës të analizojnë situatën dhe të marrin masa të menjëhershme për të kërkuar nga operatorët ekonomik që ushtrojnë aktivitet për qëllime biznesi në fushën e mineraleve dhe të pajisur me leje minerare e miratuar nga (MEIT) për të lidhur kontrata qiraje me të gjithë OE dhe për të gjithë sipërfaqen e dhënë në përdorim për t'u shfrytëzuar nga fondi pyjor/kullësor, brenda territorit të bashkisë Has në sipërfaqen totale prej 746,2 ha e pa kontraktuar me diferencë në vlerën prej 52,330,090 lekë *e konsideruar e ardhur e munguar për buxhetin e Bashkisë Has.*
(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.4 faqe 56-73 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

16.1 Rekomandim: Bashkia Has të marrë masat për zbatimin e rekomandimeve të pa zbatuara, të lëna nga KLSH në auditimin e mëparshëm si vijon:

1. Të zbatohet urdhrat nr. 38/1 deri në 38/8, datë 21.01.2022 óPër realizimin e detyrave të lëna nga KLSH referuar Raportit Përfundimtar të Auditimit nr. 866/07 datë 30.12.2021ô.

2. Drejtoria e Financës të sistemojë diferencën e pa argumentuar e rezultuar ndërmjet gjendjes debitorë në pasqyrat financiare dhe gjendjes debitorë e pasqyruar nga sektori i taksave dhe tarifave vendore në vlerën prej 2,329,317 lekë detyrime debitorë.

3. Drejtoria e Financës të sistemojë llog. (203) óKoncesione, Patenta, Licenca e të ngjashmëô;

4. Drejtoria e Financës të pasqyrojnë saktë në dokumentet kontabël vlerën e secilit aktiv afatgjatë material për llog. (213) óRrugë, rrjete vepra ujorëô;

5. Titullari i Bashkisë Has, Sektori i Planifikimit e Urbanistikës të marrin masa të menjëhershme lidhur me lejen zhvillimore nr. 3, datë 24.03.2020; leje ndërtimi nr. 2 Prot, datë 18.09.2020 óPër ndërtim të ri me sipërfaqe më të madhe se 250 m² për objekt banimi dhe shërbimi 8 kat+1 Kat nëntokëô, për të saktësuar oponencën teknike dhe të përshtatë atë me objektin e ndërtuar në territorin e Bashkisë Has, në të kundërt të aplikojë masa administrative nga zhvilluesi (EKB) për kundërvajtjen e konstatuar e parashikuar në ligjin nr. 107/2014 óPër planifikimin dhe zhvillimin e territoritô, neni (51), pika (1), germa (gj).

6. Drejtoria e Financës të sistemojë në kontabilitet në llog. (468) óDebitor të ndryshëmô **vlerën prej 75,389 lekë e konsideruar dëm ekonomik** në ngarkim të personave material përgjegjës, për mungesë rezultuar nga inventarizimi fizik i aktiveve, ndërmjet gjendjes fizike dhe kontabile (vlera historike) për 4 artikujt óinventar ekonomikô.

7. Titullari Bashkisë Has, Sektori Taksave dhe Tarifave Vendore të analizojnë situatën dhe të marrin masa të menjëhershme për të përlogaritur detyrimin që rrjedh nga mos aplikimi dhe mos zbatimi i nivelit për tarifave vendore nga 9 OE edhe me seli jashtë territorit të Bashkisë Has, të cilët ushtrojnë aktivitetet dhe kanë lidhur kontrata punë publike nga fondet e aplikuar për investime në Bashkinë Has, në shumën **897,500 lekë**.

8. Bashkia Has, Sektori Planifikimit Territorit Urbanistikës, të analizojë situatën dhe të marrë masa të menjëhershme për të kontabilizuar vlerën e penalitetit sipas vlerës së masës së gjobës dhe të kërkojë arkëtimin e shumës **4,600,000 lekë**.

9. Titullari i Bashkisë Has, Sektori Juridik, Drejtoria e Pyjeve e Kullotave dhe Drejtoria e Financës të analizojnë situatën dhe të marrin masa të menjëhershme për të kërkuar nga operatorët ekonomik që ushtrojnë aktivitetet për qëllime biznesi në fushën e mineraleve dhe të pajisur me leje minerare e miratuar nga (MEIT) për të lidhur kontrata qiraje me të gjithë OE dhe për të gjithë sipërfaqen e dhënë në përdorim për t'u shfrytëzuar nga fondi pyjor/kullosor, brenda territorit të Bashkisë Has në sipërfaqen totale prej **746,2 ha** e pa kontraktuar me diferencë në vlerën **prej 52,330,090 lekë**.

10. Titullari Bashkisë Has të analizojë e nxjerrë përgjegjësitë për moszbatimin e rekomandimeve të lëna nga KLSH në auditimet e mëparshme. Të vazhdojë ndjekja dhe zbatimi i masave që rezultojnë ende të pa zbatuara, apo të përshpejtojë ato rekomandime që janë në proces. Titullari i njësisë vendore të hartojë një program pune të veçantë: *për 9 masa për shpërblim dëmi* në vlerën 16,717 mijë lekë e kontabilizuar, por pa arkëtuar; lidhur me zbatimin e vendimit nr. 12, datë 12.02.2019 dërguar nga Agjencia e Prokurimit Publik, në të cilin është vendosur të dënohen me gjobë 11 punonjës në vlerën 2,490,000 lekë, ndërsa ka filluar arkëtimi nga 2 punonjës në masën 600,000 lekë dhe ka mbetur pa arkëtuar vlera prej 1,890,000 lekë.

Menjëherë dhe në vijimësi

B. MASA PËR ULJEN E BORXHIT TATIMOR DHE RITJEN E PERFORMANCËS NË ARKËTIMIN E DETYRIMEVE PËR TAKSAT DHE TARIFAT VENDORE, PËRFSHIRË DHE DETYRIMET NGA QIRADHËNIA - TË ARDHURA TË MUNGUARA.

1. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i ecursë së pagesave për taksën e ndikimit në infrastrukturë nga legalizimet rezulton se në Bashkinë Has ka detyrime të pa paguara për objekte që janë legalizuar që nga viti 2017 deri në 31.12.2020 në vlerën **9,282,639 lekë për 239 objekteqë përbën të ardhura të munguara në buxhetin e Bashkisë Has**. Për vitin 2021 Bashkia Has nuk ka marrë asnjë shkresë nga ASHK për objektet që mund të jenë legalizuar gjatë këtij viti. Gjithashtu, bashkia nga ana e saj nuk ka dërguar asnjë shkresë drejt ASHK-së për të kërkuar informacion. Veprime këto në kundërshtim me përcaktimet e ligjit nr. 9632, datë 30.10.2006, óPër sistemin e taksavevendoreó, i ndryshuar, neni 9, pika 4, neni 27, VKM nr. 860, datë 10.12.2014 ó Për përcaktimin e mënyrës sëmbledhjes dhe administrimittë të ardhurave përndërtimet pa leje dhe vleravetë zbatueshme për legalizimó pika 5. *(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.2 faqe 19-38 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*

1.1 Rekomandim:Sektori i Planifikimit, të Territorit dhe Urbanistikës në Bashkinë Has të dërgojë periodikisht informacion në Sektorin e Taksave dhe Tarifave Vendore mbi subjektet debitorë për óTaksën e ndikimit në infrastrukturë për legalizimetó dhe në bashkëpunim të marrin masa administrative e ligjore për arkëtimin e taksës së ndikimit në infrastrukturë **për 239 debitorë në vlerën 9,282,639 lekë** si dhe në vijimësi nga të gjitha ndërtimet e reja që legalizohen. Gjithashtu, nga strukturat e Bashkisë Has të bashkëpunohet me Agjencinë Shtetërore të Kadastrës (ASHK), për të marrë informacion periodik lidhur me legalizimet e reja që kryhen si dhe për bllokimin e veprimeve në dhënien e certifikatës së pronësisë deri në kryerjen e pagesave të taksës së ndikimit në infrastrukturë.

Menjëherë dhe në vijimësi

2. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i pagesave të kontratave aktive të qirave rezulton se:

- 7 qiramarrës nuk kanë paguar detyrimin për vitin 2021 apo edhe më herët, në vlerën totale 5,434,436 lekë që përbën të ardhura të munguara në buxhetin e Bashkisë Has. Gjithashtu, për qiramarrësit që nuk kanë paguar detyrimet e qirasë nga Sektori i Taksave dhe Tarifave vendore nuk është llogaritur kamatëvonesa prej 0.01% për çdo ditë vonesë por jo më shumë se 10% e vlerës së kontratës.

- Qiramarrësi *G.I* nuk ka paguar detyrimin referuar kontratës nr. 257, datë 12.06.2013 në vlerë 84,000 lekë, detyrim ky që është kontabilizuar nga Drejtoria e Financës, por nuk është i përfshirë në listën e debitorëve progresiv.

- Qiramarrësi *F. SHPK* ka lidhur me Bashkinë Has kontratën me nr. 03, datë 12.01.2015 për marrjen e sipërfaqes 0.63 ha për 9 vjet me vlerë vjetore të kontratës 465,000 lekë. Rezulton se kjo kontratë është amenduar me kontratën nr. 3, datë 01.06.2016 ku sipërfaqja e marrë me qira dhe afati nuk ndryshon por ka ndryshuar vlera e kontratës në 91,350 lekë. Amendimi i kontratës nuk është i shoqëruar me asnjë relacion ku të shpjegohen arsyet e ndryshimit të vlerës së qirasë vjetore. Qiramarrësi ka paguar rregullisht detyrimin sipas amendimit të kontratës përkatësisht për 6 vite x 91,350 = 548,100 lekë, ndërkohë detyrimi që duhet të paguajë sipas kontratës bazë është 6 vite x 465,000 = 2,790,000 lekë. **Diferenca prej 2,241,900 lekë (2,790,000 - 465,000) përbën të ardhura të munguara në buxhetin e Bashkisë Has**. Kjo vlerë detyrimi nuk është e përfshirë

në listën e debitorëve progresiv si dhe nuk është kontabilizuar. Nga vlera totale e detyrimit për pagesat e qirave të kontratave aktive është e përfshirë te lista e debitorëve progresiv detyrimi për 5 qiramarrës në vlerën 2,560,436 lekë dhe nuk është i përfshirë detyrimi në vlerën **2,325,900 lekë** (84,000 + 2,241,900) që përbën të ardhura të munguara në buxhetin e Bashkisë Has.

Gjithashtu, konstatohen 3 subjekte (N., V., A.), të cilat shfrytëzojnë asete të Bashkisë Has dhe nuk kanë një kontratë të nënshkruar me bashkinë, veprime në kundërshtim me përcaktimet e Kodit Civil të Republikës së Shqipërisë, nenet 826-840, ligjit nr. 139/2015, óPër Vetëqeverisjen Vendore, neni 36, VKM-së nr. 54, datë 5.2.2014 óPër përcaktimin e kriterëve, të procedurës e të mënyrës së dhënies me qira, enfiteozë apo kontrata të tjera të pasurisë shtetërore, e ndryshuar, VKM nr. 391 datë 21.06.2006, ndryshuar me VKM nr. 1064, datë 22.12.2010 óPër përcaktimin e tarifave në sektorin e pyjeve dhe të kullotave. *(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.2 faqe 19-38 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*

2.1 Rekomandim: Sektori i Taksave dhe Tarifave Vendore në Bashkinë Has, të marrë masat dhe të ndjekë të gjitha hapat ligjorë për arkëtimin e vlerës që lind nga mos pagesa e kontratave të qirasë për qiramarrësin *G.I* për vlerën **84,000 lekë** dhe subjektin *F*. ShPK për vlerën **2,241,900 lekë**. Gjithashtu, në vijimësi Sektori i Taksave dhe Tarifave Vendore të ndjekë zbatimin e kushteve të kontratave të qirasë me të gjithë qiramarrësit, si dhe për vonesat në pagesa të llogarisë kamatëvonesat referuar kushteve të kontratave.

Menjëherë dhe në vijimësi

2.2 Rekomandim: Sektori i Taksave dhe Tarifave Vendore në Bashkinë Has, të marrë masa për lidhjen e menjëhershme të kontratave të qirasë me subjektet óN.ó, óV.ó dhe óA.ó, që kanë në përdorim objekte/prona/sipërfaqe në pronësi të Bashkisë Has.

Menjëherë dhe në vijimësi

3. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i të dhënave lidhur me detyrimet që tatimpaguesit kanë ndaj Bashkisë Has rezultoi se gjatë vitit 2021 borxhi i krijuar është në shumën 4,166,512 lekë dhe përbëhet nga detyrimet nga taksat dhe tarifat për personat fizikë/juridikë në shumën 3,419,026 lekë, detyrimet nga institucionet shtetërore në shumën 104,240 lekë dhe detyrimet nga qiratë e tregut në shumën 643,246 lekë.

Detyrimet për taksat dhe tarifat vendore më mënyrë progresive më 31.12.2021 në Bashkisë Has janë në vlerën **32,867,505 lekë** të përbëra nga:

- Detyrimet nga taksat dhe tarifat e bizneseve, detyrime nga autorizimet e subjekteve hidrokarbure, detyrime nga kontratat e fondit pyjor kullor (kontrata aktive dhe jo aktive) rezultojnë në vlerën totale **26,643,184 lekë për 187 biznese**;
- Qira të ambienteve të tregut (Markata) detyrime në vlerën **3,743,941 lekë**;
- Detyrime nga kontratat e dhënies me qira të aseteve në vlerën **2,325,900 lekë**;
- Detyrime nga institucione publike në vlerën **154,480 lekë**.

Rezulton se Bashkia Has nuk ka aplikuar të gjitha masat e duhura ligjore për subjektet që nuk kanë paguar detyrimet për taksat dhe tarifat vendore, në kundërshtim me përcaktimet e ligjit nr. 9920, datë 19.05.2008 óPër Procedurat Tatimore në Republikën e Shqipërisë i ndryshuar, nenet 89,90,91,93. *(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.2 faqe 19-38 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*

3.1 Rekomandim: Sektori i Taksave dhe Tarifave Vendore në Bashkinë Has, të marrë masa për nxjerrjen e njoftimit të vlerësimit tatimor për debitorët, duke ndjekur të gjitha rrugët për arkëtimin e detyrimeve për taksat dhe tarifat vendore në fund të vitit 2021 në vlerën:

- 26,643,184 lekë për 187 subjekte private;
- 3,743,941 lekë për qiratë e ambienteve të tregut;
- 2,325,900 lekë nga kontratat e dhënies me qira të aseteve;
- 154,480 lekë nga institucione publike;

a-T'u dërgohen bankave të nivelit të dytë urdhër bllokimet e llogarive bankare.

b-Të dërgohet në Drejtorinë Rajonale të Transportit, kërkesa për vendosjen e barrës siguruese (për mjetet) dhe në ASHK (për pasuritë e paluajtshme).

c-Në funksion të mbledhjes së detyrimit të papaguar, Sektori i Taksave dhe Tarifave Vendore, të angazhohet për të verifikuar dhe monitoruar në vend aktivitetin tregtar të tatim paguesit, me qëllim konfiskimin në fund të çdo dite të një shume jo më pak se 50 % të qarkullimit të realizuar.

d- Nëse edhe pas njoftimeve zyrtare subjektet, nuk pranojnë të paguajnë detyrimet, nga ana e Sektorit të Taksave dhe Tarifave Vendore, të merren masa administrative apo sekuestro dhe pas marrjes së këtyre masave të bëhet kallëzim penal.

e-Sektori i Taksave dhe Tarifave Vendore të bashkërendojë punën me QKB Bashkia Has, për mos kalimin e subjekteve debitorë me status pasiv ose mbyllje dhe lejimin e tyre në debitorë të keq.

f- Në regjistrat e debitorëve, të evidentohen vlera e detyrimit të pa arkëtuar, statusi i tyre dhe hapat e ndërmarra për çdo subjekt në zbatim të ligjit për arkëtimin e debitorëve.

Menjëherë dhe në vijimësi

4. Gjetje nga auditimi: Bashkia Has ka pajisur me autorizim/licencë subjektet që ushtrojnë aktivitet për shitjen e lëndëve djegëse me pakicë dhe ka hartuar akt marrëveshje me to lidhur me pagesën e detyrimit për autorizimin. Marrëveshja konsiston në krijimin e mundësisë për subjektet që detyrimin e autorizimit në vlerën prej 1,000,000 lekë për 5 vite ta paguajnë me këste vjetore në vlerën 200,000 lekë. Konstatohet se subjekti óG.Shô SHPK të cilit i ka përfunduar autorizimi më datë 14.03.2020 nuk është pajisur me autorizim të ri nga Bashkia Has në kundërshtim me përcaktimet e ligjit nr. 8450, datë 24.02.1999 óPër përpunimin, transportimin dhe tregtimin e naftës, të gazit dhe nënprodukteve të tyre, i ndryshuar me ligjin nr. 71/2014, neni 4, neni 15, neni 20, si dhe VKM nr. 970, datë 02.12.2015, óPër përcaktimin e procedurave dhe të kushteve për dhënien e licencave për tregtimin e naftës bruto dhe nënprodukteve të saj, kreu II, pika 3.

Edhe pse nuk është pajisur me autorizim, subjekti óG.Shô SHPK ka paguar vlerën prej 200,000 lekë, për të cilën nuk ka dokumentacion nga Bashkia Has se për cilën periudhë është kjo pagesë. Vlera e mbetur për t'u paguar nga subjektet që janë pajisur me autorizim por me marrëveshje detyrimin e paguajnë me këste është 5,607,000 lekë dhe është e regjistruar të lista e debitorëve progresiv. (Më hollësisht trajtuar në pikën 2.2 faqe 19-38 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

4.1 Rekomandim: Sektori i Taksave dhe Tarifave Vendore të shqyrtojë dokumentacionin e subjektit óG.Shô SHPK dhe të marrë masa që ky subjekt të pajiset menjëherë me autorizimin/licencën për ushtrimin e aktivitetit duke paguar vlerën e mbetur prej 800,000 lekë ndaj Bashkisë Has për 5 vjet duke filluar nga data 14.03.2020. Gjithashtu, Sektori i Taksave dhe Tarifave Vendore të ndjekë rregullisht pagesat periodike të autorizimeve për të gjithë subjektet e tjera me qëllim që të bëjë të mundur pagesat e plota brenda afateve.

Menjëherë dhe në vijimësi

C. MASA DISIPLINORE

KLSH mbështetur në ligjin nr. 154/2014, datë 27.11.2014 *óPër organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit*, neni 15 germa b, c dhe ç, ligjin nr. 152/2013 *óPër nëpunësin civil*, i ndryshuar, neni 59 *óKompetenca dhe procedura për masat disiplinore*, pika 1 dhe pika 4 germa b, VKM-në nr. 115, datë 05.03.2014 *óPër përcaktimin e procedurës disiplinore dhe të rregullave për krijimin, përbërjen e vendimmarrjen në komisionin disiplinor në shërbimin civil*”, ligjin nr. 7961, datë 12.07.1996 *óKodi i punës në Republikën e Shqipërisë*, neni 37, *óMasa disiplinore*, **i rekomandon Kryetarit të Bashkisë Has** të kërkojë Komisionit Disiplinor pranë institucionit, që bazuar në performancën e secilit punonjës dhe shkeljeve të konstatuara në Raportin Përfundimtar të Auditimit të KLSH-së, të vlerësojë shkallën e përgjegjësisë për çdo nëpunës të adresuar dhe të sigurojë marrjen e masave disiplinore përkatëse.

V. ANEKSET

Aneksi: 2.3.1 Analiza analitike e llogarisë 202 “Studime dhe kërkime”

Nr.	E M E R T I M I	Viti i ndërtimit	Vlera fillestare	Vite në përdorim	Amortiz	Vlera Mbetur
1	Studim,projektim Rruga Tobel-Metalaj	09/08/2014	478,800	7	377,727	101,073
2	Studim,projektim 'Planif.Territori	10/10/2014	100,000	7	77,192	22,808
3	Ujsjellsi Golaj miniere , Gjeologji(projektme)	31/12/2014	86,432	7	64,776	21,656
4	Asfaltim rruga fshatit Nikoliq(projektme)	31/12/2008	396,000	13	396,000	-
5	Ujs.Zgjec dhe stac.i pompave Letaj(projektme)	31/12/2009	400,000	12	400,000	-
6	Rik.rruga Vlahen-N/Satcioni elektr.(projektme)	31/12/2009	397,500	12	397,500	-
7	Ndertim Sifoni,Kanali vad.rez.Qarr(projektme)	31/12/2010	297,000	11	297,000	-
8	Nd.KUZB, lagjia Hasanaj, Golaj(projektme)	31/12/2010	395,000	11	395,000	-
9	Studim Hidro-gjeologjik ujsjellsi uji I pishem Zgjec(projektme)	31/12/2010	59,095	11	59,095	-
10	Sistemim,ndricim,trotuari Golaj(projektme)	31/12/2014	478,200	7	358,387	119,813
11	Studime Rik. Shkolla 9-Vjecare Krume	12/10/2006	400,000	15	400,000	-
12	Studime ujerat e larta Fshati Krume	05/11/2008	400,000	13	400,000	-
13	Studime Projektim Rik. Shkolla 9-Vjecare Zahrisht	04/04/2011	399,000	10	399,000	-
14	Studime Projektim Bashkia Has (E re)	10/04/2012	470,400	9	470,400	-
15	Rrjeti kanalizimeve Ujera te Zeza, ne zonen Kodra e Madhe 3km2	26/04/2016	504,000	5	311,168	192,832
16	Hartimi I projektit zbatimit - Ndertim rruge Pusi I Thate	05/06/2016	97,200	5	58,946	38,254
17	Studim & Projektim Rik Ujesjellesi Cahan	04/06/2016	120,000	5	72,806	47,194
18	Studim & Projektim Trotualet qender Golaj, Mur Mbajtes Fshati Bregu I Krumes, Sistemim shtrati gurra e Domaj	04/06/2016	300,000	5	182,014	117,986

19	studim projektimper ndertimin e shkolles 9 vjecare fshati letaj	13/02/2018	330,000	3	98,864	231,136
20	studim projektim preventiv zbatim rikonstrukcion thetore bagetive qyteti krume	30/04/2018	117,000	3	35,052	81,948
21	Studim projektim reabiliti trotuari rruga pashtrig	06/06/2018	57,000	3	17,077	39,923
22	studim projektim kanalit ushqyes te kanalit Llakaj	02/07/2018	990,000	3	296,593	693,407
23	studim projektim reabiliti trotuari rruga pazari vjeter	06/07/2018	984,600	3	294,975	689,625
24	studim-projektim lulishte qyteti krume	22/08/2018	94,800	3	28,401	66,399
25	studim-projektimpallati nr3 firzamonika lagje 1 ne qender qyteti krume	17/04/2019	117,000	2	29,955	87,045
26	studim-projektim ndertim trotuarve qendra vranisht,kodra e madhe,qender letaj,rruge malore qender gjinaj,bjeshke stanet gjinaj	20/04/2019	576,000	2	146,762	429,238
27	studim-projektim rruga pashtrik-rrafsh,sheta,geca,peçaku e sistemim I projektit te tershenes	06/11/2019	684,000	2	118,060	565,940

Aneksi: 2.3.2 Analitikiisht llogaria 212 “Ndërtesa dhe konstruksione”

Nr.	E M E R T I M I	Viti i	Vlera	Vite ne	Amortiz	Vlera Mbetur
1	Çerdhe Qyteti Krume (Kopeshti)	31/12/1990	194,840	30	79,005	115,835
2	Ndertesa Çerdhe Fshati Krume	31/12/1990	29,050	30	11,779	17,271
3	Ndertesa Kopeshti Zahrisht	01/01/1990	19,370	31	8,011	11,359
4	Shkolla 9-Vjecare Vlahen	11/10/1998	6,502,030	22	2,224,177	4,277,853
5	Shkolla 9 - Vjecare Zahrisht	31/12/2013	6,997,095	7	1,525,252	5,471,843
6	Amb.Q. Shendetsore Fajza	10/10/2000	155,538	20	50,671	104,867
7	Konvikti Kosova Krume	01/05/1994	5,303,666	27	2,006,480	3,297,186
8	Konvikti Kosova Krume	01/05/2004	9,687,324	17	2,875,101	6,812,223
9	Ndertesa Markata -Banja	31/07/2001	2,585,436	19	825,323	1,760,113
10	Shkolla 9 - Vjecare Zahrisht	31/10/2013	7,246,245	7	1,589,426	5,656,819
11	Shkolla 9 - Vjecare Zahrisht	01/12/2002	4,972,260	18	1,533,091	3,439,169
12	Shkolla 9 - Vjecare Zahrisht	22/12/2014	14,269,275	6	2,997,093	11,272,182
13	Shkolla 9 - Vjecare Zahrisht	17/04/2015	72,000	6	14,935	57,065
14	Shkolla 9 - Vjecare Zahrisht	17/04/2015	9,000	6	1,867	7,133
15	Ndertesa Poliklinika Krume	31/10/1990	29,050	30	11,820	17,230
16	Ndertesa Pallatit Kultures	31/12/1990	5,538,043	30	2,245,570	3,292,473
17	Ndertim rrethimi Pallatit Kultures	31/12/2011	399,960	9	93,710	306,250
18	Shkolla 9-Vjecare Dobrunë	05/11/1998	3,698,263	22	1,263,018	2,435,245
19	Shkolla 9-Vjecare Domaj	27/09/2005	23,178,411	15	6,613,226	16,565,185
20	Shkolla 9-Vjecare Gjinaj	01/01/2000	9,086,045	21	3,017,456	6,068,589
21	Shkolla 9-Vjecare Helshan	18/10/2014	34,886,486	6	7,378,104	27,508,382
22	Shkolla 9-Vjecare Helshan	24/07/2000	2,520,660	20	825,573	1,695,087

23	Shkolla 9-Vjecare Helshan	07/11/2016	2,768,457	4	539,095	2,229,362
24	Shkolla 9-Vjecare Helshan	07/04/2017	1,420,131	4	271,752	1,148,379
25	Shkolla 9-Vjecare Helshan	13/04/2017	151,200	4	28,913	122,287
26	Ambulanca Branoge	25/10/2001	1,987,137	19	630,519	1,356,618
27	Ambulanca Liqe-Kuq	10/10/2008	1,511,860	12	393,942	1,117,918
28	Ambulanca Metaliaj	10/10/2001	1,875,248	19	595,645	1,279,603
29	Ambulance lagjia Kastrat	31/12/2004	129,800	16	37,817	91,983
30	Ambulance fshati Mujaj	31/12/2007	129,800	13	34,644	95,156
31	Shkolla 9-Vjecare Kishaj	01/01/2003	12,063,500	18	3,711,177	8,352,323
32	Ndertim Rrethimi i Kopeshtit Krume	31/12/2005	480,000	15	135,935	344,065
33	Tregu Agro Ushqimor	31/10/2012	49,828,433	8	11,335,532	38,492,901
34	Ambulanca Shendetesore Pla te Krumes	31/12/2012	1,041,764	8	235,573	806,191
35	Rrethimi i Varrezave te Qytetit Krume	03/08/2004	1,998,000	16	588,794	1,409,206
36	Shkolla 9-Vjecare Krume (Mesme)	01/06/1995	4,556,579	26	1,683,571	2,873,008
37	Shkolla 9-Vjecare Krume (Mesme)	31/07/2004	8,143,047	16	2,400,236	5,742,811
38	Shkolla 9-Vjecare Krume (Mesme)	31/07/2006	10,150,000	14	2,826,437	7,323,563
39	Shkolla 9-Vjecare Krume (Mesme)	31/07/2008	23,939,794	12	6,275,860	17,663,934
40	Ndertesa Pallatit Kultures	31/10/2012	414,721	8	94,346	320,375
41	Shkolla 9-Vjecare Krume (P Cilesi Barazi Ne	20/09/2013	80,979,727	7	17,836,599	63,143,128
42	Shkolla 9-Vjecare Krume (P Cilesi Barazi Ne	20/09/2013	87,724,256	7	19,322,149	68,402,107
43	Shkolla 9-Vjecare Krume (P Cilesi Barazi Ne	20/11/2013	1,795,875	7	393,115	1,402,760
44	Tregu Agro Ushqimor	05/12/2014	299,998	6	63,125	236,873
45	Shkolla 9-Vjecare Letaj	22/12/1998	-	22	-	-
46	Shkolla 9-Vjecare Mujaj	31/12/1990	116,200	30	47,116	69,084
47	Shkolla 9-Vjecare Myc Has	27/11/2005	7,500,239	15	2,129,745	5,370,494
48	Shkolla 9-Vjecare Nikoliq	24/07/2010	33,205,088	10	8,168,969	25,036,119
49	Shkolla 9-Vjecare Perollaj	25/04/1999	9,571,280	22	3,232,219	6,339,061
50	Shkolla 9-Vjecare Perollaj	30/12/2006	5,490,180	14	1,510,206	3,979,974
51	Zbatim per eficencen e energjise Ndertesa 4kt	22/12/2016	17,388,718	4	3,368,602	14,020,116
52	Zbatim per eficencen e energjise ndertese 4kt	20/12/2016	117,600	4	22,786	94,814
53	Rrethim I varrezave te lagjes Nikoliq dhe	28/12/2016	1,485,624	4	287,601	1,198,023
54	Zbatim per eficencen e energjise ndertese 4kt	28/12/2016	11,760	4	2,276	9,484
55	Rrethim I varrezave te lagjes Nikoliq dhe	28/12/2016	11,520	4	2,230	9,290
56	Rehabilitim pallatet Qyteti Krume	17/08/2016	52,749,685	4	10,368,365	42,381,320
57	Rehabilitim pallatet Qyteti Krume	17/08/2016	540,000	4	106,142	433,858
58	Shkolla 9-Vjecare Pusi Thate	01/01/2000	250,000	21	83,025	166,975
59	Objekt me vlera historike,Golaj	31/12/2012	767,188	8	173,484	593,704
60	Zyrat e komunes,Golaj + Z Gjendjes Civile	10/08/2000	10,191,609	20	3,334,115	6,857,494
61	Ambulanca Sefoll	25/10/2008	1,486,778	12	386,909	1,099,869
62	Ambulanca Tregtan	25/10/1998	2,336,503	22	798,527	1,537,976
63	Ambulanca Vranisht	25/10/1998	2,372,352	22	810,779	1,561,573
64	Arkiva Krume	31/12/2004	-	16	-	-
65	Gjendja Civile	25/10/2009	298,000	11	75,121	222,879
66	Godina Njesise Administrative	01/01/1995	3,232,730	26	1,205,327	2,027,403
67	Shkolla 9-Vjecare Vranisht	21/07/2016	56,900	4	11,218	45,682
68	Shkolla 9-Vjecare Vranisht	30/12/2015	474,000	5	95,612	378,388
69	Shkolla 9-Vjecare Vranisht	31/12/2015	2,494,532	5	503,125	1,991,407
70	Shkolla 9-Vjecare Vranisht	25/10/1999	2,238,992	21	746,963	1,492,029
71	ndertesa zjarrefikesve(ish dega e mobilizimit)	01/01/1987	1,600,000	34	700,906	899,094
72	Varreza, (rrethim varreza Perollaj)	30/06/2014	41,600	7	34,693	6,907
73	Shkolla 9-Vjecare Vranisht	25/10/1999	14,296,987	21	4,769,696	9,527,291
74	Shkolla 9-Vjecare Vranisht	05/06/2013	3,552,690	8	791,000	2,761,690
75	Shkolla 9-Vjecare Vranisht	06/08/2014	38,860,734	6	8,281,928	30,578,806
76	Komuna Fajza	10/10/1974	7,182,906	46	3,862,536	3,320,370
77	Shkolla 9-Vjecare Vranisht	09/06/2015	2,500,000	6	515,666	1,984,334
78	Kopshti Fajza	10/10/1974	162,191	46	87,217	74,974

79	Shkolla 9-Vjecare Zgjec	25/03/1999	4,175,247	22	1,412,868	2,762,379
80	Ndertesa Bashkia Has	31/12/2006	4,066,810	14	1,118,584	2,948,226
81	Rikonstruksion Zyra Gjendjes Civile Krume	31/12/2008	-	12	-	-
82	Rrethim varreza F.Fajza	25/10/2013	150,000	7	32,921	117,079
83	Rrethim varreza L.Kuq	25/10/2014	318,000	6	67,204	250,796
84	Shkolla 9 - Vjecare Metaliaj	25/10/2008	150,000	12	39,036	110,964
85	Shkolla 9 - Vjecare Metaliaj	25/10/1986	4,370,355	34	1,921,136	2,449,219
86	Shkolla 9 Vjecare Tregtan	25/10/1978	3,516,905	42	1,775,327	1,741,578
87	Shkolla E Mesme Fajza	10/10/1974	5,004,230	46	2,690,974	2,313,256
88	Shkolla e re Fajza	25/10/2008	24,275,674	12	6,317,318	17,958,356
89	Shkolla 9 - Vjecare Metaliaj	10/10/2009	25,903,878	11	6,538,682	19,365,196
90	Sholla Fillore B.Krumes	25/10/1999	1,754,835	21	585,440	1,169,395
91	Zyra e Ndermarjes Has	01/01/1990	1,637,488	31	677,274	960,214
92	Zyrat e vjetra te Llogarise	01/01/1990	19,430	31	8,037	11,393
93	Shkolla 9-Vjecare Golaj	17/11/2004	62,252,392	16	18,198,015	44,054,377
94	Shkolla Mesme Krume (Fillore)	31/12/1990	5,576,799	30	2,261,286	3,315,513
95	Shkolla Mesme Krume (Fillore)	31/12/2007	2,000,000	13	533,811	1,466,189
96	Shkolla Mesme Krume (Fillore)	31/12/2007	2,134,942	13	569,828	1,565,114
97	Shkolla Mesme Krume (Ish Shkolla 9-Vjecare)	05/05/2014	3,158,778	7	679,749	2,479,029
98	Shkolla Mesme Krume (Ish Shkolla 9-Vjecare)	05/05/2014	3,127,979	7	673,121	2,454,858
99	Shkolla Mesme Krume (Ish Shkolla 9-Vjecare)	16/04/2015	33,600	6	6,970	26,630
100	Shkolla Mesme Krume (Ish Shkolla 9-Vjecare)	17/04/2015	3,000	6	622	2,378
101	Rehabilitim pallatet Qyteti Krume	16/08/2017	49,891,610	3	9,401,271	40,490,339
102	Rehabilitim pallatet Qyteti Krume	17/08/2017	408,000	3	76,872	331,128
103	Sektori Pyjor Fajza	12/05/2017	1,464,500	4	279,100	1,185,400
104	Sektori Pyjor Golaj	12/05/2017	1,488,400	4	283,654	1,204,746
105	Sektori Pyjor Helshan	12/05/2017	1,741,220	4	331,835	1,409,385
106	posbllok Helshan	12/05/2017	426,600	4	81,300	345,300
107	Rehabilitim pallatet Qyteti Krume	09/10/2018	749,029	2	106,738	642,291
108	Shkolla 9-Vjecare Tregtan (rikonstruksion)	27/12/2018	4,419,384	2	629,768	3,789,616
109	Rindertim Shkolla 9-Vjecare Letaj	27/12/2018	2,000,000	2	285,003	1,714,997
110	Rindertim Shkolla 9-Vjecare Letaj	16/10/2018	12,018,238	2	1,712,616	10,305,622
111	Rindertim Shkolla 9-Vjecare Letaj	06/11/2018	7,031,998	2	1,002,070	6,029,928
112	Rindertim Shkolla 9-Vjecare Letaj	17/12/2018	6,931,275	2	987,716	5,943,559
113	Pasuria 4/80-N1(zyrat e sig shoqerore)	28/05/2019	2,860,988	2	1,306,299	1,554,689
114	Shkolla 9-Vjecare Tregtan	22/07/2019	20,132,317	1	2,366,112	17,766,205
115	Rindertim I Shkolles 9-Vjecare Letaj	13/12/2019	44,033,121	1	4,391,218	39,641,903
116	Shkolla 9-Vjecare Tregtan	22/07/2019	117,000	1	13,750	103,250
117	Rindertim I Shkolles 9-Vjecare Letaj	13/12/2019	180,000	1	17,951	162,049
118	Lulishte qyetit Krume	31/12/2018	33,000	2	4,702	28,298
119	Lulishte qyetit Krume	31/12/2018	15,000	2	2,138	12,862
120	Lulishte qyetit Krume	31/12/2018	1,844,959	2	262,909	1,582,050
121	Tregu Agro Ushqimor	15/05/2019	1,359,780	2	171,244	1,188,536
122	Rindertim Shkolla 9-Vjecare Letaj	12/05/2020	17,086	1	854	16,232
123	Rindertim Shkolla 9-Vjecare Letaj	26/02/2020	300,000	1	15,000	285,000
Totali			966,447,807		232,977,891	733,469,916

Aneksi: 2.3.3 Analitikisht llogaria 215 “Mjete transporti”

Nr.	E M E R T I M I	Viti i Ndertimit	Vlera fillestare	Vite ne Perdorim	Amortiz	Vlera Mbetur
1	Kamion	24/12/2010	2,343,200	10	2,284,795	58,405
2	Makine administrate ML	24/07/2012	2,394,000	8	1,059,245	1,334,755
3	Makine tip JEEP	31/03/2012	1,488,000	9	680,529	807,471
4	automjet (kamion)APV me vinc	22/07/2016	4,999,200	4	1,738,170	3,261,030

5	automjet (mercedez)viti 1990,nafte,10964CC,Nr.Shasie 61506425488919	27/12/2016	545,173	4	127,104	418,069
6	Makine ËOLSVAGEN	01/01/1997	374,000	24	374,000	-
7	Veture Benz (HS 0801 A)	17/06/2002	1,099,996	19	1,012,126	87,870
8	Eskavator me zinxhire,Volvo FC220D,seri- 16121209,me kave germimi+patrimi 1800mm seri322196(pompe graso,celes 17-13,24-27,30- 32,kacavide)	10/03/2017	16,347,130	4	3,656,733	12,690,397
9	mjeti tip mercedes benz, zjarrefikese me nr shasie 61506425495204	07/02/2019	748,003	2	103,170	644,833
10	motocikleta 125ccBrendKIEËAY model target125,nr LBBJ89007KBA38539,TARGA AZ118	22/07/2019	323,252	1	37,992	285,260
11	motocikleta 125ccBrendKIEËAY model target125,nr LBBJ89007KBA41943,TARGA AZ311	22/07/2019	323,252	1	37,992	285,260
Totali			30,985,206		11,111,856	19,873,350

Aneksi: 2.3.4 Analitikisht aktivet afatgjata materiale dhe jomateriale

N	E M E R T I M I	Viti i	Vlera	Vite ne	Amortiz	Vlera
1	Mbjellje peme oborri ishkolles Golaj ne proces	31/12/2013	326,708	7.0	0	326,708
2	Mbjellje peme oborri I shkolles Nikoliq ne proces	31/12/2013	89,234	7.0	0	89,234
3	Rikonstruksion Pallatit 4kt, rruga Dardania	31/12/2021	4,999,908	0.0	0	4,999,908
4	Ndertim rruga bjeshkes Gjinaj & rikonstruksion I	16/09/2020	3,996,257	0.3	0	3,996,257
5	Ndertim Ujesjellesi Rajonal per njesine	29/12/2020	60,000,000	0.0	0	60,000,000
6	Ndertim Ujesjellesi Rajonal per njesine	29/12/2020	796,800	0.0	0	796,800
7	Rikonstruksion Pallatit 4kt, rruga Dardania	29/12/2020	9,000,000	0.0	0	9,000,000
8	Rikonstruksion Pallatit 4kt, rruga Dardania	31/12/2021	7,496,075	0.0	0	7,496,075
9	Ndertim rruga bjeshkes Gjinaj & rikonstruksion I	31/12/2021	4,185,650	0.0	0	4,185,650
1	Ndertim Ujesjellesi Rajonal per njesine	31/12/2021	20,000,000	0.0	0	20,000,000
1	Ndertim Ujesjellesi Rajonal per njesine	31/12/2021	200,000	0.0	0	200,000
Totali			111,090,632		0	111,090,632

Aneksi: 2.3.6 Analitikisht aktivet afatgjata të dëmtuara

Nr.	E M E R T I M I	Viti i	Vlera fillestare	Vite ne	Amortiz	Vlera
1	Shkolla 9-Vjecare Cahan	31/12/1990	96,830	30	33,044	63,786
2	Ndertesa Muzeu Krume	31/12/1990	97,420	30	33,245	64,175
3	Shkolla 9-Vjecare Kosturr	30/12/2012	353,519	8	101,434	252,085
4	Makine MITSUBISHI	24/07/2002	999,500	18	847,947	151,553
5	Depo Oksigjeni	01/01/1990	6,205	31	2,173	4,032
6	Hangar 1 NB	01/01/1990	48,890	31	17,124	31,766
7	Hangar 2 NB	01/01/1990	124,450	31	43,589	80,861
8	Hangar 3 NB	01/01/1990	50,000	31	17,513	32,487
9	Ish Zyrtar e Sektorit Ujrave	01/01/1990	21,615	31	7,571	14,044
10	Stacion Pompimi Fajza	01/01/1990	315,310	31	116,698	198,612
11	Stacion Pompimi Tregtan nr.3	01/01/1990	120,000	31	42,031	77,969
12	Stacion Pompimi kosturr	01/01/1990	149,500	31	52,364	97,136
13	Magazina e NB	01/01/1990	86,022	31	30,129	55,893
14	Oficina dykateshe	01/01/1990	266,496	31	93,342	173,154
15	Oficina Krume	01/01/1990	820,820	31	287,497	533,323
16	Rrethimi I oficines NB	01/01/1990	35,866	31	12,562	23,304
17	Shkolla Q Tobel	25/10/1998	722,579	22	195,566	527,013
18	Shtepia e Kultures Fajza	10/10/1974	304,379	46	148,477	155,902
19	Vend roja NB	01/01/1990	3,084	31	1,080	2,004
20	Shkolla Gjeologji,e re	09/09/2004	2,024,891	16	948,137	1,076,754
21	Shkolla Gjeologji,e vjeter	09/09/2004	2,500,000	16	543,951	1,956,049
22	Kamion Tip Benz	26/10/2000	4,225,000	20	4,225,000	-

23	Shkolla Pla - Pates	31/12/1997	1,500,000	23	417,029	1,082,971
24	Shkolla Qarr	05/03/1999	4,796,737	22	1,282,698	3,514,039
25	Land Rover	01/01/2002	895,000	20	895,000	-
	Totali		20,564,113		10,395,20	10,168,912

Aneksi: 2.3.6 Analitikisht Llogaria 466 “Kreditore për mjete nën ruajtje

Nr	STR. BUXHETORE	EMERTIMI I OBJEKTIT	FIRMA FITUESE	Nga komunat e Suprimuara	Çelja 01.01.2021	5% Garanci Te Hyra 2021	Te dala Garanci 2021	TOTALI
1	00-05-04530-231 - M991010	Infrast e Qytetit Krume Faza II	Sh.p.k. ó L. ó	-	98,042	-	-	98,042
2	11-01-09120-231 - M112153	Rikon.9-Vjecare Zahrisht	Sh.p.k. óXh.ó	-	56,702	-	-	56,702
3	11-01-09120-231 - M112513	Rikon.9-Vjecare Zahrisht F II	Sh.p.k. óXh.ó	-	713,513	-	(713,513)	-
4	11-01-09240-231 - M112360	Rikon. Çatia Shk. Mesme Krume	Sh.p.k. óXh.ó	-	314,338	-	(314,338)	-
5		Ndertim Shkolla Perollaj	I. Shpk	26,450	26,450	-	-	26,450
6	94-01-09120-231 - M991518	Rehabilitim I rruges Fshatit Zahrisht	P. Shpk	-	2,557	-	-	2,557
7	11-01-09120-231 - M112751	Rindertim I Shkolles 9-Vjecare Letaj	L. Shpk	-	3,263,489	-	(3,263,489)	-
8	00-05-04520-231 -	Ndertim trotuari Rruga Pashtriku dhe tjera tbrendeshme	S. Shpk	-	97,542	-	-	97,542
9	06-01-06370-231 - M063869	Rik Ujesjellesi Fshatit Zahrisht (Shtesa)	L. Shpk	-	22,282	-	-	22,282
10	00-05-06260-231 - 1170068	Rehabilitim Rruga Lagje Peka dhe Pazari Vjeter	Z.	-	2,056,377	75,000	-	2,131,377
11	00-01-06260-231 - 1170088	Ndertim trotuaresh ne segmentet Krume-Koder e Madhe, Qender Fshati Letaj dhe Qender fshati Vranisht	O.	-	477,401	99,997	(577,398)	-
12	00-01-06260-231 -	Pallati 4kt rruga Dardania	P. Shpk	-	699,995	374,805	-	1,074,800
13	00-05-05200-231 - 1170096	Ndërtimin e Kolektorit të ujërave të zeza të Qytetit Krume	O.	-	127,520	-	(127,520)	-
14	00-05-06260-231 - 1170099	Ndertim Rruge Malore Qender Fshati Gjinaj - Stanet, Bjeshka Gjinaj & Rkonstruksion I Rruges Segmenti Gjinaj - Pus I Thate.	H. Shpk	-	199,813	209,282	-	409,095
15	06-01-06370-231 - 18BQ381	Ndertim Ujesjellesi Rajonal per njesine administrative Golaj, Per fshatrat Dobrunë, Qarr I Vogel, Golaj, Nikoliq dhe Vlahen, Bashkia Has	L. Shpk	-	3,000,000	1,000,001	-	4,000,001
		Totali Leke		26,450	11,156,021	1,759,085	(4,996,258)	7,918,848

KONTROLI I LARTË I SHTETIT